

BANKA E SHQIPËRISË

RAPORTI VJETOR

2014

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 850 kopje
Shtypur në:

P Ë R M B A J T J A

MISIONI DHE DETYRAT KRYESORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË 11

FJALA E GUVERNATORIT 15

NGJARJET KRYESORE TË VITIT 20

STRUKTURA ORGANIZATIVE E BANKËS SË SHQIPËRISË 25

I. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË 27

II. BANKA E SHQIPËRISË GJATË VITIT 2014 30

II. 1. Ambienti makroekonomik dhe politika monetare 30
II.2. Stabiliteti financiar dhe ecuria e sistemit bankar 57
II.3. Mbikëqyrja bankare 65
II.4. Sistemi i pagesave dhe emetimi i monedhës 75
II.5. Operacionet në tregun financiar dhe administrimi i rezervës valutore 85
II.6. Statistikat 91

III. PUNA KËRKIMORE 96

IV. INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR 100

V. ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE INFRASTRUKTURA E BANKËS SË SHQIPËRISË 106

VI. KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN 112

VII. KONTROLLI I BRENDSHËM 118

VIII. OBJEKTIVAT E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2015 122

IX. RAPORTI I AUDITORIT TË JASHTËM DHE PASQYRAT FINANCIARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2014 126

T A B E L A

II. Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2014

Tabelë 1.	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë*	*31*
Tabelë 2.	*Disa tregues të ekonomisë në vite*	*34*
Tabelë 3.	*Zërat kryesorë të bilancit të pagesave (në mln euro, nëse nuk tregohet ndryshe)*	*41*
Tabelë 4.	*Ecuria e treguesve fiskalë*	*43*
Tabelë 5.	*Kontributi vjetor i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)*	*45*
Tabelë 6.	*Tregues të përfitueshmërisë nga veprimtaria kryesore në përqindje (kumulative)*	*63*
Tabelë 7.	*Struktura e pronësisë së bankave (numri i bankave, fund i periudhës)*	*67*
Tabelë 8.	*Numri i subjekteve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë (fund periudhe)*	*68*
Tabelë 9.	*Transaksionet me karta sipas terminaleve*	*82*
Tabelë 10.	*Struktura e injektimit sipas instrumenteve*	*86*

H A P Ë S I R A I N F O R M U E S E

Hapësirë informuese 1:	*Ekonomia shqiptare në këndvështrimin e bizneseve dhe të konsumatorëve*	*39*
Hapësirë informuese 2:	*Politika monetare dhe transmetimi i saj në ekonomi.*	*51*
Hapësirë informuese 3:	*Përmbledhje e rezultateve të vrojtimit të aktivitetit kreditues gjatë vitit 2014*	*56*
Hapësirë informuese 4:	*Ecuria e sistemeve AIPS dhe AECH*	*77*
Hapësirë informuese 5:	*Statistika mbi ecurinë e rezervës valutore, gjatë vitit 2014*	*90*
Hapësirë informuese 6:	*Projekti "Analiza e nevojave të Bankës së Shqipërisë"*	*101*
Hapësirë informuese 7:	*Realizimi i Projektit për Rikonstruksionin dhe Ndërtimin e Bankës së Shqipërisë*	*107*
Hapësirë informuese 8:	*Aktivitetet edukuese të organizuara gjatë vitit 2014*	*115*

G R A F I K Ë

II. Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2014
Grafik 1. Ecuria e normave bazë të interesit 32
Grafik 2. Ecuria e kursit të këmbimit dhe e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare 32
Grafik 3. Çmimi i naftës dhe i ushqimeve në tregun ndërkombëtar (ndryshim vjetor i indekseve) 33
Grafik 4. Ecuria vjetore e PBB-së reale (në %) dhe kontributet e komponentëve të vlerësuar nga ana e prodhimit (në pikë përqindje). Tendenca e vlerës së shtuar bruto reale në ekonomi dhe në sektorë 36
Grafik 5. Ecuria e shkallës së papunësisë (në përqindje) 37
Grafik 6. Ecuria e kërkesës së sektorit privat (ndryshim vjetor në përqindje) dhe e treguesit të ndjesisë ekonomike, TNE (mesatare afatgjatë=100) 37
Grafik 7. Tregues të tërthortë të konsumit privat 38
Grafik 8. Tregues përafrues të investimeve private 38
Grafik 9. Treguesi i ndjesisë ekonomike në Shqipëri, në vendet e Bashkimit Evropian dhe krahasimi me normat vjetore të PBB-së 39
Grafik 10. Balancat kryesore të vrojtimeve të besimit të biznesit (mesatare për ekonominë) dhe të konsumatorit 39
Grafik 11. Kontributi i eksporteve reale neto në rritjen ekonomike (në pikë përqindje të PBB-së) 40
Grafik 12. Forma e financimit të llogarisë korrente (ndaj PBB-së nominale) 41
Grafik 13. Politika fiskale dhe pozicioni fiskal, 2002 - 2014 42
Grafik 14. Ndryshimet vjetore të zërave kryesorë fiskalë (shpenzimet majtas dhe të ardhurat djathtas) sipas kontributeve të kategorive kryesore përkatëse 43
Grafik 15. Inflacioni vjetor (në përqindje) 44
Grafik 16. Prirjet afatgjata të inflacionit (majtas) dhe presionet e brendshme nga kostot si ndryshime vjetore të treguesve (djathtas) 46
Grafik 17. Kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në inflacionin total 46
Grafik 18. Pritjet inflacioniste nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë 47
Grafik 19. Hendeku i prodhimit dhe inflacioni bazë (majtas); norma bazë e interesit (djathtas) 47
Grafik 20. Normat e interesit në tregun ndërbankar dhe kurba e yield-eve në tregun primar 49
Grafik 21. Ecuria e normave te interesit për depozitat dhe kreditë 49
Grafik 22. Kursi i këmbimit lek/euro dhe lek/usd dhe luhatshmëria e tyre ndër vite 50
Grafik 23. Përcjellja e politikës monetare në tregjet financiare 51
Grafik 24. Faktorët përcaktues të ecurisë së kredisë 52
Grafik 25. Ecuria e ofertës monetare dhe përbërja e depozitave 54
Grafik 26. Kredia për ekonominë dhe normat e interesit sipas monedhës 54
Grafik 27. Ecuria e kredisë sipas destinacionit të saj (ndryshime vjetore, në përqindje) 55
Grafik 28. Ecuria e standardeve të huadhënies për agjentët ekonomikë 56
Grafik 29. Ecuria e kërkesës për kredi 57
Grafik 30. Ecuria e numrit dhe vlerës së transaksioneve të shlyera në AIPS (majtas) dhe raporti i vlerës së transaksioneve të AIPS ndaj PPB-së (djathtas) 77
Grafik 31. Shpërndarja e pagesave të procesuara në sistemin AIPS në numër (majtas) dhe në vlerë (mld lekë, djathtas) 78
Grafik 32. Ecuria e vlerës së KBD dhe AIPS si dhe raporti i tyre (majtas), dhe ecuria e numrit të KBD dhe vlerës mesatare (djathtas) 78
Grafik 33. Ecuria e numrit dhe e vlerës së transaksioneve të kleruara në AECH 79
Grafik 34. Pesha e transaksioneve sipas seancave në AECH për vitin 2014 79
Grafik 35. Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave në vite (majtas) dhe përdorimi i instrumenteve të pagesave nga individët dhe bizneset 80
Grafik 36. Ecuria e përqindjes së llogarive të aksesueshme nga interneti ndaj totalit të llogarive dhe ecuria e raportit të shfrytëzimit të llogarive të aksesueshme nga interneti 80
Grafik 37. Zhvillimet e ATM dhe POS, për periudhën 2004 -2014 (majtas), dhe zhvillimet e kartave të debitit dhe të kreditit (djathtas) 81
Grafik 38. Struktura e kartëmonedhës në qarkullim (copë) 83
Grafik 39. Struktura e monedhës metalike në qarkullim (copë) 83
Grafik 40. Operacionet e tregut të hapur dhe përdorimi i lehtësirave të përhershme 86
Grafik 41. Ndërhyrjet me marrëveshjet e anasjella të riblerjes me maturim njëjavor, njëmujor dhe tremujor 86

V. Administrimi i burimeve njerëzore dhe infrastruktura e Bankës së Shqipërisë
Grafik 42. Shpërndarja e punonjësve sipas nivelit të kualifikimit 106

GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. GENT SEJKO.

ANËTARËT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS (nga e majta, në të djathtë)

Zj. Denada Prifti, Anëtare
Zj. Ermelinda Meksi, Anëtare
Z. Petraq Milo, Anëtar
Zj. Elisabeta Gjoni, Zëvendëskryetare
Z. Gent Sejko, Kryetar
Zj. Natasha Ahmetaj, Anëtare
Z. Dhori Kule, Anëtar
Zj. Ela Golemi, Anëtare
Z. Tonin Kola, Anëtar

POTAIN

MISIONI DHE DETYRAT KRYESORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

- Në bazë të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Nëpërmjet arritjes së këtij objektivi, Banka e Shqipërisë ndihmon në krijimin e premisave të duhura për rritjen ekonomike, të punësimit dhe të mirëqenies, ruan vlerat e kursimeve, si dhe ndihmon stabilitetin e zhvillimin e sistemit financiar. Përmbushja e objektivit realizohet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit në mënyrë të pavarur të politikës monetare. Gjithashtu, ajo ndihmohet edhe nga kryerja e një sërë funksionesh mbështetëse nga Banka e Shqipërisë.
- Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë bankare. Bazuar në parimet e tregut, ajo synon të nxisë funksionimin normal, efektiv dhe të qëndrueshëm të sistemit bankar. Nëpërmjet: politikave të saj makroprudenciale; rregullimit dhe mbikëqyrjes së kujdesshme të sektorit bankar e të institucioneve financiare jobanka; rolit të saj si "huadhënës i fundit në radhë"; rolit të saj si autoriteti përgjegjës për trajtimin dhe likuidimin e bankave me probleme; dhe, rregullimit e mbikëqyrjes së infrastrukturës së pagesave, Banka e Shqipërisë angazhohet dhe jep një kontribut direkt në ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit.
- Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës kombëtare – Lekut. Në përmbushje të përgjegjësisë ligjore, ajo nxit funksionimin normal të sistemeve të pagesave, me qëllim mbështetjen e zbatimit të politikës monetare, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe të besueshmërisë së publikut në monedhën kombëtare.
- Banka e Shqipërisë ka të drejtën e mbajtjes dhe të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë. Rezerva valutore i shërben vendit si një garanci për përballimin e goditjeve të paparashikuara në sektorin real apo financiar të ekonomisë. Administrimi i rezervës valutore udhëhiqet nga parimet e kujdesit dhe të ruajtjes së vlerës.
- Banka e Shqipërisë ka të drejtën e hartimit të bilancit të pagesave të Shqipërisë, si dhe organizon dhe drejton sistemin e statistikave të këtij bilanci. Ajo bashkëpunon me agjencitë e tjera statistikore kombëtare për bashkërendimin e aktiviteteve statistikore, si dhe për hartimin dhe përshtatjen e metodologjive statistikore.

Në vëmendjen e Bankës së Shqipërisë janë dhe një sërë detyrash dhe angazhimesh të tjera institucionale si: mbështetja e proceseve integruese të vendit; edukimi financiar i publikut; forcimi i bashkëpunimit me institucione homologe ndërkombëtare; zgjerimi i dijeve dhe pjesëmarrja aktive në debatet akademike etj.

FJALA E GUVERNATORIT

Në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të kontribuojë në promovimin e stabilitetit ekonomik e financiar të vendit edhe gjatë vitit 2014. Nëpërmjet politikës monetare dhe instrumenteve operacionale të realizimit të saj, Banka e Shqipërisë vazhdon të sigurojë një ambient ekonomik me çmime të qëndrueshme. Nëpërmjet mbikëqyrjes dhe rregullimit të vazhdueshëm të sistemit bankar, si dhe nëpërmjet ushtrimit të rolit të saj unik në fushën e emetimit të monedhës dhe të zhvillimit të sistemit të pagesave, ajo ka mbështetur stabilitetin financiar të vendit dhe ka nxitur zhvillimin dhe rritjen e eficiencës së tregjeve financiare. Përmbushja e këtyre objektivave nga Banka e Shqipërisë është një parakusht i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit. Paralelisht me to, gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të punojë edhe për mbështetjen e procesit të integrimit evropian të vendit, për zhvillimin e mëtejshëm institucional të saj, si dhe për përmirësimin e statistikave, të punës kërkimore dhe të komunikimit. Të gjitha këto shtjellohen me detaje dhe vërtetësi në Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2014.

Në këtë fjalë të shkurtër prezantuese, dëshiroj të paraqes mesazhet kryesore të këtij Raporti.

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve.

Ekonomia shqiptare u përball me një ambient të huaj sfidues, me goditje të ofertës të cilat dëmtuan prodhimin në sektorë specifikë dhe me pamundësinë e përdorimit të stimulit fiskal. Pavarësisht këtyre, rritja ekonomike u përmirësua gjatë vitit 2014, në sajë të rritjes së kërkesës së brendshme dhe aktivitetit të sektorit privat. Megjithatë, presionet inflacioniste mbetën të ulëta, duke reflektuar dobësinë ciklike dhe rënien e inflacionit të importuar. Inflacioni mesatar i vitit 2014 rezultoi në nivelin 1.6%. Në këtë ambient me presione të dobëta inflacioniste, karakteri stimulues i politikës monetare u forcua më tej. Norma bazë e interesit zbriti nga 3% në fillim të vitit, në 2.25% në fund të tij. Për përcjelljen e stimulit të saj monetar, Banka e Shqipërisë përdori kuadrin e zakonshëm të instrumenteve të injektimit të likuiditetit si dhe instrumentin e sinjalizimit të kahut të politikës monetare për të ardhmen.

Rritja e stimulit monetar nga Banka e Shqipërisë ndihmoi reduktimin e kostove të financimit dhe zgjerimin e aktivitetit kreditues në lekë, duke mbështetur zgjerimin e kërkesës dhe përshpejtimin e rritjes ekonomike. Këto zhvillime kanë krijuar premisat për kthimin e inflacionit në objektiv në të ardhmen.

Paralelisht me objektivin kryesor, Banka e Shqipërisë ushtron përgjegjësitë e saj ligjore për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sistemit bankar, si dhe për ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit.

Analizat tona dhe ushtrimet e provës së rezistencës tregojnë se sistemi financiar është – në tërësi – i qëndrueshëm. Sistemi bankar ka regjistruar përmirësim të përfitueshmërisë, likuiditet të bollshëm dhe nivele të mira kapitalizimi.

Viti 2014 shënoi ndryshime të rëndësishme në kuadrin rregullator të mbikëqyrjes bankare. Këto ndryshime reflektojnë përmbushjen e rekomandimeve të Programit për Vlerësimin e Sistemit Financiar dhe përshtatjen me parimet ndërkombëtare për një Mbikëqyrje Efektive.

Për të adresuar problemet e kreditimit, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë ndryshimesh rregullative dhe ka iniciuar, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë, disa përmirësime ligjore dhe nënligjore për çështjet e ekzekutimit të kolateralit dhe të trajtimit fiskal të kredive të humbura në bilancet e bankave. Gjithashtu, në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një program i cili synon të mbështesë procesin e ristrukturimit të kredive. Këto masa kanë ndihmuar frenimin e kredive me probleme dhe kanë mbështetur rritjen e kreditimit.

Përpos këtyre objektivave, gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar detyrat e tjera ligjore dhe ka respektuar angazhimet e saj institucionale. Në veçanti, kapacitetet teknike janë përmirësuar më tej, në sajë të punës së vazhdueshme kërkimore dhe shkëmbimit të informacionit e asistencës me partnerët tanë vendas e të huaj.

Banka e Shqipërisë ishte pjesë e një projekti vlerësimi dhe bashkëpunimi të zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane, i cili analizoi kapacitetet institucionale të Bankës së Shqipërisë dhe kuadrin e saj të politikave, të organizimit dhe të drejtimit, në funksion të përafrimit gradual me standardet e Bankës Qendrore Evropiane. Projekti vlerësoi se Banka e Shqipërisë është një institucion transparent dhe i fokusuar, me kapacitete të mira teknike. Në vazhdim, rekomandimet e projektit do të shërbejnë për të orientuar zhvillimin e ardhshëm institucional të Bankës së Shqipërisë, si parapërgatitje për aderimin në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Së fundi, nuk mund të lë pa përmendur edhe një ngjarje të jashtëzakonshme të ndodhur gjatë vitit 2014, e cila ndikoi në aktivitetin e institucionit gjatë gjithë gjysmës së dytë të vitit. Në muajin korrik, Banka e Shqipërisë u vu në dijeni të përvetësimit të një sasie të konsiderueshme vlerash monetare në ambientet e saj, nga punonjës të ngarkuar me ruajtjen dhe përpunimin e tyre. Banka e Shqipërisë bëri transparencë të plotë për ngjarjen dhe, sipas kërkesave ligjore, mbështeti veprimet e organeve të drejtësisë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë mori masa për ruajtjen e qetësisë së tregjeve financiare dhe për mbarëvajtjen normale të sistemit bankar. Duke qëndruar në këtë plan, dëshiroj të siguroj publikun se Banka e Shqipërisë po merr të gjitha ndryshimet e nevojshme rregullative dhe operacionale që ngjarje të tilla të mos përsëriten më.

I nderuar lexues,

Besoj se leximi i këtij Raporti do t'ju mundësojë të krijoni një ide të plotë mbi punën dhe arritjet e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2014. Për të ardhmen, jam i bindur se platforma e zhvillimit, rezultatet e punës sonë, dedikimi dhe përkushtimi i stafit profesional të Bankës, do të rikuperojnë dhe do të ngrenë më lart besimin e publikut tek ky institucion.

Gent SEJKO

Guvernator

NGJARJET KRYESORE TË VITIT

- Prodhimi i brendshëm bruto vlerësohet të jetë rritur me 1.4% gjatë nëntëmujorit të parë, duke shënuar përmirësim nga viti paraardhës. Ecuria e përmirësuar e investimeve dhe e konsumit privat u mbështet në rritjen e besimit në ekonomi dhe kushtet më të mira të financimit. Nga ana tjetër, ambienti i jashtëm ekonomik vazhdoi të mbetet i pafavorshëm.
- Norma mesatare vjetore e inflacionit rezultoi 1.6% për vitin 2014, duke mbetur poshtë objektivit 3.0% të Bankës së Shqipërisë. Në prani të presioneve të ulëta inflacioniste nga ana e kërkesës, rënia e inflacionit në tregjet botërore solli reduktimin e inflacionit në vend në krahasim me vitin e kaluar.
- Në një ambient ekonomik me inflacion të ulët dhe me rritje të ekonomisë nën potencial, Banka e Shqipërisë vijoi të ndjekë një politikë monetare stimuluese. Këshilli Mbikëqyrës reduktoi normën bazë të interesit në muajt shkurt, maj dhe nëntor. Në fund të vitit, norma bazë zbriti në nivelin 2.25%.
- Politika fiskale ka pasur një natyrë konsoliduese gjatë vitit 2014. Niveli i lartë i borxhit publik nuk lë hapësirë për ndjekjen e një politike fiskale stimuluese.
- Ecuria e sektorit bankar vlerësohet e qëndrueshme. Rezultati financiar shfaqi përmirësim dhe treguesit e kapitalizimit e të likuiditetit të veprimtarisë janë në nivele të qëndrueshme. Sektori bankar mbetet relativisht i mbrojtur nga rreziku direkt i tregut, ndërsa është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.
- Kuadri rregullator i mbikëqyrjes bankare u përmirësua më tej, me qëllim përshtatjen me parimet e Komitetit të Bazelit për një Mbikëqyrje Efektive dhe plotësimin e rekomandimeve që rrjedhin nga Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar.
- Gjatë vitit, është rishikuar baza rregullatore e sistemit të pagesave, si dhe është realizuar përditësimi teknik i infrastrukturës ekzistuese të sistemeve të pagesave. Ndryshimet rregullatore synojnë përafrimin me praktikat evropiane dhe me parimet ndërkombëtare për Mbikëqyrjen e Infrastrukturës së Tregjeve Financiare.
- Me mbështetjen e Bankës Botërore, në muajin maj u finalizua projekti për vënien në zbatim të Sistemit të Administrimit të Portofolit. Me zbatimin e tij, krijohen kushte pune më të përshtatshme, për një kontroll më të mirë të rreziqeve që hasen gjatë procesit të administrimit të rezervës valutore.
- Në muajin qershor, Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kjo ngjarje pritet të reduktojë më tej primet e rrezikut dhe do të shërbejë si një ankorë besimi për investitorët e huaj.

- Më 28 shkurt 2014, Bordi Ekzekutiv i FMN-së miratoi marrëveshjen trevjeçare prej 295.42 milionë SDR (rreth 330.9 milionë Euro), nën programin *Extended-Fund Facility* për Shqipërinë. Marrëveshja synon mbështetjen e konsolidimit fiskal afatmesëm, lehtësimin e rreziqeve lidhur me borxhin e lartë publik dhe rregullimin e ekonomisë në periudhën afatshkurtër.
- Gjatë periudhës prill-shtator u zbatua projekti për identifikimin e nevojave të Bankës së Shqipërisë, i udhëhequr nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Raporti vlerëson se Banka e Shqipërisë është një institucion transparent dhe i fokusuar, me kapacitete të mira teknike. Rekomandimet e propozuara do të shërbejnë si udhëzues për Bankën e Shqipërisë, për përafrimin me standardet dhe parimet evropiane.
- Në muajin korrik, Banka e Shqipërisë u vu në dijeni të përvetësimit të një sasie të konsiderueshme vlerash monetare në ambientet e saj, nga punonjësit që i kishin në ngarkim. Banka e Shqipërisë bëri transparencë të plotë për ngjarjen dhe, sipas kërkesave ligjore, mbështeti veprimet proceduriale të organeve të drejtësisë, si dhe mori masat për administrimin e situatës. Këto masa siguruan funksionimin normal të tregjeve financiare.

02

05
39

STRUKTURA ORGANIZATIVE E BANKËS SË SHQIPËRISË



I. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Procesi i vendimmarrjes në Bankën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimet e pavarësisë dhe transparencës.

Veprimtaria e Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2014 është ushtruar në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin për Bankën e Shqipërisë dhe procedurat e parashikuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këtij organi.

Këshilli zhvilloi 16 mbledhje të zakonshme, prej të cilave, 12 ishin për shqyrtimin dhe miratimin e raporteve të politikës monetare. Këto mbledhje janë shoqëruar edhe me vendimmarrjet përkatëse të politikës monetare.

Gjatë vitit 2014 janë marrë 80 vendime, nga të cilat 56 ishin akte të miratuara për herë të parë dhe 24 ndryshime ose plotësime aktesh ekzistuese. Përmirësimi i qeverisjes ka qenë në qendër të veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës. Për këtë qëllim janë miratuar shtatë rregullore të brendshme për organizimin dhe funksionimin e departamenteve.

Në përmbushje të detyrës së tij, Këshilli ka analizuar në vazhdimësi informacionet periodike mbi zbatimin e politikave të administrimit të institucionit, përfshirë edhe mënyrat dhe procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të institucionit. Çdo muaj janë marrë në shqyrtim raportet për pozicionin dhe rezultatin financiar të institucionit, ndërkohë që çdo tre muaj, janë shqyrtuar raportet për kryerjen e investimeve dhe të ardhmen e tyre. Këshilli ka marrë në analizë çdo muaj edhe raportet e Komitetit të Investimit mbi ecurinë e rezervës valutore, investimin dhe kthimin prej tij. Në muajin dhjetor 2014, Këshilli Mbikëqyrës, pasi vlerësoi përgjegjshmërinë me të cilën departamentet rishikuan në ulje buxhetet e tyre përkatëse, miratoi buxhetin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2015.

Këshilli është informuar rregullisht nëpërmjet raporteve tremujore të Inspektorit të Përgjithshëm në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e kontrolleve të kryera nga Departamenti i Kontrollit, mbi efektivitetin dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të administrimit të rrezikut dhe të drejtimit të Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2014, me qëllim forcimin e efikasitetit të kontrollit të jashtëm, Këshilli ndryshoi procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e tij. Procedura e re u zbatua në përzgjedhjen e kontrollorit të jashtëm për periudhën 2014-2018.

Në muajin korrik 2014, Këshilli Mbikëqyrës, krijoi Komitetin e Auditit, në përputhje me rekomandimet e lëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në përbërje të këtij Komiteti janë 5 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës me

funksione joekzekutive në Bankën e Shqipërisë. Ky Komitet do të asistojë Këshillin Mbikëqyrës për të ushtruar më mirë përgjegjësitë e tij në lidhje me administrimin financiar të institucionit, me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe me respektimin e ligjit, akteve nënligjore dhe kodit të etikës së Bankës së Shqipërisë. Këshilli është njohur edhe me gjetjet dhe rekomandimet e raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2013 si dhe me masat e marra nga departamentet për adresimin e tyre.

Në përmbushje të detyrimeve të veta ligjore mbi llogaridhënien dhe transparencën, Këshilli miratoi raportin vjetor të Bankës së Shqipërisë, i cili mbulonte operacionet e institucionit gjatë vitit 2013 dhe pasqyrat financiare të audituara nga kontrollori i jashtëm.

Gjithashtu, Këshilli ka miratuar 4 raporte tremujore të politikës monetare dhe 2 raporte gjashtëmujore të stabilitetit financiar, të cilat i janë paraqitur Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore.

Në veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, një vend të rëndësishëm ka zënë adresimi me përgjegjësi i ngjarjes së ndodhur në Departamentin e Emisionit. Pas konstatimit të përvetësimit të vlerave monetare nga ana e dy ish-punonjësve të Bankës së Shqipërisë, Këshilli ka zhvilluar një aktivitet intensiv mbledhjesh të jashtëzakonshme, ku janë vendosur masat që duheshin ndërmarrë dhe është monitoruar zbatimi i tyre, përfshirë dhe veprimtaria e administratorëve dhe e personelit për normalizimin e situatës.

Nga muaji shtator, pas shkarkimit nga detyra të zotit Ardian Fullani dhe dorëheqjes së zotit Adrian Civici, Këshilli Mbikëqyrës, ka vepruar me 5 anëtarë. Në muajin dhjetor 2014, Kuvendi emëroi tre anëtarë të rinj të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: zonjën Natasha Ahmetaj, zotin Tonin Kola dhe zotin Gent Sejko. Në përfundim të vitit, Këshilli Mbikëqyrës kishte në përbërje tetë anëtarë, nga nëntë që parashikon ligji "Për Bankën e Shqipërisë".

II. BANKA E SHQIPËRISË GJATË VITIT 2014

II. 1. AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE POLITIKA MONETARE

- *Aktiviteti ekonomik dhe treguesit e stabilitetit ekonomik e financiar shënuan përmirësime në vitin 2014. Të dhënat e INSTAT-it për tre tremujorët e parë dhe vlerësimet e Bankës së Shqipërisë për tremujorin e katërt tregojnë se rritja ekonomike ishte më e lartë se ajo e vitit paraardhës dhe u mbështet kryesisht nga gjallërimi i kërkesës së brendshme. Megjithatë, ekonomia shqiptare vazhdoi të operojë me kapacitet jo të plotë dhe u përball me një ambient të jashtëm të pafavorshëm. Dobësia ciklike e kërkesës dhe prirja në rënie e inflacionit të importuar kanë krijuar një mjedis me presione të dobëta për rritjen e çmimeve të konsumit. Normat e inflacionit dhe pritjet inflacioniste vazhduan të qëndrojnë në nivele të ulëta, nën objektivin 3.0% të Bankës së Shqipërisë. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, politika monetare theksoi natyrën stimuluese. Banka e Shqipërisë uli tre herë normën bazë të interesit, sinjalizoi tregjet për ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare në të ardhmen dhe vijoi të injektojë likuiditet. Politika monetare ka kontribuar në krijimin e një ambienti ekonomik likuid dhe me norma të ulëta interesi, duke siguruar kushtet e duhura monetare për nxitjen e kërkesës dhe ruajtjen e inflacionit pranë objektivit 3.0% të Bankës së Shqipërisë në periudhën afatmesme.*

II.1.1. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE

Ekonomia botërore shënoi një ritëm pozitiv rritjeje në vitin 2014, ndonëse ai qëndroi më poshtë se parashikimet fillestare dhe pritjet e agjentëve ekonomikë. Rritja ekonomike është forcuar në ShBA; ajo ka vijuar të shënojë norma modeste rritjeje në zonën euro, ndërkohë që ekonomitë në zhvillim kanë shfaqur një ecuri jo të njëtrajtshme dhe shumë prej tyre kanë pasur tkurrje të aktivitetit ekonomik. Bankat kryesore qendrore kanë vijuar të ndjekin politika monetare lehtësuese, duke ndihmuar përmirësimin e likuiditetit të tregjeve financiare dhe duke mbështetur rritjen e aktivitetit ekonomik. Nga ana tjetër, çmimi i naftës, çmimet e ushqimeve dhe çmimet e produkteve energjetike kanë ardhur në rënie, duke u përcjellë në nivele të ulëta inflacioni në rang botëror. Së fundi, tregtia botërore është ngadalësuar gjatë këtij viti dhe ka mbetur poshtë niveleve të regjistruara gjatë vitit 2013. Pavarësisht zhvillimeve pozitive, tregjet dhe ekonomia botërore mbeten të rrethuara nga elementë pasigurie, të lidhur si me tensionet gjeopolitike në disa rajone ashtu edhe me efektet e krizës që vijojnë të jenë ende të pranishme.

Pjesa e parë e vitit u karakterizua nga një rritje ekonomike e qëndrueshme e shteteve të zhvilluara, por ritmi i rritjes së këtyre ekonomive humbi forcë në tremujorin e tretë. Treguesit paraprijës të dinamikës së PBB-së të ekonomive të zhvilluara, si edhe ata të besimit të biznesit dhe të individëve, janë shfaqur pozitivë në tremujorin e fundit, duke mbështetur gjykimin për një rritje ekonomike më të fortë në këtë periudhë. Efektet frenuese të politikave konsoliduese fiskale në shumë shtete të zhvilluara janë zbutur. Norma e papunësisë në zonën euro është ulur për herë të parë pas vitit 2008, por ajo mbetet ende e lartë dhe shfaqet e përqendruar në grupmoshën e re.

Situata ekonomike në vendet kryesore partnere ka qenë në përmirësim të lehtë. Ekonomia italiane është futur në recesion në tremujorin e dytë, por tkurrja vjetore për vitin 2014 pritet të jetë më e ulët se ajo e vitit të kaluar. Ekonomia e Greqisë doli nga recesioni në tremujorin e dytë të vitit dhe parashikohet të kalojë në territor pozitiv për vitin 2014. Presionet inflacioniste kanë qenë të ulëta në këto dy vende, duke regjistruar edhe norma negative gjatë vitit.

Prirja rënëse e primeve të rrezikut në tregjet financiare ka vijuar edhe gjatë këtij viti, duke reflektuar politikat monetare lehtësuese dhe rezultatet e arritura në drejtim të konsolidimit fiskal. Normat e interesit janë ulur në zonën euro, ndërkohë që vlerësimi i investuesve ndaj ekonomive të Evropës Juglindore ka qenë më pozitiv. Megjithatë, këto zhvillime nuk janë përkthyer në rritje të dukshme të flukseve investuese, duke ilustruar dhe një herë oreksin e ulët të tregjeve financiare për investime dhe gjendjen akoma të brishtë të ripërtëritjes.

Tabelë 1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë

Shtetet	Ndryshimi i PBB-së		Norma e papunësisë (mesatare)		Norma e inflacionit (mesatare)	
	2013	2014[2]	2013	2014	2013	2014
ShBA	2.2	2.4	7.4	6.2	1.5	0.8
Eurozonë	-0.4	0.9	12	11.6	1.3	0.4
Gjermani	0.1	1.5	5.2	5.0	1.6	0.8
Francë	0.2	0.4	10.3	10.2	1.0	0.6
Itali	-1.9	-0.4	12.2	12.8	1.3	0.2
Greqi	-3.9	0.9	27.5	26.7[2]	-0.9	-1.4
Mbretëri e Bashkuar	1.7	1.9	7.6[1]	6.3[2]	2.6	1.5

Burimi: Eurostat, institutet statistikore përkatëse.
[1] Parashikuar dhe vlerësuar paraprakisht nga institutet kryesore ekonomike.
[2] Vlerësim paraprak.

Politika monetare dhe tregjet financiare

Bankat qendrore kryesore kanë lënë të pandryshuara normat bazë të interesit gjatë vitit 2014. Përjashtim nga kjo sjellje bën Banka Qendrore Evropiane, e cila e ka ulur dy herë, me nga 0.25 pikë përqindje, normën bazë të interesit, duke e çuar atë në nivelin 0.05%. Normat bazë të interesit në bankat e tjera qendrore qëndrojnë përkatësisht në nivelet: Rezerva Federale në 0-0.25%, Banka e Anglisë në 0.5% dhe Banka e Japonisë në 0-0.1%.

Grafik 1. Ecuria e normave bazë të interesit



Burimi: BQE, FED, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë.

Ulja e normës bazë nga BQE-ja, si dhe zbatimi i programeve speciale të injektimit të likuiditetit nga BQE-ja dhe të lehtësimit sasior nga Rezerva Federale, kanë ndikuar në uljen e pasigurisë dhe në reduktimin e normave të interesit në tregjet financiare. Duke përjashtuar Greqinë, titujt e borxhit të shteteve të Eurozonës janë karakterizuar nga ulje e *spread*-eve dhe e primeve të rrezikut. Megjithatë, ulja e primeve të kërkuara në tregjet e kapitaleve nuk është shoqëruar me ulje të përgjithshme të normave të interesave për kreditimin e ekonomisë. Ecuria e këtyre normave ka ndryshuar në varësi të madhësisë së biznesit, duke favorizuar firmat dhe subjektet e mëdha. Ndërkohë për bizneset e vogla dhe familjet, uljet kanë qenë të vogla ose kanë munguar. Në terma vlerësimi, përqasja e investuesve të huaj ndaj vendeve të EQJL-së ka qenë më pozitive, duke shënuar ulje të *yield*-eve dhe të primeve të sigurimit (CDS) të kërkuar, por nivelet e flukseve investuese mbeten poshtë niveleve historike.

Grafik 2. Ecuria e kursit të këmbimit dhe e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare



Burimi: BQE, Reuters.

Normat mesatare të interesit euribor me afat 1-, 3-, 6- dhe 12- mujor, shënuan respektivisht vlerat 0.13%, 0.21%, 0.31% dhe 0.48% gjatë vitit 2014, duke regjistruar një ulje mesatare prej 0.03 pikësh përqindje nga viti i kaluar. Norma e interesit Libor me afat 3-mujor për dollarin amerikan u ul në 0.23%, nga 0.27% që ishte një vit më parë.

Në tregun valutor, euro është nënçmuar lehtë në terma mesatarë ndaj paundit britanik dhe ndaj frangës zvicerane, ndërkohë që ka fituar terren ndaj jenit japonez dhe renminbisë kineze. Në terma dypalëshe, vlera mesatare e euros për vitin 2014 (1.328 usd) ka qenë e njëjtë me atë të vitit 2013, por muajt

e fundit monedha e përbashkët zbriti nën nivelin 1.200 usd, duke shënuar një nënçmim prej 10% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo sjellje ka faktorizuar efektet e politikës lehtësuese të BQE-së dhe bindjen e tregut për fillimin e afërt të programit të lehtësimit sasior (e verifikuar më pas në muajin janar 2015).

Grafik 3. Çmimi i naftës dhe i ushqimeve në tregun ndërkombëtar (ndryshim vjetor i indekseve)



Burimi: EIA dhe FMN.

Ecuria e çmimeve në tregjet botërore

Çmimet e lëndëve të para në tregun botëror kanë pësuar një rënie të dukshme gjatë vitit 2014. Indeksi i Evropës për naftën - Brent - u tkurr me 8.8% në terma vjetorë, duke shënuar një rënie edhe më të shpejtë në tremujorin e fundit. Çmimi mesatar për një fuçi naftë për vitin 2014 u luhat ndjeshëm brenda intervalit 112 - 62 dollarë amerikanë, duke arritur në muajin dhjetor vlerën më të ulët të regjistruar në pesë vitet e fundit. Këto zhvillime u diktuan kryesisht nga rritja e vazhdueshme e prodhimit të naftës argjilore në ShBA, nga furnizimi i bollshëm nga shtetet e OPEC-ut, si dhe nga kërkesa e përmbajtur për naftë në nivel botëror.

I ndikuar më së shumti nga dinamikat e tregut të naftës, indeksi i FMN-së për çmimet e mallrave kryesore ka ndjekur një trajektore në rënie. Në linjë me forcimin e dollarit në tregjet valutore, ofertën e gjerë dhe mungesën e presioneve nga ana e kërkesës, çmimet e ushqimeve u tkurrën me 4.1% në krahasim me vitin 2013.

II.1.2. ZHVILLIMET EKONOMIKE NË VEND

Ekonomia shqiptare shënoi një aktivitet të përmirësuar ekonomik në vitin 2014. Sipas të dhënave të INSTAT-it, vlera e shtuar bruto u rrit me 1.4% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit dhe treguesit e tërthortë sugjerojnë se ajo është përshpejtuar më tej në tremujorin e katërt. Treguesit e stabilitetit të përgjithshëm ekonomik e financiar të vendit shënuan përgjithësisht përmirësime, ndonëse ekonomia shqiptare vazhdon të operojë me kapacitet jo të plotë dhe të përballet me një ambient të jashtëm të pafavorshëm. Në aspektin makroekonomik, inflacioni dhe pritjet inflacioniste vazhduan të qëndrojnë në nivele të ulëta. Në sferën e financave publike, viti 2014 u karakterizua nga një politikë fiskale konsoliduese. Të ardhurat fiskale u rritën dhe, duke përjashtuar pagimin e detyrimeve të prapambetura, deficiti buxhetor u reduktua. Në sferën e marrëdhënieve ekonomike e financiare me jashtë, viti 2014 nuk shënoi ndryshim të trajektoreve të mëparshme. Deficiti i llogarisë korrente u rrit, por bilanci i pagesave rezultoi pozitiv dhe kursi i këmbimit u shfaq i qëndrueshëm. Në aspektin financiar, ekonomia shqiptare dhe sistemi i saj financiar njohën progres gjatë vitit 2014, në drejtim të përmirësimit të treguesve të likuiditetit, të përfitueshmërisë dhe të cilësisë së aktiveve. Megjithatë, aktiviteti ndërmjetësues i sektorit bankar mbetet i ulët dhe bilancet e tij vazhdojnë të vuajnë nga kreditë me probleme.

Vlerësimet e Bankës së Shqipërisë sugjerojnë se rritja ekonomike e vitit 2014 do të jetë më e lartë se ajo e vitit paraardhës. Kjo rritje është mbështetur në masën më të madhe nga rritja e konsumit dhe e investimeve private, si pasojë e përmirësimit të besimit të biznesit e të konsumatorit, përmirësimit të bilanceve në sektorin privat dhe kushteve më të mira të financimit. Politika konsoliduese fiskale rezultoi në reduktimin e stimulit fiskal dhe kërkesa e huaj nuk ndihmoi rritjen ekonomike. Problemet ekonomike të partnerëve tanë tregtarë nuk favorizuan rritjen e kërkesës për mallra e shërbime shqiptare; në prani edhe të disa goditjeve të ofertës ato u reflektuan në një rritje të ulët të eksporteve tona.

Ndonëse në rritje, kërkesa agregate ishte e pamjaftueshme për të vënë në shfrytëzim të plotë kapacitetet prodhuese të ekonomisë. Dobësia ciklike e kërkesës ka krijuar një mjedis ekonomik me presione të dobëta për rritjen e pagave, të kostove të punës, të marzheve të fitimit dhe të inflacionit të çmimeve të konsumit. Gjithashtu, inflacioni i importuar erdhi në rënie dhe shtoi presionet disinflacioniste në ekonomi. Për rrjedhojë, inflacioni i çmimeve të konsumit regjistroi një vlerë mesatare prej 1.6% gjatë vitit 2014, duke mbetur nën objektivin e Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 2. Disa tregues të ekonomisë në vite

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Inflacioni (vit mbi vit, mesatare periudhe)							
Inflacioni total (në %)	3.36	2.28	3.56	3.45	2.04	1.94	1.63
Rritja ekonomike							
Rritja reale e PBB-së (në %)[1]	7.5	3.70	3.75	3.17	1.00	1.45	1.45
PBB (me çmime korrente, në milionë lekë)	1,080,676	1,143,936	1,239,645	1,300,624	1,335,488	1,364,781	
Tregu i punës							
Numri i të punësuarve (në mijë)	974.1	909.8	895.7	948.0	962.4	926.6	947.0
Norma e papunësisë[2]	12.7	13.6	13.8	13.1	12.8	13.4	12.9
Norma e papunësisë sipas anketës[3]	13.2	13.8	14.2	14.3	13.9	16.10	17.40
Sektori fiskal							
Balanca buxhetore (me grantet, në % të PBB-së)	-5.6	-7.1	-3.1	-3.5	-3.4	-4.9	-5.1
Të ardhurat buxhetore (në % të PBB-së)	26.9	26.1	26.2	25.4	24.7	24	25.9
Shpenzimet buxhetore (në % të PBB-së)	32.5	33.2	29.3	28.9	28.2	28.9	31
Sektori i jashtëm							
Llogaria korrente (në % të PBBsë)	-15.7	-15.4	-11.3	-13.2	-10.2	-10.6	-12.1
Importet në mallra (fob, në % të PBB-së)	38	35.3	36.2	39.4	36.7	35.7	36.6
Eksportet në mallra (fob, në % të PBB-së)	10.4	8.7	13	15.2	15.9	18.2	18.6
Investimet e huaja direkte (hyrëse, në % të PBB-së)	7.6	8.3	8.8	6.8	6.9	9.7	8.3
Mjetet e rezervës valutore (milionë euro, fund periudhe)	1,675	1,646	1,904	1,912	1,972	2,015	2,192
Sektori monetar e financiar							
Norma e repo-s (fund periudhe)	6.25	5.25	5	4.75	4	3	2.25
Agregati M3 (rritje vjetore, fund periudhe)	7.7	6.8	12.5	9.2	5	2.3	4
Kredia për sektorin privat (rritje vjetore, fund periudhe)	32.1	10.3	10.1	10.4	1.4	-1.4	2.0
Yield-i 12-mujor (mesatare vjetore)	8.16	9.17	7.98	7.34	7.03	5.16	3.41
Kursi mesatar i këmbimit, lek/usd	83.9	95	103.9	100.8	108.2	105.7	105.5
Kursi mesatar i këmbimit, lek/euro	122.8	132.1	137.8	140.3	139	140.3	140.0
Kursi nominal efektiv, NEER	99.7	107.1	113.4	113.8	113.3	113.7	112.2

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, vlerësime të FMN-së dhe Banka e Shqipërisë.

[1] *Për vitin 2012, të dhënat janë gjysmë finale dhe për vitin 2013 të dhënat janë paraprake. Për vitin 2014, shifra është rritje vjetore e nëntëmujorit. Për të dhënat e tregut të punës dhe sektorit të jashtëm, të dhënat i përkasin fundit të tremujorit të tretë.*

[2] *Sipas të dhënave administrative, INSTAT.*

[3] *"Rezultate të Anketës së Forcave të Punës", INSTAT.*

* *Raportet e treguesve ndaj PBB-së mbështeten në projeksione vjetore.*

Në përgjigje të presioneve të ulëta inflacioniste dhe të dobësisë ciklike të ekonomisë, Banka e Shqipërisë theksoi më tej natyrën stimuluese të politikës së saj monetare. Banka e Shqipërisë uli tre herë normën bazë të interesit, furnizoi me likuiditetin e nevojshëm sistemin bankar dhe sinjalizoi tregjet për ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare në të ardhmen. Forcimi i stimulit monetar në ekonomi u krye paralelisht me ndjekjen e një politike fiskale konsoliduese. Të kushtëzuara nga niveli i lartë i borxhit publik, hapësirat për ndjekjen e një politike fiskale stimuluese mbeten të pakta. Megjithatë, korrektimi fiskal ka kontribuar në reduktimin e primeve të rrezikut dhe në zgjerimin e hapësirave të sektorit privat për financim. Gjithashtu, pagimi i detyrimeve të prapambetura ka ndihmuar në përmirësimin e bilanceve të sektorit privat të ekonomisë.

Politika monetare dhe operacionet e administrimit të likuiditetit kontribuan në krijimin e një ambienti ekonomik likuid dhe me norma të ulëta interesi, duke iu përgjigjur në kohë rreziqeve ndaj stabilitetit të çmimeve dhe duke siguruar kushtet e duhura monetare për nxitjen e kërkesës. Në përgjigje të saj, kostot e financimit të sektorit privat dhe publik zbritën në nivelet e tyre minimale historike dhe aktiviteti kreditues në lekë u zgjerua, duke mbështetur më mirë kërkesën e brendshme. Përdorimi në rritje i kredisë bankare dhe ulja e kostos së saj, ndihmuan në stimulimin e kërkesës së brendshme dhe u reflektuan në prirjen rritëse të inflacionit bazë gjatë vitit.

Përtej nxitjes së kërkesës së brendshme, tejçimi i stimujve monetarë në ekonomi pati rrjedhoja pozitive edhe në treguesit e shëndetit financiar. Frenimi i rritjes së kredive me probleme, përmirësimi i likuiditetit në sistem, ruajtja e bilanceve të shëndosha të sektorit financiar të ekonomisë si dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit, kanë ndihmuar stabilitetin financiar të vendit.

II.1.3. AKTIVITETI EKONOMIK DHE RRITJA EKONOMIKE

Viti 2014 u karakterizua nga rikuperimi gradual i aktivitetit ekonomik

Aktiviteti ekonomik në vend shënoi përmirësim gjatë vitit 2014.[1] Sipas të dhënave të INSTAT-it, vlera e shtuar bruto[2] u rrit me 1.4% gjatë nëntë muajve të parë të vitit dhe të dhënat e tërthorta të disponuara sugjerojnë një rritje më të shpejtë në tremujorin e katërt. Rritja ekonomike u udhëhoq nga rritja e konsumit dhe e investimeve private dhe u reflektua më së shumti në zgjerimin e aktivitetit të sektorit të shërbimeve. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik nuk ishte i njëtrajtshëm[3] gjatë vitit, duke pasqyruar efektet bazë të krahasimit, goditjet e përkohshme të ofertës, por edhe luhatjet e treguesve fiskalë gjatë tremujorëve.

---

[1] *Analiza e aktivitetit ekonomik sipas sektorëve mbulohet me të dhëna direkte statistikore vetëm për tre tremujorët e parë të vitit 2014.*

[2] *Në mungesë të të dhënave mbi prodhimin e brendshëm bruto, ecuria ekonomike për vitin 2014 shqyrtohet në terma të vlerës së shtuar reale me frekuencë tremujore.*

[3] *Normat vjetore të rritjes së vlerës së shtuar ishin përkatësisht 1.4%, -0.4% dhe 3.3% në tremujorët e parë, të dytë dhe të tretë të vitit.*

Grafik 4. Ecuria vjetore e PBB-së reale (në %) dhe kontributet e komponentëve të vlerësuar nga ana e prodhimit (në pikë përqindje). Tendenca e vlerës së shtuar bruto reale në ekonomi dhe në sektorë*



*Indekset e vlerës së shtuar bruto reale për ekonominë dhe sektorët e saj pasqyrojnë tendencën e vlerës së shtuar përkatëse, të llogaritur si shumë rrëshkitëse e vlerave tremujore të katër tremujorëve, të bazuar në tremujorin e katërt të vitit 2010.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në ndryshim nga një vit më parë, performanca e ekonomisë u drejtua nga sektori i shërbimeve[4], ndërkohë që sektori prodhues dha një kontribut më të ulët në rritje. Aktiviteti i sektorit të shërbimeve shfaqi tendencë përmirësimi gjatë vitit, duke kontribuar me 1.2 pikë përqindje në rritjen e vlerës së shtuar gjatë nëntë muajve të parë. Ndër degët e shërbimeve, kontributin më të lartë në rritje e dhanë "Shërbimet e tjera"[5] dhe "Tregtia, hotelet dhe restorantet". Sektori prodhues kontribuoi me 0.2 pikë përqindje në rritjen e vlerës së shtuar totale në ekonomi, por ky kontribut ishte rreth 1 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Prodhimi bujqësor[6] dhe ai industrial[7] llogaritet të kenë kontribuar me 1 pikë përqindje në rritje. Ndërkohë, dobësia e shfaqur nga sektori ndërtues[8] u përkthye në një kontribut negativ prej rreth 0.8 pikësh përqindje në rritjen vjetore të vlerës së shtuar totale.

Përmirësimi i aktivitetit ekonomik u reflektua edhe në treguesit e tregut të punës. Shkalla e punësimit dhe ajo e pjesëmarrjes në forcën e aftë për punë

---

[4] *Sektori i shërbimeve përfshin degët "Tregti, hotele dhe restorante", "Transport", "Postë dhe komunikacion" dhe "Shërbime të tjera". Aktivitetet e përfshira në shërbimet e tjera grupohen në: "Aktivitete financiare", "Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet", "Administrata publike dhe e mbrojtjes", "Arsimi", "Shëndetësia", "Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale".*

[5] *Ecuria e degës së shërbimeve të tjera reflektoi zhvillimet më pozitive në shërbimet e shëndetësisë dhe shërbimet e tjera kolektive, sociale dhe personale.*

[6] *Vlera e shtuar në ekonomi nga sektori bujqësor shënoi rritje me mesatarisht 2.3%, por mbeti nën mesataren historike të zgjerimit, të luhatur në rreth 5% për vitet 2010-2013.*

[7] *Zgjerimi me ritme të larta i vlerës së shtuar nga industria nxjerrëse u zbeh nga kontraktimi i prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit e ujit. Kjo rezultoi në një kontribut të sektorit industrial prej rreth 0.4 pikë përqindje për rritjen vjetore të vlerës së shtuar totale, më e ulët krahasuar me kontributin 1.1 pikë përqindje të dhënë në të njëjtën periudhë të një viti më parë.*

[8] *Vlera e shtuar në sektorin e ndërtimit shfaqi luhatje të forta nëpër tremujorë. Rënia e lartë e vlerës së shtuar në aktivitetin ndërtues gjatë tremujorit të dytë e zbehu performancën pozitive të tremujorit të tretë. Zhvillimet më pozitive të këtij sektori në tremujorin e tretë janë pasojë edhe e efektit bazë në krahasim, dhënies së një numri më të madh lejesh ndërtimi në këtë tremujor, si edhe ndikimit pozitiv të lidhur me shlyerjen nga qeveria të pagesave të prapambetura ndaj kompanive ndërtuese për projektet infrastrukturore të realizuara.*

shënuan një rritje vjetore prej 3.7 dhe 4.8 pikësh përqindje në fund të tremujorit të tretë të vitit. Për zhvillime pozitive në tregun e punës flasin edhe të dhënat administrative. Me gjithë përmirësimet e vërejtura, tregu i punës karakterizohet nga kapacitete të lira të shprehura në normën ende të lartë të papunësisë.

Grafik 5. Ecuria e shkallës së papunësisë (në përqindje)



Burimi: INSTAT.

KËRKESA AGREGATE DHE RRITJA EKONOMIKE

Rritja ekonomike u mbështet nga kërkesa e brendshme e sektorit privat. Përmirësimi i treguesve të besimit, i bilanceve dhe kushtet monetare stimuluese kanë ndihmuar në rikuperimin e saj gjatë vitit 2014.

Nga pikëpamja e kërkesës agregate, rritja ekonomike u mbështet nga kërkesa e sektorit privat, ndërsa stimuli fiskal dhe kërkesa e huaj rezultuan të dobët. Të dhënat e përftuara tregojnë se të dy komponentët e kërkesës së brendshme private, konsumi dhe investimet, dhanë kontribut pozitiv në rritje, sidomos në gjashtëmujorin e dytë. Për herë të parë prej shumë vitesh, treguesi i ndjesisë ekonomike u rrit në mënyrë progresive gjatë tremujorëve dhe qëndroi rreth mesatares historike në tremujorin e katërt.

Grafik 6. Ecuria e kërkesës së sektorit privat (ndryshim vjetor në përqindje) dhe e treguesit të ndjesisë ekonomike, TNE (mesatare afatgjatë=100)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Rritja e konsumit privat - komponentit me peshën kryesore në kërkesën agregate - u reflektua në rritjen e shpenzimeve për mallra të përditshme dhe në rritjen e kërkesës për shërbime. Rritja e konsumit të mallrave të përditshme sugjerohet nga rritja e indeksit të tregtisë me pakicë (me 5.4% gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2014) dhe rritja e treguesit të besimit në tregti në tremujorin e katërt. Nga ana tjetër, konsumi i mallrave të qëndrueshme nuk ka shënuar rritje. Pavarësisht përmirësimit në tremujorin e tretë, vrojtimi i besimit të konsumatorit raporton se balanca e "blerjeve të mëdha" ka mbetur poshtë mesatares historike. Preferenca për mallra konsumi të importuara ka vijuar të bjerë gjatë vitit.[9]

Konsumi privat u ndikua pozitivisht nga rritja e besimit, nga zhvillimet pozitive në tregun e punës dhe nga normat e ulëta të inflacionit që mbështesin të ardhurën reale. Rritja e kredisë konsumatore, lehtësimi i standardeve të kreditimit dhe rritja e të ardhurave në formën e remitancave, kanë ndikuar pozitivisht financimin e konsumit. Nga ana tjetër, ecuria nën potencial e treguesit të punësimit dhe

[9] *Vrojtimet e besimit tregojnë zhvendosje të preferencës së konsumatorit shqiptar drejt mallrave të prodhuara në vend.*

rritja e ngadaltë e pagave i ka bërë konsumatorët më të kujdesshëm në kryerjen e shpenzimeve. Për këtë arsye, rikuperimi i qëndrueshëm i konsumit privat vazhdon të mbetet i pakonsoliduar.

Grafik 7. Tregues të tërthortë të konsumit privat



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Investimet private u rritën gjatë vitit, si pasojë e besimit të përmirësuar të bizneseve, rikuperimit të kërkesës konsumatore dhe përmirësimit të likuiditetit të sektorit privat, në reflektim të shlyerjes së pagesave të prapambetura të qeverisë. Gjallërimi i kërkesës për produktet finale të bizneseve ka ndikuar në përmirësimin e situatës së tyre financiare dhe në rritjen e vazhduar të normës së shfrytëzimit të kapaciteteve. Bazuar në të dhënat e llogarive kombëtare, investimet në sektorin e ndërtimit shënuan një kthesë drejt rritjes në tremujorin e tretë të vitit. Gjithashtu rritja e importit të makinerive dhe pajisjeve, rritja e porosive dhe përmirësimi i balancës së investimeve në vrojtimin e besimit, tregojnë rikuperimin e këtij komponenti të kërkesës agregate edhe në tremujorin e katërt të vitit.

Grafik 8. Tregues përafrues të investimeve private



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 1: EKONOMIA SHQIPTARE NË KËNDVËSHTRIMIN E BIZNESEVE DHE TË KONSUMATORËVE

Nëpërmjet pyetjeve cilësore,[1] vrojtimet e besimit mbledhin opinionin dhe pritjet e bizneseve të sektorëve të industrisë, ndërtimit, shërbimeve, tregtisë si dhe të konsumatorëve. Të dhënat e këtyre vrojtimeve agregohen dhe shprehen në mënyrë sasiore nëpërmjet treguesve të besimit për secilin sektor.[2]

Treguesit e besimit ndoqën një prirje rritëse gjatë vitit 2014. Treguesi i ndjesisë ekonomike, i cili përmbledh në një të vetëm besimin e pesë sektorëve, regjistroi për herë të parë pas tre vitesh një nivel mbi mesataren e vet historike. Grafiku më poshtë sugjeron se përmirësimi i TNE-ve në dy partnerët tanë kryesorë tregtarë, Italia dhe Greqia por edhe në vendet e Bashkimit Evropian, ka paraprirë rritjen e treguesit të agreguar të besimit në vend.[3]

Grafik 9. Treguesi i ndjesisë ekonomike në Shqipëri, në vendet e Bashkimit Evropian dhe krahasimi me normat vjetore të PBB-së



Burimi: INSTAT, Komisioni Evropian dhe Banka e Shqipërisë.

Në gjallërimin e treguesit të ndjesisë ekonomike kontribuan pozitivisht rritja e besimit në të gjithë sektorët e ekonomisë, por veçohet përmirësimi i theksuar i besimit në ndërtim. Treguesi i besimit për këtë sektor regjistroi rritje në të katër tremujorët e

Grafik 10. Balancat kryesore të vrojtimeve të besimit të biznesit (mesatare për ekonominë) dhe të konsumatorit*



* Të gjitha balancat janë të shprehura si diferencë nga mesataret e tyre historike.

Burimi: Banka e Shqipërisë

vitit të kaluar, duke ndërprerë prirjen rënëse prej një periudhe trevjeçare. Nga ana tjetër, treguesi i besimit të konsumatorëve shfaqi luhatje më të lartë gjatë vitit të kaluar 2014. Pas përmirësimit në tremujorët e dytë e të tretë, besimi konsumator ra në tremujorin e katërt, si rezultat i rënies së balancës së blerjeve të mëdha dhe i rënies së balancës së të ardhurave e shpenzimeve.

Nga vrojtimi i bizneseve, rritja e kërkesës ka ndikuar në përmirësimin e besimit në të katër sektorët: industri, ndërtim, shërbime dhe tregti. Rritja e kërkesës për produktet finale dhe e porosive të reja është mbështetur kryesisht në kërkesën e brendshme, e cila ka dominuar mbi rritjen më të ngadaltë të kërkesës së jashtme. Balancat e kërkesës së brendshme dhe të jashtme qëndrojnë afër mesatares historike, për herë të parë pas tre vitesh. Gjendja financiare e bizneseve është përmirësuar, por balanca e gjendjes së tyre financiare qëndron nën mesataren historike.

Të nxitur nga rritja e besimit dhe përmirësimi i gjendjes financiare, bizneset u shprehën se kanë ndërmarrë më shumë investime në vitin 2014. Balanca e investimeve të reja, e cila kapërceu në nivele të larta mbi mesataren historike në gjashtëmujorin e parë të vitit, u ngadalësua disi në pjesën e dytë të tij.

Kërkesa e huaj rezultoi e dobët dhe eksportet neto nuk e mbështetën rritjen ekonomike gjatë vitit 2014

Grafik 11. Kontributi i eksporteve reale neto në rritjen ekonomike (në pikë përqindje të PBB-së)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Aktiviteti tregtar i vendit u zgjerua gjatë vitit 2014, por rritja e tij reflektoi më së shumti rritjen e importeve. Deficiti tregtar në mallra u zgjerua me 9.4% në nivel vjetor dhe u vlerësua në rreth 20.8% të PBB-së. Ndikimin kryesor në këtë ecuri e dha rritja vjetore e importit të mallrave me rreth 6.7%, ndërkohë që eksporti i tyre u rrit me vetëm 3.8%. Ritmi i rritjes së eksporteve ishte ndjeshëm më i ulët kundrejt nivelit të regjistruar në vitin 2013.

Shkëmbimet tregtare me jashtë dhanë një kontribut negativ në rritjen e kërkesës agregate.[10]

Zgjerimi i deficitit të eksporteve neto ka ndikuar edhe në thellimin e mëtejshëm të deficitit të llogarisë korrente gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Ndikim të kahut të njëjtë dha edhe zgjerimi i deficitit në llogarinë e të ardhurave. Të ardhurat më të larta prej llogarisë së të ardhurave dytësore, si rezultat i rritjes së lehtë të remitancave, nuk arritën të balancojnë efektin negativ të dy llogarive të tjera.

[10] *Gjykimi bazohet në ecurinë e eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve të matura në vëllim, pra të korrektuara nga lëvizjet e çmimeve. Në terma realë, deficiti i eksporteve neto në mallra dhe shërbime u zgjerua me rreth 6.7% në nivel vjetor. Të dhënat finale mbi eksportet neto reale të mallrave e të shërbimeve janë të disponueshme deri në tremujorin e tretë të vitit 2014.*

Financimi i deficitit të llogarisë korrente u realizua kryesisht me flukse jo-borxhkrijuese, në formën e investimeve të huaja direkte dhe të hyrjeve në llogarinë kapitale. Megjithatë, në dallim me dy vitet e mëparshme, është evidentuar dhe rritje në financimin me anë të flukseve borxhkrijuese. Zgjerimi i detyrimeve financiare në formën e investimeve të tjera ishte kontribuesi kryesor në rritjen e financimit të llogarisë korrente me anë të borxhit të huaj. Në fund të vitit 2014, niveli i mjeteve të rezervës valutore ishte i mjaftueshëm për të mbuluar 5.3 muaj importi mallrash e shërbimesh dhe 179.8% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Grafik 12. Forma e financimit të llogarisë korrente (ndaj PBB-së nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 3. Zërat kryesorë të bilancit të pagesave (në mln euro, nëse nuk tregohet ndryshe)

	T2 '13	T3 '13	T4 '13	T1 '14	T2 '14	T3 '14
Llogaria korrente (në mil euro)	-285.0	-190.4	-336.2	-260.8	-324.6	-316.4
vmv (%)	13.2	-23.2	63.3	16.7	13.9	66.2
/ PBB-së (%)	-10.9	-8.2	-13.4	-11.1	-12.2	-12.8
Mallra dhe shërbime	-442.5	-394.9	-518.1	-396.8	-468.8	-459.8
Eksporte, f.o.b.	805.6	981.0	960.3	609.7	753.0	842.1
Importe, f.o.b.	1248.1	1375.9	1478.4	1006.5	1221.8	1301.8
Udhëtime neto	-31.5	26.1	34.0	-21.8	10.6	32.0
Të ardhura parësore	-11.0	22.2	0.0	-7.1	-28.6	-44.5
Kredi	35.7	40.2	33.4	29.2	25.8	28.3
Debi	46.7	18.0	33.4	36.3	54.3	72.8
Të ardhura nga IHD - neto	-20.1	6.2	6.9	-15.9	-31.4	-51.3
Të ardhura dytësore	168.4	182.3	181.9	143.0	172.9	187.8
Kredi	200.5	216.5	213.5	170.2	201.7	221.0
Debi	32.0	34.2	31.6	27.3	28.8	33.2
Dërgesa nga emigrantët - neto	129.6	152.5	140.1	115.9	134.8	155.4
Llogaria Kapitale	4.8	15.0	18.2	22.5	15.3	20.7
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-280.2	-175.4	-318.0	-238.3	-309.3	-295.8
Llogaria financiare	-262.4	-70.9	-226.1	-231.3	-225.4	-140.7
vmv (%)	213.8	78.4	-16.2	82.5	-14.1	98.5
/ PBB-së (%)	-10.0	-3.0	-9.0	-9.8	-8.5	-5.7
Investime direkte	-270.5	-307.0	-231.2	-192.6	-144.5	-188.9
Investime portofoli	104.4	6.2	-18.1	12.8	12.3	-14.2
Derivativë financiarë	1.1	0.0	-2.4	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	-183.8	195.4	18.6	-11.1	-115.8	-91.6
Mjetet e rezervës	86.4	34.5	7.1	-40.3	22.5	154.0
Gabime dhe harresa	17.8	104.5	91.9	7.0	83.9	155.1
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-280.2	-175.4	-318.0	-238.3	-309.3	-295.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Konsolidimi fiskal u shoqërua me hapësira të pakta për stimul ekonomik gjatë vitit 2014[11]

Politika fiskale ka ruajtur një profil konsolidues gjatë vitit 2014.[12] Duke përjashtuar pagimin e detyrimeve të prapambetura, deficiti primar[13] në terma të PBB-së u ngushtua me rreth 1.9 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Procesin e konsolidimit fiskal e ka drejtuar rritja e të ardhurave tatimore, ndërkohë që impulsi fiskal i gjeneruar nga shpenzimet primare korrente është neutralizuar nga ritmet rënëse të shpenzimeve kapitale. Deficiti i përgjithshëm buxhetor u vlerësua në rreth 5.1% të PBB-së, duke qenë lehtësisht më i lartë se vlera 4.9% e regjistruar një vit më parë. Gjithsesi, 47% e këtij deficiti u formua nga shlyerja e detyrimeve të prapambetura.

Grafik 13. Politika fiskale dhe pozicioni fiskal, 2002 - 2014*



*Grafiku majtas tregon ndryshimet në deficitin primar (deficit i përgjithshëm – shpenzime për interesa – efekti i masave *one-off*) në varësi të ndryshimeve në PBB-në nominale. Ndryshimet e deficitit primar nga një vit më parë të vendosura mbi boshtin horizontal tregojnë përkeqësim të pozicionit fiskal, ose impuls fiskal pozitiv, dhe e kundërta.
Burimi: Llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Shpenzimet buxhetore të vitit 2014 ishin rreth 438.8 miliardë lekë ose rreth 11.3% më të larta se një vit më parë. Madhësia e sektorit publik, e shprehur si raport i shpenzimeve totale ndaj PBB-së, u vlerësua në rreth 31% në fund të vitit, nga 28.9% të shënuar një vit më parë. Përqendrimi më i lartë i shpenzimeve u evidentua në tremujorin e fundit, e sidomos në muajin dhjetor[14]. Shpenzimet korrente primare rezultuan rreth 301.3 miliardë lekë ose rreth 5.6% më të larta në terma vjetorë, ndërsa shpenzimet kapitale ishin rreth 7.5% më të ulëta nga viti i mëparshëm.

[11] Të dhënat fiskale për vitin 2014 janë paraprake dhe mund të jenë subjekt rishikimi në të ardhmen.

[12] *Gjykimi mbi kahun e politikës fiskale bazohet në konceptin e politikës fiskale diskrecionare. Ky koncept përjashton nga treguesit fiskalë, efektet e luhatjeve ciklike të ekonomisë dhe masat e përkohshme, të emërtuara si one-off. Si masa të tilla, gjatë vitit 2014, përmendim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Sipas përkufizimit të EC, Public Finances in EMU (2006), këto masa kanë efekt të përkohshëm dhe nuk ndikojnë në pozicionin buxhetor ndërkohor.*

[13] *I referohet deficitit të përgjithshëm buxhetor pa përfshirë shpenzimet për interesat mbi borxhin publik.*

[14] *Tremujori i fundit i vitit mbarti rreth 32.3% të totalit të shpenzimeve, ndërkohë që në muajin dhjetor janë realizuar rreth 15.6% e totalit të shpenzimeve për vitin.*

Grafik 14. Ndryshimet vjetore të zërave kryesorë fiskalë (shpenzimet majtas dhe të ardhurat djathtas) sipas kontributeve të kategorive kryesore përkatëse



Burimi: Ministria e Financave.

Të ardhurat buxhetore u rritën me rreth 12.1% gjatë vitit 2014. Raporti i tyre ndaj PBB-së u rrit me rreth 2 pikë përqindje nga një vit më parë, duke arritur në nivelin 25.9%. Trajektorja rritëse e ndjekur nga të ardhurat buxhetore është pasojë e ndryshimeve në legjislacionin tatimor[15]; e formalizimit në rritje të ekonomisë dhe e eficiencës së përmirësuar në mbledhjen e të ardhurave tatimore; si edhe, e efektit statistikor të krahasimit me një vit më parë.

Tabelë 4. Ecuria e treguesve fiskalë

	Miliardë lekë			Ndaj PBB-së, në %		
	2012	2013	2014	2012	2013	2014
Të ardhura totale	330.4	327.2	366.7	24.7	24.0	25.9
Grante	5.6	5.7	10.1	0.4	0.4	0.7
Tatime dhe dogana	232.6	229.0	253.5	17.4	16.8	17.9
TVSH	116.5	111.9	123.8	8.7	8.2	8.8
Tatim fitimi	16.9	15.1	21.5	1.3	1.1	1.5
Akciza	36.4	38.2	40.9	2.7	2.8	2.9
Të ardhurat personale	28.0	29.6	28.9	2.1	2.2	2.0
Pushteti lokal	10.9	10.8	12.4	0.8	0.8	0.9
Kontribute	57.4	60.0	69.9	4.3	4.4	4.9
Jotatimore	24.0	21.6	20.7	1.8	1.6	1.5
Shpenzime totale	376.2	394.1	438.8	28.2	28.9	31.0
Korrente	312.6	328.6	343.0	23.4	24.1	24.3
Personeli	69.4	70.7	71.4	5.2	5.2	5.0
Interesat	41.5	43.3	40.1	3.1	3.2	2.8
Shpenzime operative	31.5	32.4	31.3	2.4	2.4	2.2
Shpenzime për sigurime sociale	120.3	127.6	138.5	9.0	9.4	9.8
Shpenzime pushteti lokal	27.3	29.8	32.9	2.0	2.2	2.3
Shpenzime të tjera	20.7	23.2	25.5	1.5	1.7	1.8
Kapitale	61.7	65.5	60.5	4.6	4.8	4.3
Detyrime të prapambetura	0.0	0.0	33.8	0.0	0.0	2.4
Mbështetje për energjinë	0.0	0.0	1.5	0.0	0.0	0.1
Balanca buxhetore	-45.9	-66.9	-72.1	-3.4	-4.9	-5.1
Huamarrje e brendshme	24.8	46.3	38.2	1.9	3.4	2.7

Burimi: Ministria e Financave.

[15] *Për detaje në ndryshimet e paketës fiskale referojuni raporteve të politikës monetare të publikuara përgjatë vitit 2014.*

Deficiti buxhetor në fund të vitit rezultoi rreth 72.1 miliardë lekë ose rreth 16.3 miliardë lekë nën nivelin e planifikuar. Financimi i deficitit buxhetor gjatë vitit është mbështetur në emetimin e letrave me vlerë dhe huanë e akorduar prej FMN-së për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Këto dy instrumente financuan përkatësisht 53% dhe 42% të deficitit të përgjithshëm buxhetor.

II.1.4. STABILITETI I ÇMIMEVE

Inflacioni i çmimeve të konsumit mbeti në nivele të ulëta gjatë vitit 2014

Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 1.6%, duke qëndruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni vjetor mori vlera brenda intervalit 1.4-2.2%, por në muajin dhjetor ai shënoi një vlerë të pazakontë të ulët prej 0.7%. Reduktimi i inflacionit në krahasim me vitin e kaluar u shkaktua kryesisht nga goditjet pozitive nga ana e kostove të brendshme e të jashtme, në prani të presioneve të ulëta inflacioniste nga ana e kërkesës.

Grafik 15. Inflacioni vjetor (në përqindje)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Kontributi kryesor në inflacion erdhi nga grupi i ushqimeve, ndërkohë që rënia e çmimit të naftës reduktoi normën e inflacionit në fund të vitit.

Kategoria "Ushqime të papërpunuara" ka përcaktuar ecurinë e inflacionit edhe gjatë vitit 2014. Kjo kategori mallrash ka formuar rreth 80% të inflacionit mesatar total. Megjithatë, çmimet e ushqimeve të papërpunuara janë rritur më ngadalë se vitin e kaluar, si pasojë e shtimit të ofertës bujqësore vendase dhe e rënies së çmimeve të tyre në vendet partnere. Ngadalësimi i fortë i inflacionit të kësaj kategorie gjatë tremujorit të fundit[16], i detyrohet më së shumti ambientit të jashtëm ekonomik, i cili ka ushtruar presione disinflacioniste dhe është materializuar në rënien e inflacionit të importuar. Inflacioni i kategorisë "Ushqime të përpunuara" vazhdon të ndikohet nga rënia e çmimeve të tyre në tregun botëror. Në kahun e kundërt, rritja e taksave e akcizave për disa prej këtyre artikujve ka ushtruar presion për rritjen e çmimit të tyre.

[16] *Inflacioni në muajin dhjetor shënoi vlerën 0.7%. Rënia e theksuar e inflacionit gjatë këtij muaji u diktua nga rritja e ulët e çmimeve të prodhimeve ushqimore dhe nga rënia e vazhduar e çmimit të naftës, e cila ka ulur më tej kostot e prodhimit e të transportit të mallrave dhe të shërbimeve.*

Tabelë 5. Kontributi vjetor i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)

	T4:12	T1:13	T2:13	T3:13	T4:13	T1:14	T2:14	T3:14	T4:14
Ushqime të përpunuara (pp)	0.6	0.5	0.3	0.1	-0.1	-0.1	-0.2	-0.1	0.1
Bukë dhe drithëra (pp)*	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0	-0.1	-0.1	-0.1	-0.1
Alkool dhe duhan (pp)	0.2	0.1	0.2	0.1	0.1	0.3	0.3	0.3	0.3
Ushqime të papërpunuara (pp)	1.0	1.7	2.0	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	0.8
Fruta (pp)	0.5	0.3	0.4	0.8	0.5	0.7	0.7	0.2	0.4
Perime(pp)	0.2	1.2	1.5	0.5	1.1	0.9	0.6	1.2	0.2
Shërbime (pp)	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2
Mallra me çmime të rregulluara (pp)	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.1
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Strehim (pp)	-0.2	-0.1	-0.1	0.0	0.3	0.3	0.2	0.1	0.1
Mallra konsumi joushqimor	0.5	0.0	-0.3	-0.4	-0.2	0.2	0.2	0.2	0.0
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.2	0.1	0.1	0.0	0.0	-0.1	-0.1	0.0	0.0
Indeksi i çmimeve të konsumit (v/v %)	2.4	2.5	2.2	1.5	1.5	1.9	1.6	1.7	1.3

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore përbërëse të kategorive.*

Rënia e vazhduar e çmimit të naftës[17] solli jo vetëm rënien e kontributit të artikujve të kategorisë "Mallra konsumi joushqimor", por dhe uljen e kostove të prodhimit e të transportit të mallrave dhe të shërbimeve të tjera. Gjithashtu, inflacioni i shërbimeve ka shënuar një rritje të lehtë, duke reflektuar përmirësimin e kërkesës konsumatore. Çmimet e grupeve të tjera të shportës rezultuan përgjithësisht të qëndrueshme dhe dhanë ndikim minimal në formimin e inflacionit vjetor.

Dobësia ciklike e kërkesës ka krijuar një mjedis ekonomik me presione të dobëta për rritjen e pagave, të kostove të punës dhe të inflacionit të gjeneruar nga ekonomia e brendshme.

Ndonëse në rritje, kërkesa agregate është e pamjaftueshme për të kthyer ekonominë në nivelet potenciale. Kjo tendencë u reflektua në rritje të ulët të pagave e të kostove të punës, si dhe në nivelet e ulëta të inflacionit bazë gjatë vitit 2014.

Në prani të hendekut negativ të prodhimit, presionet nga ana e kostove të punës dhe atyre prodhuese mbi çmimet e konsumit rezultuan më të dobëta sesa një vit më parë[18]. Rritja mesatare vjetore e treguesit të kostove të punës për njësi në 9-mujorin e parë të këtij viti shënoi vlerën 4%. Treguesi i produktivitetit të punës për sektorin jobujqësor të ekonomisë ra me 9%, ndërkohë që pagat reale shënuan një rënie mesatare prej 5% gjatë periudhës në fjalë.[19]

[17] *Në mënyrë të veçantë, në muajin dhjetor, inflacioni vjetor i nëngrupit "karburante" shënoi një vlerë rreth -6%, duke e ulur kontributin e kategorisë "Mallra konsumi joushqimor" te inflacioni total me 0.2 pikë përqindje.*

[18] *Treguesit e produktivitetit të punës, të kostove të punës për njësi të prodhuar dhe ai i pagës mesatare reale janë përafrues të llogaritur për sektorët jobujqësorë të ekonomisë, me anë të indekseve të statistikave afatshkurtra (SASH, INSTAT).*

[19] *Të dhënat e tregut të punës mund të jenë ndikuar në një masë të madhe nga tendenca e formalizimit në rritje të ekonomisë. Raportimi i një numri më të madh punonjësish nga bizneset sjell rënien e treguesve të produktivitetit e të pagave, përtej efekteve reale në ekonomi.*

Mesatarja vjetore e inflacionit bazë rezultoi rreth -0.1%, duke ilustruar dhe një herë presionet e ulëta inflacioniste të gjeneruara nga ekonomia e brendshme. Inflacioni bazë u luhat në një interval të ngushtë vlerash negative përgjatë tre tremujorëve të parë të vitit, ndërkohë që në të katërtin rimori vlera të ulëta pozitive. Profil të ngjashëm me atë të inflacionit bazë, paraqiti edhe inflacioni i sektorit të mallrave të patregtueshme të shportës së IÇK-së, me një mesatare vjetore prej 1.2%.

Grafik 16. Prirjet afatgjata të inflacionit (majtas) dhe presionet e brendshme nga kostot si ndryshime vjetore të treguesve (djathtas)*



*Ndryshimet vjetore të treguesve të kostove janë sheshuar nga mesatare lëvizëse me 4 terma.
Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Presionet nga inflacioni i importuar kanë ardhur në rënie

Inflacioni i ulët në tregjet partnere, rënia e çmimit të naftës dhe e ushqimeve bazë në tregjet ndërkombëtare dhe ato rajonale, të mbështetura edhe nga qëndrueshmëria e monedhës vendase kundrejt euros, reduktuan inflacionin e importuar gjatë vitit 2014.

Grafik 17. Kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në inflacionin total



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Rënia e inflacionit të importuar ndikoi në reduktimin e inflacionit total gjatë vitit. Në terma mesatarë, kontributi i komponentit të importuar në inflacionin total rezultoi rreth 0.73 pikë përqindje. Ai u luhat nga 1 pikë përqindje në tre tremujorët e parë të vitit, në -0.07 pikë përqindje në të katërtin, duke sinjalizuar për deflacion të importuar. Ky fenomen u shfaq dukshëm në muajin e fundit të vitit, duke e pakësuar inflacionin total me -0.6 pikë përqindje.

Pritjet inflacioniste vijuan prirjen rënëse

Pritjet inflacioniste të agjentëve të ndryshëm të ekonomisë kanë ndjekur prirje rënëse gjatë vitit 2014. Pritjet e bizneseve, të cilat shfaqën rënien

më të theksuar gjatë vitit të kaluar, ndaluan në nivelin 1.4% në tremujorin e katërt 2014. Pritjet e konsumatorëve u shfaqën më të luhatshme gjatë vitit; pasi ranë në dy tremujorët e parë të vitit, ato shënuan një kthesë të lehtë rritëse në dy tremujorët e fundit. Pritjet e agjentëve financiarë, si afatshkurtra (inflacioni pas një viti) ashtu edhe ato afatmesme (inflacioni pas dy vitesh), qëndrojnë më afër objektivit 3% të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 18. Pritjet inflacioniste nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

II.1.5. POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË DHE TREGJET FINANCIARE

Objektivi kryesor i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në terma sasiorë, Banka e Shqipërisë synon kontrollin e inflacionit të çmimeve të konsumit në nivelin 3.0%. Për realizimin e këtij objektivi, Banka e Shqipërisë ndjek regjimin e inflacionit të shënjestruar dhe zbaton një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë orientohet nga e ardhmja; ajo është fleksibël, e kujdesshme dhe transparente.

Presionet e ulëta inflacioniste diktuan vijimin e politikës monetare stimuluese

Presionet e ulëta inflacioniste kanë kërkuar lehtësimin e mëtejshëm të politikës monetare gjatë vitit 2014. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka reduktuar tre herë normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në 2.25% në fund të vitit. Këto sinjale janë përcjellë tek tregjet financiare, të cilat kanë operuar në kushte të mjaftueshme likuiditeti dhe kanë reduktuar normat e interesit të financimit të sektorit privat e publik.

Grafik 19. Hendeku i prodhimit dhe inflacioni bazë (majtas); norma bazë e interesit (djathtas)



* MA - mesatare lëvizëse me 4 terma për të sheshuar luhatjet afatshkurtra.
Burimi: Vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Instrumentet për zbatimin e politikës monetare nuk kanë pësuar ndryshime gjatë vitit 2014. Banka e Shqipërisë ka vijuar të injektojë likuiditet në sistemin bankar, nëpërmjet operacioneve të saj standarde të rifinancimit. Presionet për likuiditet në sistem kanë qenë të përmbajtura dhe janë reflektuar në luhatje të ulëta të normave të interesit në tregun ndërbankar. Operacioni kryesor për injektimin e likuiditetit ka qenë marrëveshja e anasjellë e riblerjes me afat 7-ditor. Krahas saj janë përdorur edhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes me maturim 1-mujor dhe 3-mujor, duke synuar plotësimin optimal të kërkesave për likuiditet të sistemit bankar.

Në një ambient me prime të larta pasigurie, Banka e Shqipërisë ka vijuar të përdorë instrumentin verbal për orientimin e tregut mbi kahun e politikës monetare në të ardhmen (*forward guidance*). Nëpërmjet këtij komunikimi, Banka e Shqipërisë ka shprehur angazhimin se politika monetare do të jetë stimuluese dhe se normat e interesit do të mbeten në nivele të ulëta edhe për disa tremujorë. Përdorimi i këtij instrumenti ka ndihmuar në rritjen e qartësisë së politikës monetare, në uljen e primeve të rrezikut në treg dhe në reduktimin e normave afatgjata të interesit.

Politika monetare është reflektuar në rënie të normave të interesit në tregjet financiare

Tregjet financiare kanë reaguar ndaj politikës monetare lehtësuese dhe angazhimit për ruajtjen e këtij kahu edhe për një periudhë kohe. Në veçanti, ky vit ka shënuar rënie të vazhdueshme të normës së interesit për kredinë në lekë si për bizneset ashtu dhe për individët, duke krijuar stimuj për rritjen e kreditimit në monedhën vendase.

Normat e interesit të tregut ndërbankar janë luhatur shumë pranë normës bazë, në përputhje me objektivin operacional të Bankës së Shqipërisë[20]. Norma mesatare ditore e interesit në këtë treg u ul në 2.56% në vitin 2014, nga 3.50% që shënonte një vit më parë, ndërsa ajo 7-ditore zbriti në 2.65%, nga 3.62%. Interesat e tregut ndërbankar kanë treguar luhatje më të ulët krahasuar me një vit më parë.[21]. E ndryshme ka qenë sjellja e interesave të kërkuara në tregun primar të letrave të borxhit të qeverisë qendrore. Sipas maturiteteve, *yield*-et e tregut primar kanë treguar prirje divergjuese, duke rezultuar në pjerrësim të kurbës në fund të vitit. *Yield*-i 12-mujor ka rënë në 3.37% në muajin dhjetor, nga 3.71% që shënonte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në të kundërt, *yield*-et e obligacioneve qëndrojnë afërsisht 22 pikë bazë[22] më lart nga viti i kaluar.

---

[20] *Objektivi operacional i Bankës së Shqipërisë trajtohet më tej në kapitullin "Operacionet në tregun financiar dhe administrimi i rezervës valutore".*

[21] *Deviacioni standard i interesit ditor në tregun ndërbankar për këtë vit ishte 0.2626 nga 0.4219 që ishte në vitin 2013.*

[22] *Yield-et e obligacioneve me maturitet 2-, 3-, 5- dhe 7-vjeçar me interes fiks kanë pasur rritje mesatare prej, respektivisht, 0.12pp, 0.34pp, 0.02pp dhe 0.40 pp.*

Grafik 20. Normat e interesit në tregun ndërbankar dhe kurba e *yield*-eve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në gjysmën e parë të vitit, bankat kanë treguar interes për instrumentet e tregtueshme të borxhit publik, duke shkaktuar një ulje të përgjithshme të *yield*-eve. Duke filluar nga muaji shtator, kërkesa e sektorit publik për financim u rrit, ndërkohë që pjesëmarrja e bankave në ankande primare tentoi të reduktohej, si pasojë e kufizimeve të vendosura nga bankat mëma. Këto tendenca sollën një rritje të kurbës së *yield*-eve dhe pjerrësim të saj. Paralelisht me to, edhe strategjia e rritjes së maturitetit të borxhit publik dhe rritja e emetimeve në segmentin afatgjatë të letrave me vlerë ka ndikuar dhe ndikon në pjerrësimin e kurbës së *yield*-eve.

Reduktimi i normës bazë është përcjellë edhe në tregun e depozitave. Norma mesatare e interesit të depozitave të reja në lekë për vitin 2014 shënoi 1.9%, duke rënë me rreth 1.8 pikë përqindje krahasuar me vitin 2013. Kjo rënie është vënë re në të gjitha llojet e depozitave, duke qenë më e ndjeshme në maturitetet afatgjata. Paralelisht, rënie kanë shfaqur edhe normat e interesit të

Grafik 21. Ecuria e normave të interesit për depozitat dhe kreditë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

depozitave të reja në euro, duke zbritur mesatarisht në nivelin 0.76% ose 1.0 pikë përqindje më poshtë se një vit më parë.

Viti 2014 ka shënuar përmirësim të transmetimit të uljes së normës bazë në aktivitetin kreditues, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit. Norma e interesit për kreditë e reja në lekë ka ndjekur një trend të dukshëm rënës gjatë gjithë vitit 2014 dhe ka rezultuar mesatarisht në 8.6% (1.8 pikë përqindje më pak kundrejt vitit të kaluar). Rënia është evidente për të gjitha afatet e maturimit dhe llojet e kredisë. Diferenca midis interesit të kredisë në lekë dhe *yield*-it 12-mujor, i cili kuotohet si normë referencë, është ngushtuar në këtë periudhë, kryesisht si pasojë e uljes së interesit për kreditë. Rënia e normave të interesit ka mbështetur rritjen e kërkesës për kredi në monedhë vendase dhe përmirësimin e treguesve të aktivitetit kreditues. Nga ana tjetër, norma e interesit të kredive të reja në euro ka qëndruar mesatarisht në nivel të njëjtë me atë të vitit të kaluar, në 6.7%. Kjo ecuri është reflektuar në ngushtimin e diferencave të interesave të kredisë për dy monedhat.

Kursi i këmbimit të lekut ka treguar luhatje të ulëta

Gjatë vitit 2014, një euro u këmbye mesatarisht me 140 lekë, duke qëndruar në nivel të ngjashëm me atë të vitit 2013 (140.3 lekë/euro). Pavarësisht efektit sezonal të vërejtur kryesisht në muajin gusht, kursi i këmbimit është luhatur ngushtë në intervalin 138.9-140.8 lekë, duke sinjalizuar një raport të balancuar ofertë/kërkesë për valutë. Për të njëjtën periudhë, ecuria e dollarit amerikan ndaj lekut, në reflektim edhe të ecurisë së dollarit në tregjet ndërkombëtare shfaqet më e luhatshme. Deri në muajin gusht, dollari amerikan dobësoi pozitat e tij ndaj lekut mesatarisht me 3.7% në terma vjetorë, për t'u mbiçmuar deri në fund të vitit me 7.1% në krahasim me një vit më parë.

Grafik 22. Kursi i këmbimit lek/euro dhe lek/usd dhe luhatshmëria e tyre ndër vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 2: POLITIKA MONETARE DHE TRANSMETIMI I SAJ NË EKONOMI

Kriza ekonomike dhe financiare botërore e shtriu në mënyrë graduale, por të pashmangshme, ndikimin e saj në Shqipëri. Si pasojë e efekteve direkte dhe indirekte të kësaj krize, ekonomia shqiptare shënoi një ngadalësim progresiv dhe presionet inflacioniste erdhën në rënie. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, duke faktorizuar në çdo moment fortësinë e goditjeve, kahun dhe intensitetin rezultant të politikave makroekonomike, fortësinë e mekanizmit të transmetimit dhe konsiderata të tjera mbi treguesit e shëndetit financiar, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka marrë një natyrë gjithnjë e më të fortë stimuluese. Ky kah u ruajt dhe u forcua më tej gjatë vitit 2014. Nëpërmjet tre uljeve të mëtejshme, në fund të këtij viti, norma bazë e interesit zbriti në vlerën 2.25%. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë vazhdoi të zbatojë strategjinë e komunikimit të kahut të ardhshëm të politikës monetare, duke e forcuar dhe përmirësuar më tej këtë instrument gjatë vitit 2014.*

Qëllimi kryesor i politikës monetare lehtësuese ka qenë ulja e kostove të financimit dhe administrimi i pritjeve të agjentëve ekonomikë për inflacionin, duke krijuar premisat e duhura për nxitjen e rritjes ekonomike dhe të kthimit të inflacionit në objektiv. Duke gjykuar mbi presionet e forta negative të ardhura nga sektori i jashtëm i ekonomisë, si dhe goditjet që pësuan sektorë të veçantë të ekonomisë shqiptare dhe besimi i agjentëve ekonomikë në vend, politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka qenë e suksesshme në administrimin e situatës dhe në ndryshimin e kahut të zhvillimit të ekonomisë.

Si në çdo ekonomi të bazuar në parimet e tregut të lirë, lidhja midis instrumenteve të politikës monetare dhe përmbushjes finale të objektivave të saj, realizohet nëpërmjet një zinxhiri stimujsh financiarë dhe reagimesh të agjentëve ekonomikë, i cili ndryshe njihet edhe si mekanizëm i transmetimit. Në një pamje të thjeshtuar, ky mekanizëm përfshin dy etapa: (i) përcjelljen e stimulit monetar në tregjet financiare; dhe, më tej, (ii) nxitjen e konsumit, investimeve, kreditimit dhe oreksit për rrezik, në përgjigje të kushteve më të mira të financimit. Duke gjykuar mbi të dhënat e disponuara, Banka e Shqipërisë vlerëson se hallka e parë e këtij mekanizmi, mbi të cilën ajo ka një ndikim më të shpejtë dhe më direkt, ka funksionuar. Ndërkohë, funksionimi i hallkës së dytë të mekanizmit të transmetimit mbetet ende jo i plotë.

Grafik 23. Përcjellja e politikës monetare në tregjet financiare*



* Paneli i djathtë tregon ndryshimin kumulativ (në pikë përqindje, fund periudhe) të normave të interesit në tregjet financiare në përgjigje të reduktimit të normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë (interesi i kredisë në lekë është llogaritur si mesatare rrëshqitëse 6-mujore). Paneli i majtë tregon ecurinë e normave kryesore të interesit në ekonomi: normën mesatare të ponderuar të kredisë në lekë (mesatare rrëshqitëse 6-mujore), normën mesatare të ponderuar të depozitave në lekë dhe *yield*-in mesatar të ponderuar të letrave me vlerë të qeverisë.
Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.

Sikurse shihet nga grafikët, reduktimet e normës bazë të interesit kanë sjellë rënien e të gjitha normave të interesit në tregjet financiare. Gjatë vitit 2014, normat e interesit të financimit të sistemit bankar, normat e interesit të kredisë në lekë dhe normat e interesit të letrave me vlerë të qeverisë zbritën në minimumet e tyre historike (shih grafikun 23). Kushtet më të mira të financimit rritin stimujt për huamarrje të re, si dhe lehtësojnë kostot e shërbimit të huave ekzistuese.

Nga ana tjetër, sikurse e parashtruam, reduktimi i kostove të financimit ka ndihmuar në rritjen e kredisë në lekë dhe në mbështetjen e konsumit dhe të investimeve në vend (shih panelin A të grafikut 24). Megjithatë, aktiviteti kreditues dhe reagimi i ekonomisë ndaj politikës monetare lehtësuese mbetet poshtë nivelit të synuar nga Banka e Shqipërisë dhe jo i plotë. Kjo sjellje motivohet nga të paktën tre faktorë.

Së pari, kërkesa për kredi shfaqet e dobët, në çdo nivel normash interesi. Biznesi dhe konsumatori hezitojnë në ndërmarrjen e konsumit dhe investimeve shtesë, si pasojë e pasigurisë për të ardhmen. Pavarësisht përmirësimit të besimit gjatë tremujorëve të fundit, kërkesa për kredi mbetet e ulët (shih panelin B të grafikut 24).

Së dyti, oreksi për rrezik i sektorit financiar shfaqet i ulët. Niveli i lartë i kredive me probleme, politikat konservatore të bankave mëma, por edhe problemet në sektorë specifikë të ekonomisë bëjnë që sistemi bankar të zbatojë politika dhe praktika tejet të kujdesshme në kredidhënie (shih panelin C të grafikut 24).

Së treti, rikuperimi i ngadaltë i konsumit, i investimeve dhe i kërkesës për kredi lidhet edhe me faktorë strukturorë, të cilët diktojnë rritje të ngadaltë të saj. Kështu, nevoja për ristrukturimin e ekonomisë, për zhvendosjen e burimeve financiare, njerëzore dhe menaxheriale, drejt sektorëve më produktivë të ekonomisë, tenton të reduktojë rritjen e kërkesës agregate. Ky fenomen është i pranishëm në të gjitha vendet e rajonit dhe, së bashku me politikat konservatore të bankave mëma, përcakton një rritje të ngadaltë të kredisë dhe të ekonomisë në to (shih panelin D të grafikut 24).

Grafik 24. Faktorët përcaktues të ecurisë së kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë

Duke marrë parasysh fortësinë e goditjeve dhe kufizimet e mësipërme, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka qenë e suksesshme në drejtim të përmbushjes së misionit të saj, atë të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve në ekonomi. Megjithatë, funksionimi i mekanizmit të transmetimit ka qenë dhe mbetet jo i plotë, si pasojë e

faktorëve që ndodhen jashtë ndikimit të politikës monetare. E vetme, politika monetare mbetet një instrument i pamjaftueshëm për adresimin e të gjitha problemeve që pengojnë rritjen ekonomike. Zgjidhja apo zbutja e kufizimeve të ofertës, përmirësimi i klimës së biznesit si dhe përshpejtimi i axhendës së reformave strukturore, do të ndihmonin në rritjen e efektivitetit të kësaj politike dhe në një kthim më të shpejtë të ekonomisë në ekuilibër.

* *Norma bazë është ulur 2 herë në vitin 2011, 3 herë në vitin 2012, 4 herë në vitin 2013 dhe 3 herë në vitin 2014.*

III.1.6. ECURIA E TREGUESVE MONETARË[23]

Mjetet monetare kanë shfaqur norma të moderuara rritjeje, në linjë me ecurinë e aktivitetit ekonomik në vend dhe sjelljen e kujdesshme të bankave në kreditim.

Treguesit monetarë kanë shfaqur një ecuri të ngadaltë për pjesën më të madhe të vitit 2014, si pasojë e aktivitetit të moderuar kreditues të bankave dhe e zhvendosjeve strukturore të mbajtjes së parasë në ekonomi. Mbasi shfaqi një ecuri vjetore të dobët përgjatë vitit, agregati M3 shënoi një rritje vjetore prej 4% në muajin dhjetor. Kjo ecuri u ndikua nga aktiviteti i shtuar fiskal për këtë periudhë.[24] Zgjerimi monetar është mbështetur kryesisht nga komponenti valutor i kërkesës për para përgjatë gjithë vitit, ndërsa kërkesa për financim nga sektori privat dha një kontribut të moderuar, vetëm në pjesën e dytë të vitit.

Sistemi bankar ka ruajtur aftësinë e tërheqjes së kursimeve të publikut, por këto të fundit tentojnë të zhvendosen në afate më të gjata maturimi apo në instrumente të tjera me kthim më të lartë.

Depozitat e rezidentëve shfaqën një ecuri pozitive, duke shënuar një normë rritjeje vjetore prej 4.2% ose 1 pikë përqindje më të lartë se rritja e një viti më parë. Ecuria e depozitave në vitin 2014 mbetet pranë niveleve të moderuara historike, e ndikuar nga krijimi i ulët i parasë në ekonomi. Zgjerimi i depozitave mori kryesisht formën e rritjes së depozitave në valutë, ndërkohë që depozitat në lekë kanë dhënë një kontribut më të ulët.

Depozitat e individëve me afat maturimi nën dy vjet u rritën me 4.6 miliardë lekë, duke ngadalësuar normën vjetore të rritjes në 0.5%. Në prani të reduktimit të normave të interesit të depozitave në lekë dhe në valutë, individët kanë investuar kursimet e tyre në instrumente financiare afatgjata, të cilat sigurojnë kthime më të larta. Kështu, investimet e individëve në depozita mbi dy vjet dhe

[23] *Të dhënat për muajin dhjetor janë paraprake dhe subjekt rishikimi deri në momentin e publikimit të këtij raporti.*

[24] *Aktiviteti fiskal kontribuoi negativisht në rritjen vjetore të agregatit M3 gjatë pjesës më të madhe të vitit, por ky kontribut kërceu në territor pozitiv dhe shënoi vlerën 1.8 pikë përqindje në muajin dhjetor.*

ato në letra me vlerë u rritën në total me 27 miliardë lekë. Në tërësi, investimet e individëve në instrumente financiare gjatë vitit shënuan një rritje vjetore prej 3.2%.

Grafik 25. Ecuria e ofertës monetare dhe përbërja e depozitave*



*Në të dhënat monetare, stoku i depozitave që përfshihet në llogaritjen e parasë së gjerë, sipas përkufizimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, nënkupton depozitat me afat maturimi deri në dy vjet. Depozitat totale përfshijnë depozitat monetare dhe stokun e depozitave mbi dy vjet.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Me gjithë rritjen e portofolit të kredisë, rimëkëmbja e saj shfaqet e dobët dhe e segmentuar[25]

Zhvillimet e kredisë janë karakterizuar nga rikuperimi gradual i normave të rritjes gjatë vitit 2014, nga reduktimi i ndjeshëm i normave të interesit në lekë dhe nga rritja e financimit në monedhën vendase. Zhvendosja e portofolit drejt monedhës vendase ka mundësuar një përcjellje më të mirë të stimulit monetar

Grafik 26. Kredia për ekonominë dhe normat e interesit sipas monedhës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[25] *Analiza e mëposhtme për aktivitetin kreditues i referohet kredisë së dhënë vetëm për rezidentët sipas metodologjisë së statistikave monetare.*

dhe ka ndihmuar në reduktimin e rrezikut të kursit të këmbimit në bilancet e kredimarrësve dhe të bankave. Në tërësi, rikuperimi i ngadaltë i kredisë ka reflektuar një kërkesë të ulët të ekonomisë për financim dhe një përqasje të kujdesshme të bankave ndaj kreditimit. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, ndryshimi vjetor i raportit të kredisë ndaj PBB-së nominale ka vijuar të jetë negativ, por është ngushtuar në krahasim me një vit më parë.

Teprica e kredisë u rrit me rreth 12 miliardë lekë dhe ndryshimi vjetor i saj rezultoi në 2.2% në fund të vitit 2014[26], nga -1.2% që shënonte në fund të vitit 2013[27]. Një zhvillim pozitiv i këtij viti ishte rikuperimi i qëndrueshëm i kredisë në lekë, rritja vjetore e së cilës rezultoi 6.1% në fund të vitit 2014. Ndërkohë, kredia në valutë vijoi të tkurret, por me ritme më të zbutura se një vit më parë.

Pjesa më e madhe e rritjes së kredisë ka shkuar për rritjen e financimit të bizneseve, si për likuiditete ashtu edhe për investime. Ndryshimi vjetor i kredisë për biznese arriti në 2.4% në fund të vitit 2014, nga -2.0% që shënonte në fund të vitit 2013. Nga ana tjetër, kredia për individë ka shfaqur një ecuri të plogësht gjatë vitit 2014. Ndryshimi vjetor i saj, pasi është luhatur rreth vlerës zero në gjysmën e parë të vitit, është rritur gradualisht në 1.2% në fund të tij. Pavarësisht lehtësimit të mëtejshëm të kushteve të kreditimit për të gjitha produktet, individët kanë reaguar me kërkesë të shtuar vetëm për kredi konsumatore. Kërkesa për kredi hipotekare ka qenë e pakët dhe ndryshimi vjetor i saj ka qenë pranë zeros gjatë gjithë vitit 2014.

Grafik 27. Ecuria e kredisë sipas destinacionit të saj
(ndryshime vjetore, në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[26] *Pastruar nga efekti i kursit të këmbimit, fluksi neto i kredisë ishte rreth 7.2 miliardë lekë dhe rritja vjetore e saj rezultoi 1.6%.*

[27] *Rikuperimi i rritjes së kredisë, krahas ecurisë më të mirë, ka ardhur si pasojë edhe e shitjeve dhe fshirjeve më të pakta të kredive nga bilancet e bankave gjatë vitit 2014. Në veçanti, rikthimi në norma pozitive i ndryshimit vjetor pas 12 muajsh tkurrjeje ka reflektuar edhe shuarjen e efektit bazë si rrjedhojë e shitjeve të disa kredive në muajt korrik, gusht dhe tetor të vitit 2013.*

HAPËSIRË INFORMUESE 3: PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË VROJTIMIT TË AKTIVITETIT KREDITUES GJATË VITIT 2014

Vrojtimi i aktivitetit kreditues mundëson analizën cilësore të aspekteve që lidhen me kushtet e kreditimit dhe kërkesën për kredi të bizneseve dhe të individëve. Kjo hapësirë informuese përmbledh të dhënat e vrojtimit dhe përshkruan faktorët që kanë ndikuar kushtet dhe kriteret e kredidhënies, të zbatuara për klientët e sistemit bankar gjatë vitit 2014.*

Nga përpunimi i të dhënave rezulton se bankat kanë lehtësuar standardet e kredidhënies për bizneset gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014, dhe i kanë shtrënguar ato lehtësisht gjatë gjashtëmujorit të dytë. Mesatarisht, balancat neto shënuan vlerat 2.3% në gjashtëmujorin e parë dhe -1.1% në të dytin. Nga ana tjetër, standardet e kredisë për individët u lehtësuan gjatë gjithë vitit 2014, ndonëse masa e lehtësimit ka ardhur në ngadalësim në gjysmën e dytë të vitit. Balanca neto e standardeve, në fund të vitit shënoi 3.4%. Ecuria e standardeve të kreditimit gjatë pjesës së parë të vitit është në linjë me prirjen lehtësuese të standardeve në vendet e Eurozonës, duke vijuar lehtësimin edhe përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, si për bizneset ashtu edhe për individët.

Grafik 28. Ecuria e standardeve të huadhënies për agjentët ekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Në përgjithësi, ndryshimi i standardeve për bizneset dhe për individët, të analizuara sipas qëllimit të përdorimit, ka rezultuar në të njëjtin drejtim**. Sasia e likuiditetit dhe gjendja e konkurrencës në treg kanë vazhduar të nxisin lehtësimin e standardeve për bizneset dhe individët gjatë vitit 2014. Këtë vit, në lehtësimin e standardeve kanë ndikuar në mënyrë domethënëse edhe vendimet e Bankës së Shqipërisë.*

Politika e kreditimit të bankave është reflektuar si në reduktimin e normave të interesit të kredisë, ashtu dhe në lehtësimin e kritereve të tjera të kredidhënies. Përjashtim nga kjo sjellje bën marzhi për kreditë me rrezik, i cili është forcuar për të gjithë agjentët ekonomikë.

*Bazuar në vlerësimet e ekspertëve të bankave, gjatë vitit 2014, kërkesa e bizneseve dhe e individëve për kredi ka rezultuar në rritje të lehtë. Balanca neto e kërkesës****

së individëve ka shënuar vlera të ulëta pozitive gjatë gjithë vitit. Kërkesa e bizneseve regjistroi kthesë drejt rritjes në tremujorin e dytë të vitit, pasi kishte shënuar rënie gjatë vitit 2013.

Grafik 29. Ecuria e kërkesës për kredi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

** Agregimi i rezultateve të vrojtimit të aktivitetit kreditues bazohet në një metodologji të standardizuar dhe të përdorur gjerësisht nga bankat qendrore. Për këtë arsye, rezultatet e këtij vrojtimi janë të krahasueshme edhe me vrojtimet e organizuara nga banka të tjera qendrore. Disa nga bankat qendrore më të zhvilluara të cilat zhvillojnë vrojtimin e aktivitetit kreditues janë: Rezerva Federale (nga viti 1967), Banka Qendrore Evropiane (nga viti 2003), Banka e Anglisë (nga viti 2007) dhe Banka e Japonisë (nga viti 2000).*

*** Biznese: kapital qarkullues dhe investime; Individë: blerje banese dhe konsum.*

**** E matur si diferencë në pikë përqindjeje e përgjigjeve për rritje ndaj atyre për ulje.*

II.2. STABILITETI FINANCIAR DHE ECURIA E SISTEMIT BANKAR

- *Ruajtja e stabilitetit financiar dhe mirëfunksionimi i sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë janë objektiva kryesorë për Bankën e Shqipërisë, krahas objektivit themelor për ruajtjen e nivelit të çmimeve. Roli i Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit financiar përcaktohet në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" dhe në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Këta objektiva realizohen përmes licencimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare, si edhe përmes monitorimit dhe zbatimit të nismave për përmirësimin teknologjik të sistemeve të pagesave. Kriza financiare globale theksoi nevojën për plotësimin e mbikëqyrjes financiare tradicionale, e cila përqendrohet në rreziqet në institucione të veçanta, me mbikëqyrjen e rreziqeve në sistemin financiar në tërësi, duke zgjeruar dimensionin e fokusit të punës për ruajtjen e stabilitetit financiar.*

Banka e Shqipërisë e përcakton stabilitetin financiar si një situatë, ku sistemi financiar vepron pa dështime serioze apo ndikime të padëshirueshme mbi zhvillimin aktual dhe të ardhshëm të ekonomisë në tërësi. Për përmbushjen e këtij angazhimi, Banka e Shqipërisë kryen analiza mbi qëndrueshmërinë e sistemit financiar në tërësi dhe të atij bankar në veçanti, monitoron rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar veprimtaria bankare përfshirë dhe rrezikun sistemik, si dhe komunikon në mënyrë të rregullt me të gjitha autoritetet publike, industrinë financiare dhe publikun.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional si pjesë e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, gjatë tremujorit të parë të vitit 2014 u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi midis Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Ky memorandum përcakton format e bashkëpunimit midis institucioneve në drejtim të parandalimit dhe administrimit të situatave të jashtëzakonshme në veprimtarinë e sistemit financiar.

II.2.1. VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE VEPRIMET PËR ADMINISTRIMIN E TYRE

Vlerësimi i ekspozimit të veprimtarisë bankare ndaj rreziqeve të kreditit, të tregut dhe të likuiditetit përbëjnë thelbin e monitorimit të zhvillimeve në këtë sektor. Në kuadër të vlerësimit të stabilitetit financiar, Banka e Shqipërisë analizon edhe zhvillimet në sistemin financiar në Shqipëri, ekspozimin e sektorit bankar ndaj institucioneve financiare jobanka apo ndikimin e ekonomisë reale dhe tregjeve financiare në stabilitetin financiar.

RREZIKU I KREDITIT

Ndikimi më i ndjeshëm i krizës ndërkombëtare në aktivitetin bankar në Shqipëri është reflektuar në përkeqësimin e cilësisë së portofolit të kredisë. Rreziku i kreditit mbetet shqetësimi kryesor për veprimtarinë bankare shoqëruar nga ngadalësimi i ndjeshëm i kreditimit në ekonomi. Banka e Shqipërisë ka ndjekur me vëmendje zhvillimet në rrezikun e kreditit, duke ndërmarrë vazhdimisht masa për të kufizuar këtë rrezik. Më konkretisht:

- Në adresim të ngadalësimit të ndjeshëm të ritmit të kredidhënies dhe rënies së cilësisë së kredisë, në maj të vitit 2013, Banka e Shqipërisë prezantoi një paketë masash me natyrë kundërciklike të cilat parashikonin: (1) ndryshimin e kërkesave për kapital lidhur me: i) rritjen vjetore të stokut të kredisë (brenda një intervali të caktuar) dhe; ii) fluksin e investimeve të sektorit bankar me subjektet jorezidente, si edhe (2) ndryshime të kërkesave për ristrukturimin e kredisë standarde. Me hyrjen e tyre në fuqi, masat kundërciklike kanë ndihmuar në mbështetjen e kreditimit dhe kufizimin e rënies së mëtejshme të cilësisë së kredisë. Bankat kanë rritur përdorimin e masave ndihmëse për ristrukturimin e kredisë, çka ka ndihmuar në ruajtjen e cilësisë së portofolit të kredisë.

Me përfundimin e afatit të këtyre masave në fund të vitit 2014, Banka e Shqipërisë mori vendimin që ato të mbeten në fuqi edhe gjatë vitit 2015. Konkretisht, ndryshimi në kërkesat për kapital lidhur me rritjen vjetore të stokut të kredisë është në fuqi deri në muajin qershor 2015, ndërsa ndryshimet që lidhen me fluksin e investimeve në sektorin bankar nga subjektet jorezidente janë në fuqi deri në fund të vitit 2015.

- Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë". Sipas këtyre ndryshimeve, nga 1 janari i vitit 2015, procesi i fshirjeve të kredive me probleme bëhet i detyrueshëm për bankat, 3 vjet pasi ato janë klasifikuar në kategorinë 'të humbura'.

- Për të lehtësuar procesin e fshirjes së kredive të humbura, me propozim të Bankës së Shqipërisë, në maj 2013 Ministria e Financave ndryshoi aktet nënligjore të cilat përcaktojnë provigjionet e kredive të fshira si shpenzim të zbritshëm për qëllime fiskale. Në prill 2014, këto ndryshime u bënë efektive në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat".

- Në të njëjtin drejtim, me qëllim zbutjen e barrës së bankave për ekzekutimin e kolateraleve, janë miratuar disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të cilat synojnë përshpejtimin e procesit. Që nga hyrja e tyre në fuqi, në muajin shtator 2013, është evidentuar një rritje e normës së suksesit të ekzekutimit të kolateraleve me gati 10%. Megjithatë, ndikimi i plotë i këtyre ndryshimeve në terma të rezultateve konkrete kërkon më shumë kohë dhe përvojë, dhe suksesi i përgjithshëm do të varet ndjeshëm nga ecuria e tregut të pasurive të patundshme.

- Banka e Shqipërisë ka miratuar një rregullore të re "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave". Ndër të tjera, kjo rregullore ka vendosur kërkesa për rritjen e përgjegjësisë së këshillave drejtues në administrimin e ekspozimeve të mëdha. Kur këto ekspozime janë në më shumë se një bankë, kërkohen edhe hartime të planeve të rimëkëmbjes e të zgjidhjes në nivel sistemi. Në bashkëpunim me projektin FinSAC të Bankës Botërore, është duke u zbatuar një platformë, e cila pritet të përgatisë infrastrukturën për hartimin e planeve të rimëkëmbjes dhe zgjidhjes në të ardhmen.

- Së fundi në përgjigje të presioneve të ulëta inflacioniste, por edhe me qëllim stimulimin e rritjes ekonomike dhe aktivitetit kreditues, Banka e Shqipërisë ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme një politikë monetare lehtësuese. Si rezultat, gjatë vitit 2014, normat e interesit për kredinë në lekë kanë shënuar rënie, duke u reflektuar edhe në përmirësimin e ritmeve të rritjes së kredisë gjatë gjysmës së dytë të vitit.

RREZIQET E TREGUT

Banka e Shqipërisë monitoron me kujdes edhe zhvillimet në rrezikun e tregut. Sektori bankar paraqitet më pak i ekspozuar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të tregut përmes lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit. Megjithatë, ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të tregut nga huamarrja e pambrojtur në valutë mbetet relativisht i lartë, pasi kreditë e pambrojtura në valutë të huaj përbëjnë 31.3% të totalit të kredive.

RREZIKU I LIKUIDITETIT

Rreziku i likuiditetit në sektorin bankar në Shqipëri vlerësohet të jetë i ulët, në kushtet kur treguesit e likuiditetit qëndrojnë ndjeshëm mbi nivelet minimale që kërkohen nga kuadri rregullator. Depozitat në banka vijojnë të rriten duke reflektuar një varësi të ulët të sektorit bankar ndaj financimeve të huaja.

RREZIKU I PËRCJELLJES SË GODITJEVE NGA JASHTË

Ndjekja dhe analiza e zhvillimeve makroekonomike dhe financiare në tregjet e huaja është e rëndësishme për të kuptuar shkallën e ekspozimit të ekonomisë tonë ndaj rreziqeve që burojnë prej tyre. Banka e Shqipërisë ka ndërtuar disa metodologji për të vlerësuar ndikimin e goditjeve nga jashtë në sistemin financiar shqiptar. Gjithashtu, ushtrimet e provës së rezistencës përdoren në mënyrë të rregullt për të vlerësuar ekspozimin e sektorit bankar ndaj lëvizjeve në çmimet e letrave me vlerë të huaja, ndaj grupeve bankare zotëruese, si dhe ndaj investimeve në jorezidentë. Rezultatet e ushtrimeve të kryera gjatë vitit 2014, tregojnë se sektori bankar në çdo rast ruan një pozicion të mirë kapitalizimi ndaj goditjeve në terma të këtyre rreziqeve.

MONITORIMI I RREZIKUT SISTEMIK

Në vijim të krizës së fundit financiare, në përputhje dhe me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare të mbikëqyrjes financiare, është punuar për ndërtimin e treguesve të përshtatshëm për identifikimin e rrezikut sistemik, përmes treguesve dhe metodologjive specifike që vlerësojnë aspekte të ndryshme të tij.

Rezultatet plotësohen më tej me konkluzionet e përftuara nga vrojtimet e kryera me industrinë bankare në terma të perceptimit të rrezikut sistemik. Ndërkohë, vrojtimet e kryera me bizneset dhe familjet ofrojnë informacion shtesë mbi masën e ngarkesës së tyre me borxh dhe potencialin e përcjelljes së goditjeve të mundshme në sistemin financiar.

Më tej, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar metodologjinë identifikuese të bankave sistemike në vend, duke nisur një proces i cili parasheh vendosjen graduale të kërkesave më të larta mbikëqyrëse për këto institucione.

Në përgjithësi, treguesit për vlerësimin e rrezikut sistemik në sektorin bankar, tregojnë se ai mbetet në nivele të konsiderueshme, por gjatë vitit 2014 ka shënuar rënie në kushtet e përmirësimit të treguesve të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve. Rezultatet ballafaqohen edhe përmes ushtrimit të provës së rezistencës me pjesëmarrjen e disa bankave tregtare, i cili ofron informacion të zgjeruar mbi ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve të ndryshme makroekonomike dhe financiare.

KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Komunikimi me publikun përbën një aspekt të rëndësishëm të punës së Bankës së Shqipërisë në drejtim të stabilitetit financiar. Banka e Shqipërisë publikon Raportin e Stabilitetit Financiar dhe Deklaratën e Stabilitetit Financiar, me një frekuencë gjashtëmujore. Në veçanti, Deklarata e Stabilitetit Financiar synon të tërheqë vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij. Deklarata e fundit, e publikuar në muajin tetor 2014, vlerëson se gjendja dhe ecuria e sektorit bankar dhe e sistemit financiar paraqitet e qëndrueshme. Gjithsesi, Deklarata nënvizon rëndësinë e monitorimit të kujdesshëm të rrezikut të kreditit, duke nxitur bankat të kryejnë vlerësime mbështetur mbi një analizë konservatore të zhvillimeve të ardhshme. Në vijim, ajo thekson nevojën që bankat të vlerësojnë edhe kostot shtesë me të cilat mund të përballen gjatë procesit të ristrukturimit dhe të administrimit të kolateralit që marrin në zotërim, në vijim të procesit të ekzekutimit. Deklarata thekson dhe nevojën për të monitoruar me kujdes zhvillimet në mjedisin e jashtëm që lidhen me veprimet e autoriteteve evropiane për rivlerësimin e cilësisë së aktiveve, të niveleve të kapitalizimit dhe të masave të ristrukturimit të grupeve më të mëdha bankare evropiane.

Çështje të stabilitetit financiar trajtohen dhe në botime të tjera të Bankës së Shqipërisë apo në fjalimet e administratorëve. Në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, paraqiten rregullisht edhe njoftimet për zhvillimin dhe përmbledhjen e mbledhjes së Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF).

PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE TË PROGRAMIT TË VLERËSIMIT TË SEKTORIT FINANCIAR (FSAP[28])

Gjatë vitit 2014, një pjesë e rëndësishme e punës së Bankës së Shqipërisë është fokusuar në përmbushjen e rekomandimeve të lëna në përfundim të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) të FMN-së dhe BB-së, të

[28] *Financial Sector Assessment Program.*

kryer në nëntor 2013. Në këtë kuadër mund të përmendim: përmirësimin e disa teknikave për ushtrimin e provës së rezistencës, identifikimin dhe monitorimin e treguesve me frekuencë të ulët që shërbejnë si "udhëheqës/ parashikues" për rrezikun sistemik; rritjen e efektivitetit në marrëdhënien me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për shkëmbimin e informacionit mbi ekspozimin dhe rreziqet mes sektorit bankar dhe atij financiar jobankar; ndërtimin e kuadrit të procedurave për veprimet e autoriteteve publike në rast të një rreziku sistemik në sistemin financiar dhe evidentimin e rolit të Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit financiar; si dhe fokusimin dhe mbështetjen më të mirë të punës së GKSF-së përmes rishikimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis anëtarëve.

II.2.2. ECURIA E SEKTORIT BANKAR

Ecuria e sektorit bankar gjatë vitit 2014 vlerësohet e qëndrueshme. Vëllimi i aktivitetit shënoi rritje dhe shëndeti financiar u përmirësua. Likuiditeti dhe treguesit e kapitalizimit mbetën në nivele të qëndrueshme gjatë vitit. Cilësia e portofolit të kredisë vijon të mbetet shqetësuese, ndonëse ka shënuar përmirësim të lehtë në krahasim me një vit më parë. Mbulimi me provigjione dhe kolateralizimi i kredisë me probleme është në nivele të mira. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut është më i kufizuar se ndaj rrezikut të kredisë.

Sektori bankar mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri. Aktivet e tij në fund të dhjetorit 2014, u ngjitën në 91.7% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) me një rritje prej 1.2 pikë përqindje ndaj një viti më parë. Ky sektor mbizotërohet nga pesë banka - të cilat së bashku përbëjnë 68.4% të portofolit të kredisë së sistemit dhe 73.4% të depozitave.

Në fund të vitit 2014, aktivet e sektorit bankar u ngjitën në nivelin 1,294 miliardë lekë, duke shënuar një rritje vjetore prej 4.8%, nga 3.9% që ishte një vit më parë. Në rritjen e aktiveve ka kontribuar kryesisht zgjerimi i portofolit të kredisë dhe i atij të investimeve në letra me vlerë, duke reflektuar rritjen e pjesëmarrjes së sektorit në ankandet e titujve të borxhit të qeverisë.

Financimi i veprimtarisë është siguruar prej rritjes së depozitave nga publiku, të cilat zënë 82.3% të totalit të aktivit të sektorit bankar. Në nivel të agreguar, depozitat në banka në fund të vitit shënuan një normë rritjeje 4.6%, nga 3.6% që shënonin një vit më parë[29].

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj subjekteve jorezidente, është i ngjashëm me periudhën paraardhëse, duke reflektuar një varësi të ulët të sektorit bankar nga burimet e huaja të financimit. Pozicioni neto i sektorit ndaj jorezidentëve mbetet i theksuar në anën krediduese, me një rritje të lehtë gjatë periudhës.

[29] *Kjo shifër pasqyron totalin e depozitave të pranuara përfshirë edhe ato nga jorezidentë.*

REZULTATI FINANCIAR DHE TREGUESIT E PËRFITUESHMËRISË

Rezultati financiar neto i sektorit bankar ishte pozitiv përgjatë gjithë vitit, duke shënuar nivelin 11.2 miliardë lekë në dhjetor 2014. Në krahasim me fundin e vitit 2013, rezultati financiar neto është përmirësuar me 70.5%. Bankat kanë ulur kostot e financimit, gjë që së bashku me rënien e nivelit të fondeve rezervë për humbjet nga aktivet (provigjionimit) kanë çuar në rritje të treguesve mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar. Rezultati neto nga interesat u rrit me 12.9% në 44.6 miliardë lekë, si rezultat i rënies më të lartë të shpenzimeve për interesa në krahasim me të ardhurat nga interesat. Rezultati neto nga veprimtaritë e tjera zbriti në 8.2 miliardë lekë.

Tabelë 6. Tregues të përfitueshmërisë nga veprimtaria kryesore në përqindje (kumulative)

Treguesit	Dhjetor`11	Dhjetor`12	Dhjetor`13	Dhjetor`14
Të ardhura nga interesat/aktive mesatare që sjellin të ardhura (1)	7.78	7.73	7.32	6.28
Shpenzime për interesa /aktive mesatare që sjellin të ardhura (2)	3.57	3.72	3.42	2.14
Marzhi Neto nga Interesat (NIM) {(1)-(2)}	4.20	4.01	3.89	4.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Normat e kthimit vjetor nga aktivet mesatare dhe nga kapitali mesatar ishin përkatësisht 0.89% dhe 10.53%, duke u përmirësuar ndjeshëm në krahasim me një vit më parë kryesisht si rezultat i rritjes së përfitueshmërisë së sistemit.

KAPITALIZIMI I VEPRIMTARISË

Struktura e kapitalit rregullator paraqitet e favorshme në drejtim të kapacitetit për të mbuluar humbjet e mundshme, pasi ai vijon të mbizotërohet nga kapitali bazë, në masën 81.9%. Ritmet më të larta të rritjes së aktiveve me rrezik kundrejt kapitalit rregullator, ndikuan në rënien e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin 16.84% nga 17.96% që rezultonte një vit më parë. Megjithatë, niveli aktual është dukshëm më i lartë se minimumi rregullator në nivelin 12%.

CILËSIA E KREDISË

Në dhjetor 2014, kreditë me probleme përbëjnë 22.8% të portofolit të kredisë, duke u përmirësuar me 0.7 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Kredia me probleme e bizneseve është përmirësuar me 1 pikë përqindje në nivelin 26.7% të portofolit përkatës, dhe për individët me 0.2 pikë përqindje në nivelin 16.5% të portofolit përkatës.

Brenda portofolit të kredive me probleme, vijon migrimi i kredisë drejt kategorisë "të humbura". Kjo prirje rrit varësinë e performancës së bankave ndaj proceseve të ekzekutimit të kolateralit dhe fshirjes së kredive të humbura. Kalimi i kredive në klasat me cilësi më të ulët, është shoqëruar me një rritje prej rreth 4.8% të vlerës së fondeve rezervë.

GJENDJA E LIKUIDITETIT

Gjendja e likuiditetit për sistemin bankar është në nivele të kënaqshme dhe Banka e Shqipërisë vlerëson se ekspozimi i sistemit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit është i ulët. Në fund të vitit 2014, raporti i aktiveve likuide me detyrimet afatshkurtra rezultoi 40.4% në nivel agregat dhe 55% për monedhën vendase (ose një rritje prej 12.3 pikë përqindje nga e njëjta periudhë e një viti më parë) dhe 26.1% për valutën (në të njëjtat nivele sikurse një vit më parë). Secili tregues qëndron ndjeshëm mbi nivelin minimal të kërkuar nga kuadri rregullator. Rritja e treguesit të likuiditetit në lekë është ndikuar edhe nga ndryshimi i rregulloreve të Bankës së Shqipërisë "Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë" dhe "Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellë të riblerjes", të cilat në mënyrë të tërthortë u reflektuan në kriteret e aktiveve për t'u konsideruar si likuide.

Gjatë vitit, angazhimet e marra nga bankat mëma, në formën e linjave të financimit janë ngushtuar, megjithatë pjesa e përdorur e saj mbetet në nivele të njëjta të moderuara. Depozitat mbeten burimi kryesor i financimit të veprimtarisë së sektorit bankar. Ato kanë përgjithësisht një përqendrim të ulët. Në fund të vitit 2014, 10 depozituesit më të mëdhenj zënë 6.1% të totalit të depozitave të sistemit bankar, 20 më të mëdhenjtë zënë 8.2% dhe 50 më të mëdhenjtë zënë 11.6%.

EKSPOZIMI NDAJ LËVIZJEVE NË KURSIN E KËMBIMIT DHE NORMËN E INTERESIT

Në fund të dhjetorit 2014, pozicioni i hapur neto në valutë ishte "në blerje", në masën 8.5% të vlerës së kapitalit rregullator, duke sugjeruar një ekspozim të kufizuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Edhe ekspozimi i sektorit bankar ndaj luhatjeve të normës së interesit konsiderohet relativisht i kufizuar, në kushtet kur pesha e kësaj diference në totalin e aktiveve, nuk është në vlera të konsiderueshme. Ndërkohë, kreditimi në monedhë të huaj përbën 59% të totalit të portofolit të kredisë dhe kredia e pambrojtur në valutë përfaqëson rreth 31% të portofolit të kredisë, çka e ekspozon tërthorazi sektorin ndaj rrezikut të tregut për individët dhe bizneset.

USHTRIMI I PROVËS SË REZISTENCËS DHE REZULTATET

Nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës vlerësohet stabiliteti i sistemit financiar dhe mjaftueshmëria e kapitalit në sektorin bankar për një periudhë kohore deri në fund të vitit 2015. Prova e rezistencës vlerëson ndikimin që situata të ndryshme makroekonomike ushtrojnë në gjendjen financiare të sektorit bankar, duke përjashtuar mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës së marrë në konsideratë. Analiza përmban tre skenarë: një skenar bazë, i cili bazohet në parashikimet e treguesve ekonomikë dhe financiarë sipas ecurisë së tyre historike; dhe dy skenarë të rënduar të cilët përfshijnë

rritje të normave të interesit, ngadalësim ose tkurrje të aktivitetit kreditues dhe nënçmim të kursit të këmbimit. Rezultatet e ushtrimit në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit tregojnë se në tërësi, sektori bankar mbetet i mirëkapitalizuar. Gjithsesi, bankat e mesme kanë norma më të ulëta të mjaftueshmërisë së kapitalit, në krahasim me grupet e tjera bankare.[30]

Për sa i përket ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut, ushtrimi bazohet në marzhin reduktues të aplikuar ndaj vlerës së investimeve në letra të huaja. Rezultatet tregojnë se sektori vazhdon të jetë i ndjeshëm ndaj ekspozimit të letrave me vlerë të borxhit tregtar, ndërsa rreziku që rrjedh nga ekspozimi ndaj letrave me vlerë të borxhit sovran është i kufizuar.

Së fundi, ushtrimi i cili vlerëson ekspozimin e sektorit bankar ndaj grupeve bankare zotëruese, konfirmon se banka të veçanta janë të ekspozuara ndaj këtij rreziku, por në tërësi, sektori bankar mbetet i mbrojtur nga ky rrezik për shkak të pozitave të shëndosha të kapitalizimit.

II.3. MBIKËQYRJA BANKARE

- *Funksioni mbikëqyrës në Bankën e Shqipërisë mbështetet në tre shtylla bazë: licencim, rregullim dhe mbikëqyrje. Kjo e fundit realizohet nëpërmjet kryerjes së analizave nga jashtë dhe ekzaminimeve në vend[31]. Mbikëqyrja dhe rregullimi i vazhdueshëm i veprimtarive financiare në vend, kryesisht të veprimtarisë bankare, mbetet në fokusin e këtij funksioni dhe përbën veprimtarinë kryesore të tij.*

Gjatë vitit 2014, janë kryer në mënyrë të vazhdueshme ekzaminimet e subjekteve financiare të licencuara, si nëpërmjet inspektimeve në vend ashtu dhe nëpërmjet analizave nga jashtë. Gjithashtu, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm me industrinë bankare për të diskutuar dhe tërhequr opinionin e saj në lidhje me përmirësimet rregullatore dhe ndikimet e mundshme të tyre.

Në përgjigje të rrezikut të rritur të kredisë, është ndërmarrë një përqasje proaktive mbikëqyrëse, duke e kanalizuar analizën në nivele mikro (në kredimarrës individualë) me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme me përfitim reciprok të të dy palëve. Kjo platformë për adresimin e kredive me probleme synon gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për kredimarrësit, krijon hapësira më të mëdha bashkëpunimi midis bankave si dhe ndikon aktivitetin ekonomik të vendit nëpërmjet krijimit të likuiditeteve të nevojshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së investitorëve dhe të korporatave.

---

[30] *Bankat e sektorit bankar shqiptar ndahen sipas madhësisë së aktivitetit të tyre në:*
- banka të Grupit 1 (banka të vogla), ku secila zë nga 0-2% të totalit të aktiveve të sektorit.
- banka të Grupit 2 (banka të mesme), ku secila zë nga 2-7% të totalit të aktiveve të sektorit.
- banka të Grupit 3 (banka të mëdha), ku secila zë mbi 7% të totalit të aktiveve të sektorit.

[31] *Banka e Shqipërisë publikon informacion të detajuar mbi zhvillimet në sistemin bankar dhe procesin e mbikëqyrjes bankare në Raportet Vjetore të Mbikëqyrjes.*

II.3.1. KUADRI RREGULLATIV

Gjatë vitit 2014 u hartuan akte të reja rregullatore dhe u rishikuan disa prej akteve ekzistuese. Qëllimi kryesor ishte përafrimi me standardet e Komitetit të Bazelit dhe direktivat evropiane, si dhe përshtatja me zhvillimet e brendshme. Gjithashtu gjatë këtij viti, u kryen disa ndryshime të kuadrit rregullator mbikëqyrës, në zbatim të rekomandimeve të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar të lëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, gjatë vitit 2013, me qëllim vlerësimin e zbatimit të 29 parimeve të Komitetit të Bazelit për një Mbikëqyrje Efektive[32].

Akte të reja rregullatore dhe të rishikuara tërësisht gjatë vitit 2014:

- Dokumenti "Politika e Mbikëqyrjes", i cili përcakton politikën e mbikëqyrjes të bazuar në rrezikun për bankat dhe grupet bankare ose financiare, për të cilat Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës përgjegjës. Objektivi kryesor është sigurimi i një procesi efikas për vlerësimin e gjendjes financiare dhe të qëndrueshmërisë së bankave.
- Rregullorja "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", e cila përcakton rregullat dhe kriteret për llogaritjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të bankës ndaj një personi/klienti ose grupi personash/klientësh të lidhur ndërmjet tyre me bankën, me qëllim administrimin e rrezikut që rrjedh nga ekspozimi i përqendruar ndaj tyre. Ajo hyri në fuqi më 1 janar 2015.
- Udhëzimi "Mbi planet e rimëkëmbjes", i cili përcakton parimet themelore dhe kërkesat mbikëqyrëse mbi strukturën dhe përmbajtjen e Planeve të Rimëkëmbjes së bankave, si dhe raportimin e tyre pranë Bankës së Shqipërisë.
- Rregullorja "Për kapitalin rregullator të bankës", e cila përcakton strukturën, elementët përbërës dhe metodën e llogaritjes së kapitalit rregullator të bankës, si dhe nivelin minimal të tij.

Akte rregullatore të rishikuara pjesërisht gjatë vitit 2014:

- Rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja" pësoi ndryshime të pjesshme, në zbatim të rekomandimeve të FMN/BB lidhur me administrimin e rrezikut të kredisë. Këto ndryshime rregullatore hynë në fuqi më 1 janar 2015.
- Rregullorja "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor" pësoi ndryshime të pjesshme, me qëllim forcimin e proceseve mbikëqyrëse dhe rritjen e disiplinës së tregut lidhur me mbrojtjen e konsumatorit në aktivitetet e këmbimeve valutore.
- Rregullorja "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" pësoi ndryshime të pjesshme, në kuadër të paketës së masave për përmirësimin e klimës së kredidhënies në vend, si dhe shtimit të formularëve raportues të kërkesave për kapital (COREP) dhe udhëzuesit metodologjik për plotësimin e tyre.

[32] *Basel Core Principles for Effective Banking Supervision.*

- Rregullorja "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë" pësoi ndryshime të pjesshme në zbatim të rekomandimeve të Misionit FSAP (2013), lidhur me disa kritere shtesë për miratimin e transferimit të pjesëmarrjes influencuese në banka dhe të disa kritereve për kryerjen e shërbimeve bankare dhe/ose financiare ndërkufitare.

II.3.2. KUADRI LICENCUES DHE MIRATIMET

Struktura e sektorit bankar shqiptar gjatë vitit 2014 mbeti e pandryshuar, e përbërë nga 16 banka tregtare me origjinë kapitali të huaj dhe vendas. Shumica e sektorit bankar kontrollohet nga filialet e grupeve të huaja bankare me origjinë kapitali nga Bashkimi Evropian dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 7. Struktura e pronësisë së bankave (numri i bankave, fund i periudhës)

	2010	2011	2012	2013	2014
Bankat në Shqipëri, prej të cilave:	16	16	16	16	16
Degë të bankave të huaja	2	2	0	0	0
Shumica[1] me kapital privat sipas ndarjeve të mëposhtme:					
Me kapital privat në shumicën e pronësisë të huaj:	14	14	14	14	14
- me shumicë kapitali të huaj nga vendet e Bashkimit Evropian[2]	10	10	10	10	10
- me shumicë kapitali me origjinë turke [3]	1	1	1	1	1
- me shumicë kapitali nga një institucion financiar ndërkombëtar (Arabia Saudite)	1	1	1	1	1
- me shumicë kapitali me origjinë kuvajtiane[4]	1	1	1	1	1
- me shumicë kapitali nga Konfederata e Zvicrës[5]	1	1	1	1	1
Me kapital privat me shumicën e pronësisë vendase[6]	2	2	2	2	2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1 *"Shumicë" është në çdo rast shumica e thjeshtë 50% e votave, plus 1 votë.*

2 *Bankat me origjinë kapitali nga vendet e BE-së janë nga: Italia (Banka Intesa Sanpaolo Albania, Banka Veneto), Austria (Banka Raiffeisen), Gjermania (Banka Procredit), Franca (Banka Societe Generale Albania, Banka Credit Agricole Shqipëri), Greqia (Banka Tirana, Banka Alpha Albania, Banka NBG Albania), Bullgaria (Banka e Parë e Investimit).*

3 *Banka Kombëtare Tregtare.*

4 *Banka e Kreditit të Shqipërisë.*

5 *Banka Ndërkombëtare Tregtare me aksioner Financial Group ICB Holding.*

6 *Bankat me shumicë kapitali vendas janë: Banka Union (me 88.82%) dhe Banka Credins (me 76.92%).*

Në përputhje dhe zbatim të kërkesave që rrjedhin nga ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të funksionimit normal të aktivitetit bankar, Banka e Shqipërisë ka mbështetur bankat në aplikimet e tyre gjatë vitit 2014, duke vlerësuar kërkesat e përcaktuara në rregulloret e mbikëqyrjes.

Miratimet për kryerjen e veprimtarive shtesë në anekset e licencave të bankave, konsistuan në vlerësimin dhe miratimin e kërkesës së një banke për shtimin e veprimtarisë së tregtimit për llogari të bankës qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar të letrave me vlerë të transferueshme. Edhe gjatë këtij viti, vazhdoi vlerësimi i kërkesave të bankave për kryerjen e veprimtarisë

së ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime (ende në proces aplikimi pranë Bankës së Shqipërisë), si dhe mbështetja e bankave të interesuara, në plotësimin e kushteve ligjore/rregullatore për kryerjen e kësaj veprimtarie.

Bankat kanë paraqitur kërkesa për ndryshim të rrjetit të tyre bankar, si në drejtim të zgjerimit ashtu edhe të reduktimit (nëpërmjet mbylljes, bashkimit/transferimit) të degëve/agjencive brenda vendit. Në fund të vitit 2014, bankat ushtrojnë veprimtarinë e tyre me 500 degë/agjenci bankare.

Në procesin licencues, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit të parimeve dhe rregullave bazë për një drejtim të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave, duke vlerësuar strukturat e tyre organizative, menaxhimin, si dhe ndarjen e përgjegjësive. Bazuar në rregulloren "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre", Banka e Shqipërisë miratoi 65 administratorë të rinj, të cilët sipas pozicioneve drejtuese ndahen në: 18 anëtarë të këshillave drejtues, 10 anëtarë të komiteteve të kontrollit dhe 37 drejtues ekzekutivë. Pjesë e miratimit ishin edhe administratorët e subjekteve financiare jobanka.

Edhe gjatë vitit 2014, mbi bazën e aplikimeve të paraqitura, Banka e Shqipërisë akordoi licenca dhe dha miratime për subjekte financiare, të cilat janë pjesë e kuadrit licencues dhe mbikëqyrës të saj.

Tabelë 8. Numri i subjekteve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë (fund periudhe)

	2010	2011	2012	2013	2014
Banka dhe degë të bankave të huaja	16	16	16	16	16
Subjekte financiare jobanka	17	19	21	21	22
Zyra të këmbimit valutor	284	301	322	333	356
Unione të shoqërive të kursim-kreditit	2	2	2	2	2
Shoqëri të kursim-kreditit	126	126	126	121	113

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tregun financiar jobankar, viti 2014 u shoqërua me licencimin e një subjekti të ri në fushën e veprimtarisë së qirasë financiare, duke e çuar numrin e subjekteve financiare jobanka të licencuara në 22. Pjesë e miratimeve të dhëna për subjektet financiare jobanka ishin miratimi i transferimit të pjesëmarrjes influencuese në masën 100% të kuotave të kapitalit dhe miratimi i zvogëlimit të kapitalit të një subjekti financiar jobankë.

Licencimi i zyrave të këmbimit valutor vijoi edhe gjatë vitit 2014, me një ritëm më të lartë rritjeje në krahasim me një vit më parë. Konkretisht, u licencuan 33 subjekte të reja për veprimtarinë e zyrave të këmbimit valutor,ndërkohë që 10 subjekte të licencuara për ushtrimin e kësaj veprimtarie dorëzuan licencat pranë Bankës së Shqipërisë, si rrjedhojë e ndërprerjes së aktivitetit. Në fund të vitit 2014, në tregun e këmbimeve valutore kryejnë aktivitet 356 zyra të këmbimit valutor të licencuara. Miratime u dhanë edhe për shtimin e kambistëve që ushtrojnë veprimtarinë në zyrat ekzistuese të këmbimit valutor.

Për sa i takon licencimit të shoqërive të kursim-kreditit, as ky vit nuk pati licencime të reja. Numri i shoqërive të kursim-kreditit vazhdoi të reduktohet, si rezultat i revokimit të 8 licencave për nisje të procedurave për likuidim nga ana e tyre.

II.3.3. EKZAMINIMET NË VEND

Ekzaminimet në vend, si pjesë mjaft e rëndësishme e procesit mbikëqyrës, synojnë shqyrtimin dhe vlerësimin nga afër të profilit të rrezikut të subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë. Planifikimi dhe organizimi i tyre bazohet në disa shtylla kryesore si: zhvendosja drejt një mbikëqyrjeje të bazuar në rrezik, sigurimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të licencuara me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe rritja e efektivitetit të instrumenteve të mbikëqyrjes. Me rëndësi thelbësore në procesin e planifikimit të mbikëqyrjes në vend janë edhe rezultatet e analizës nga jashtë. Ky funksion monitoron në mënyrë dinamike dhe nëpërmjet një procesi proaktiv gjendjen financiare të çdo subjekti të licencuar, si edhe të sistemit bankar në tërësi, duke identifikuar problemet ekzistuese dhe të së ardhmes, si dhe shërben si një sistem i paralajmërimit të hershëm.

Gjatë vitit 2014, janë zhvilluar 9 ekzaminime në institucionet financiare banka dhe jobanka. Këtu përfshihen 4 ekzaminime të plota për vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të subjekteve bankare dhe 1 ekzaminim i plotë në subjekte financiare jobanka. Gjithashtu, janë kryer 2 ekzaminime të veçanta me qëllim vlerësimin e rreziqeve specifike të subjekteve bankare, kryesisht të rrezikut të kredisë. Ndjekja dhe niveli i zbatimit të planit të masave korrektuese përbën një tjetër fokus të mbikëqyrjes në vend. Për këtë qëllim është zhvilluar 1 ekzaminim pranë një subjekti bankar dhe 1 tjetër pranë një institucioni jobankë. Në vëmendje të Bankës së Shqipërisë ka qenë edhe bashkëpunimi me autoritete të tjera mbikëqyrëse si Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Gjatë vitit janë zhvilluar 4 ekzaminime pranë bankave depozitare dhe shoqërive administruese të fondeve të përbashkëta.

Konkluzionet e dala nga ekzaminimet në vend tregojnë se përgjithësisht aktiviteti i subjekteve të licencuara është zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe të atij rregullator mbikëqyrës. Rekomandimet synojnë përmirësimin e praktikave të administrimit të rreziqeve, në drejtim të:

- Forcimit të qeverisjes së subjekteve të licencuara, veçanërisht forcimit të strukturave mbikëqyrëse dhe atyre drejtuese;
- Forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm të subjekteve të ekzaminuara me qëllim identifikimin, matjen dhe monitorimin e rreziqeve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar veprimtarisë së niveleve të ndryshme të kontrollit si njësisë së kontrollit të brendshëm, funksionit të rrezikut dhe përputhshmërisë etj.;
- Rishikimit të vazhdueshëm të kuadrit të brendshëm që rregullon praktikat e administrimit të rreziqeve në përputhje me kërkesat mbikëqyrëse;
- Përmirësimit të standardeve të aprovimit të kredisë, monitorimit të vazhdueshëm të portofolit në vonesë dhe forcimit të punës për rikuperimin e tyre;
- Sigurimit të përputhshmërisë rregullatore lidhur me trajtimin e aktivitetit të investimeve në letra me vlerë.

Rreziku i kredisë vijon të mbetet rreziku kryesor ndaj të cilit ekspozohen subjektet e licencuara, ndikuar si nga faktorë të jashtëm (kushtet ekonomike, konkurrenca etj.) ashtu dhe nga faktorë të brendshëm (strukturat e bilanceve, standardet e kredidhënies, sistemet e kontrollit etj.). Si i tillë, këtij rreziku i është kushtuar një vëmendje dhe angazhim më i madh burimesh njerëzore gjatë ekzaminimeve në vend. Ekzaminimet kanë kërkuar riklasifikim të kategorisë së rrezikut për kredimarrës të caktuar, përmirësimin e praktikave të identifikimit, matjes dhe monitorimit të ekspozimeve të bankës ndaj një kredimarrësi apo grup kredimarrësish të lidhur. Vitet e fundit, subjektet e licencuara kanë njohur ritme të ngadalta të rritjes së kredive krahasuar me periudhat e mëparshme, duke u përqendruar më tepër në rikuperimin e kredive në vonesë dhe shtrëngimin e kritereve të kreditimit. Në këto kushte, ekzaminimet kanë synuar evidentimin e faktorëve dhe përgjegjësive të brendshme që kanë ndikuar në përkeqësimin e cilësisë së kredive, me qëllim adresimin e dobësive dhe hapjen e rrugëve të reja për procese të shëndetshme kreditimi, të cilat mbështesin ekonominë në përgjithësi dhe aktivitetin e vetë subjekteve të licencuara.

Në përputhje me filozofinë mbikëqyrëse për një qasje prudenciale dhe parandaluese të dukurive negative, është kërkuar marrja e masave për adresimin e problematikës së portofolit në vonesë nëpërmjet forcimit të procesit të monitorimit të hershëm të vonesave, hartimit të strategjive të zgjidhjes për klientët problematikë, rritjes së efikasitetit në ristrukturimin e kredive etj. Gjithashtu, për një proces sa më transparent dhe të shëndetshëm të rikuperimit të kredive me probleme, gjatë ekzaminimeve në vend vëmendje e veçantë i është kushtuar trajtimit të pronave të fituara nëpërmjet proceseve ligjore, përpjekjeve për shitjen e tyre, parashikimeve të vlerave të tyre etj.

Një pjesë e rekomandimeve kanë pasur si synim përmirësimin e kërkesave cilësore për administrimin e rreziqeve të likuiditetit dhe të tregut, ndonëse ekspozimi i subjekteve ndaj tyre është vlerësuar në nivele të kënaqshme.

Analizat e provës së rezistencës (*stress-test*), si element i rëndësishëm i monitorimit të ekspozimit të subjekteve ndaj rreziqeve kanë qenë në fokus të procesit të mbikëqyrjes në vend, si në kushte normale dhe në situata jo të zakonshme të aktivitetit. Rekomandimet kanë adresuar nevojat për përmirësim të frekuencës së zhvillimit të tyre dhe përcjelljes së rezultateve pranë organeve drejtuese të subjekteve, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të politikave të brendshme të administrimit të rrezikut.

Pjesë integrale e inspektimeve të zhvilluara kanë qenë edhe vlerësimi i transparencës me publikun dhe ekspozimi ndaj rrezikut operacional dhe teknologjisë së informacionit.

TRANSPARENCA DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT

Prioriteti i Bankës së Shqipërisë në drejtim të transparencës ka qenë monitorimi, identifikimi, matja dhe vlerësimi i plotësimit të kërkesave të detyrueshme për zbatim nga bankat për informimin e klientëve, mbi produktet dhe shërbimet

bankare e financiare të ofruara nga sistemi bankar. Konstatohet se është rritur ndërgjegjësimi i sektorit bankar për çështjet e transparencës dhe publikimit të informacionit. Është kryer rishikimi i elementëve të marrëveshjes së kredisë, në përputhje me kërkesat rregullatore, si dhe informimi parakontraktor i klientëve. Tashmë të gjitha bankat publikojnë në faqen e tyre të internetit raportet vjetore dhe ato tremujore.

Gjatë vitit 2014, është bërë kujdes në mënyrë të vazhdueshme për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë, të raportimeve të bankave për komisionet dhe normat e interesit për kreditë dhe depozitat.

RREZIKU OPERACIONAL

Sistemi bankar ka shfaqur progres në monitorimin dhe administrimin e rrezikut operacional.

Gjatë ekzaminimit në vend të bankave është konstatuar një rritje e përfshirjes së drejtimit të lartë në zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm politikash që rregullojnë administrimin e këtij rreziku. Kjo gjë ka ndikuar në zhvillimin e mëtejshëm të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut operacional, ashtu edhe të monitorimit dhe raportimit të tij. Sistemi përgjithësisht ka reaguar në mënyrë pozitive ndaj kërkesave të autoritetit duke përdorur teknika zbutëse dhe duke hartuar e zbatuar edhe procedura të brendshme që i shërbejnë këtij qëllimi.

Aktiviteti i inspektimeve në vend në lidhje me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit ka qenë pjesë e inspektimit të plotë të katër bankave dhe e një inspektimi të targetuar. Ekzaminimet kanë konstatuar vështirësi në administrimin e rreziqeve të lidhura me teknologjinë e informacionit, me implementimet e planeve të vazhdimësisë së punës në rast fatkeqësie, si dhe me menaxhimin e incidenteve të sigurisë së informacionit. Mangësitë e rezultuara gjatë ekzaminimeve janë shoqëruar me rekomandimet përkatëse.

PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Gjatë vitit 2014, nëpërmjet inspektimeve në vend, ka vijuar mbikëqyrja rigoroze e çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit.

Aspekt i rëndësishëm i punës ka qenë nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit në 10 qershor 2014 ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, në kuadër të luftës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, është ndjekur dhe raportuar në vazhdimësi tek institucionet përkatëse zbatimi i planit të masave dhe rekomandimet e komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës dhe FATF (*Financial Action Task Force*).

Masat e marra për zbatimin e ndryshimeve ligjore dhe për harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e organizmave

ndërkombëtarë, në vitin 2013, kanë rritur efikasitetin e masave parandaluese për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

II.3.4. SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA, UNIONET DHE SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT

Gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka vijuar komunikimin institucional me subjektet jobankare të licencuara prej saj, me fokus të veçantë në përputhshmërinë me kuadrin rregullator. Kapacitete të konsiderueshme mbikëqyrëse janë angazhuar në rishikimin e kuadrit ligjor për unionet dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Në funksion të rishikimit të ligjit, janë zhvilluar takime konsultative me shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet si dhe është bashkëpunuar ngushtë me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, me Bankën Botërore dhe me Korpusin e Vullnetarëve të Shërbimeve Financiare (FSVC). Viti 2014 shënoi punën bazë për hartimin e projektligjit të unioneve dhe shoqërive të kursim-kreditit, punë e cila do të finalizohet në vitin në vijim, pas konsultimeve me sektorin përkatës.

II.3.5. REGJISTRI I KREDIVE

Regjistri i Kredive vazhdon të operojë me sukses duke përmbushur funksionin kryesor të tij për të lehtësuar administrimin e rrezikut të kredisë dhe për të bërë më efektiv procesin mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në fund të vitit 2014, ky regjistër përmban të dhëna të raportuara nga 31 subjekte bankare dhe financiare për një numër prej 1,042,276 kredish të raportuara, nga të cilat 405,573 janë kredi aktive dhe të tjerat janë kredi të mbyllura ndër vite, përfshirë edhe kreditë e fshira nga bilanci. Kreditë e raportuara në Regjistrin e Kredive të cilat kanë 5 (pesë) vjet që janë mbyllur nga kredimarrësit apo fshirë nga bilanci i subjektit raportues, fshihen nga regjistri në përputhje me procedurat përkatëse.

Subjektet bankare numërojnë 327,694 kredi aktive, subjektet financiare jobanka që kryejnë kredidhënie dhe qira financiare kanë raportuar 58,622 kredi aktive, ndërkohë që unionet e kursim-kreditit dhe shoqëritë e kursim-kreditit numërojnë 19,257 kredi aktive në total, nga kreditë e raportuara të sistemit.

II.3.6. VEPRIMTARI TË VEÇANTA MBIKËQYRËSE

PËRMBUSHJA E KRITEREVE TË BANKËS BOTËRORE PËR KREDINË PËR POLITIKAT E ZHVILLIMIT

Kredia për politikat e zhvillimit (*Development Policy Loans*, në vijim DPL) është një instrument i Bankës Botërore për përmbushjen e disa objektivave

të zhvillimit, në funksion të përfitimit të kredive mbështetëse për qeverinë shqiptare. Banka e Shqipërisë ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj në kuadër të këtij instrumenti.

- U miratua Politika e Mbikëqyrjes dhe Manuali i Vlerësimit të Rreziqeve, dokumente të cilat hynë në fuqi në datën 1 janar 2015.
- U miratua rregullorja "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave"[33].
- U bënë ndryshime rregullative në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë" duke vendosur kritere për fshirjen e kredive të humbura të bankave pas kalimit të një afati të caktuar[34].
- Përgjatë vitit 2014, është punuar për përgatitjen e ligjit të ri për shoqëritë e kursim-kreditit, punë e cila vijon edhe gjatë vitit 2015 dhe është brenda afatit të parashikuar në DPL.

KALIMI NË MBIKËQYRJEN E BAZUAR NË RREZIK

Në vitin 2014 u intensifikua puna për zbatimin e plotë të metodologjisë së mbikëqyrjes të bazuar në rrezik. Më konkretisht, u hartuan dhe miratuan dy dokumente të rëndësishme, ai i "Politikës së Mbikëqyrjes[35]" dhe "Manuali i Vlerësimit të Rreziqeve".

Politika e re e Mbikëqyrjes synon rritjen e mëtejshme të efektivitetit të mbikëqyrjes bankare. Ky dokument sjell një sërë përparësish, si për mbikëqyrësit ashtu edhe për bankat, duke u fokusuar në mbikëqyrjen e bankave dhe të aktiviteteve që shfaqin një rrezik më të lartë apo prirje negative. Ai nxit bankat të përmirësojnë aftësitë e tyre për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rreziqet, si dhe për të korrigjuar mangësitë e vërejtura përgjatë këtyre proceseve. Gjithashtu, Dokumenti i Politikës inkurajon komunikime të shpeshta dhe të hapura ndërmjet bankave dhe mbikëqyrësve, të cilat sigurohen nëpërmjet takimeve në faza të ndryshme të procesit dhe iu mundësojnë mbikëqyrësve të kuptojnë më mirë strategjinë e bankës, rreziqet me të cilat përballet, cilësinë e administrimit të rrezikut, si dhe arritjet në adresimin e mangësive të identifikuara gjatë procesit mbikëqyrës.

Njëkohësisht, Politika e Mbikëqyrjes përmirëson cilësinë e punës së mbikëqyrjes bankare, pasi zhvillimet e reja dhe ndryshimet strategjike në një institucion të caktuar apo zhvillimet sektoriale në rreziqe specifike monitorohen në mënyrë më të detajuar përgjatë gjithë ciklit mbikëqyrës. Ajo siguron një administrim më të mirë nga pikëpamja kohore të burimeve njerëzore, duke mundësuar shkurtimin e kohës së shpenzuar gjatë mbikëqyrjes në vend, në kushtet kur analiza paraprake kryhet nga jashtë.

---

[33] *Për më tepër, referojuni seksionit më sipër "II.2.1.Vlerësimi i rreziqeve dhe veprimet për administrimin e tyre".*

[34] *Për më tepër, referojuni seksionit më sipër "II.2.1.Vlerësimi i rreziqeve dhe veprimet për administrimin e tyre".*

[35] *Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 9 datë, 26.02.2014.*

Së bashku me Politikën e Mbikëqyrjes u miratua dhe Manuali i Vlerësimit të Rreziqeve, i cili hyri në fuqi më datë 1 janar 2015. Objektivi kryesor i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik është që të sigurojë një proces efikas për vlerësimin e gjendjes financiare dhe të qëndrueshmërisë së bankave. Manuali i ri sjell ndryshime cilësore krahasuar me manualin e mëparshëm, në lidhje me implementimin e procedurave të reja të ekzaminimit dhe vlerësimin e rreziqeve të reja (rreziku strategjik dhe organizativ, rreziku i normës së interesit në librat e bankës dhe rreziku operacional, të cilët duhet të përfshijnë dhe module mbi rrezikun e teknologjisë së informacionit dhe përputhshmërisë, AML/CTF dhe transparencës). Sistemi i ri i vlerësimit të rrezikut, prezanton një algoritëm të strukturuar për të përcaktuar vlerësimin e rrezikut të përgjithshëm të bankës bazuar në vlerësimin individual të secilit prej rreziqeve.

PLATFORMA E ADRESIMIT TË KREDIVE ME PROBLEME

Viti 2014 regjistroi zhvillime interesante edhe në administrimin e portofolit të kredive të këqija. Vlen të veçohet iniciativa e ndërmarrë për të analizuar dhe hartuar plane rimëkëmbjeje dhe zgjidhjeje për kredimarrësit më të mëdhenj të sistemit, në vështirësi shlyerjeje dhe të ekspozuar në disa banka njëkohësisht. Për kredimarrësit e përzgjedhur, pasi është marrë pëlqimi paraprak për shkëmbimin e informacionit midis bankave, janë propozuar mundësitë më të mira për një zgjidhje të qëndrueshme të aftësisë paguese të kredimarrësit dhe vijimësisë së biznesit. Kjo iniciativë është mbështetur nga projekti FinSAC i Bankës Botërore, i cili ka angazhuar një shoqëri ndërkombëtare me eksperiencë në këtë drejtim. Kjo iniciativë do të vijojë të zbatohet edhe gjatë vitit 2015.

KALIMI NGA BAZEL I NË BAZEL II

Në kuadrin e përafrimit me direktivën evropiane 2006/48/EC "Mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit" dhe direktivën 2006/49/EC "Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërive të investimit dhe institucioneve të kreditit", u miratua rregullorja e re "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

Rregullorja shënon kalimin nga standardi Bazel I, në Akordin e Ri të Kapitalit ose të njohur si Bazel II. Qëllimi i kësaj rregulloreje ishte përshtatja e kuadrit rregullator të autoritetit mbikëqyrës, në funksion të përllogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, me qëllim adresimin më të mirë të nevojave për kapital të bankave për monitorimin, kryesisht të: rrezikut të kredisë; rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional, për të siguruar në çdo rast, nivelin e mjaftueshëm të këtij raporti.

Kërkesat e reja për kapital dhe tabelat e raportimit COREP të miratuara gjatë vitit 2014, sipas rregullores së BE-së për veprimtarinë e institucioneve të kreditit, do të zbatohen nga bankat e sistemit gjatë vitit 2015, pas një periudhe testimi paralel të kërkesave të reja me ato ekzistuese (në fuqi) përgjatë vitit 2014.

PLANET E RIMËKËMBJES DHE TË ZGJIDHJES

Në fillim të vitit 2014, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi dokumentin "Planet e rimëkëmbjes" në të cilin përmblidhen masat e mundshme të rimëkëmbjes për të siguruar kthimin në normalitet të veprimtarisë bankare në rast se materializohen skenarë të ndryshëm që dëmtojnë vazhdimësinë e saj. Këto masa janë konceptuar si zgjidhje me natyrë të jashtëzakonshme, të cilat nuk ndërmerren përgjatë veprimtarisë normale të biznesit. Planet e Rimëkëmbjes synojnë të reduktojnë probabilitetin e dështimit të bankave sistemike.

II.4. SISTEMI I PAGESAVE DHE EMETIMI I MONEDHËS

II.4.1. SISTEMI I PAGESAVE

- *Në përmbushje të përgjegjësisë së saj ligjore në fushën e sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë nxit dhe mbështet mirëfunksionimin e sistemit të brendshëm të pagesave në Shqipëri. Me qëllim arritjen e këtij objektivi, Banka e Shqipërisë aplikon tre lloje përqasjesh, të cilat janë plotësuese të njëra-tjetrës dhe bashkëveprojnë ndërmjet tyre: (i) luan rol operacional në ofrimin e sistemeve, (ii) kryen veprimtari mbikëqyrëse, dhe (iii) vepron si reformator i sistemit kombëtar të pagesave.*

Gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka përmbushur funksionet e saj si operator, mbikëqyrës dhe katalizator në fushën e sistemeve të pagesave. Me qëllim përafrimin me praktikat ndërkombëtare dhe ato evropiane në fushën e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, është rishikuar dokumenti "Politika e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes"[36]. Nëpërmjet rishikimit është mundësuar një harmonizim i politikave mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë me ligjin "Për sistemin e pagesave" si dhe një përafrim i funksioneve dhe politikave të Bankës së Shqipërisë me ato të Bankës Qendrore Evropiane. Gjithashtu, nëpërmjet këtij rishikimi mundësohet informimi i tregut mbi parimet për mbikëqyrjen e infrastrukturës së tregjeve financiare, të publikuara nga Banka Ndërkombëtare për Rregullim në prill të vitit 2012, të vëna në zbatim edhe në Shqipëri.

Në përmbushje të funksionit të saj si operatore dhe administratore e sistemeve të pagesave, gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese (sistemit AIPS dhe AECH), dhe për krijimin e infrastrukturave të reja, të tilla si sistemi qendror i regjistrimit dhe i shlyerjes së titujve (AFISaR). Këto zhvillime vlerësohet të kontribuojnë në mënyrë të qenësishme në rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të sistemeve të pagesave, si dhe të krijojnë hapësira të reja për zhvillimin e infrastrukturës së tregjeve financiare. Ato janë shoqëruar edhe me përditësimin dhe përmirësimin e bazës rregullatore të zbatuar.

[36] *Vendimi nr. 32, datë 30.04.2014 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.*

Me qëllim promovimin e rolit të Bankës së Shqipërisë si katalizator në fushën e sistemit të pagesave dhe konsolidimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, është hartuar rregullorja "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave"[37]. Kjo nismë është bazuar në të drejtën dhe detyrimin e gjeneruar nga neni 4 i ligjit nr.133/2013, datë 29.04.2013 "Për Sistemin e Pagesave". Formalizimi i ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm në këtë fushë do të rrisë efikasitetin e reformave në fushën e sistemeve të pagesave si dhe do të akomodojë nevojat për bashkëpunim përtej aktorëve tradicionalë të fushës. Një praktikë e tillë konsiderohet e domosdoshme nën dritën e praktikave ndërkombëtare dhe më konkretisht të atyre të Bashkimit Evropian.

Viti 2014 ka shënuar përmirësime në cilësinë dhe gamën e të dhënave statistikore për instrumentet e pagesave. Duke pasur si udhërrëfyes praktikat më të mira ndërkombëtare dhe zhvillimet e tregut të shërbimeve dhe sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë rishikoi metodologjinë "Për raportimin e instrumenteve të pagesave". Rishikimi i metodologjisë synon përafrimin e praktikave raportuese me standardet e Bankës Qendrore Evropiane dhe të Bankës Ndërkombëtare për Rregullim dhe mundëson shtrirjen e analizave dhe studimeve edhe në rrafshin rajonal dhe atë ndërkombëtar.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar aktivitetit kërkimor në fushën e pagesave dhe më konkretisht matjes së kostove të instrumenteve të ndryshme të pagesave në ekonominë shqiptare. Banka e Shqipërisë në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore, ka punuar për hartimin e metodologjisë të këtij studimi dhe mbledhjen e të dhënave të nevojshme[38]. Kryerja e një studimi të tillë është vlerësuar shumë efektive nga bankat qendrore të vendeve të zhvilluara si në kuadër të luftës kundër përdorimit të parasë fizike në ekonomi ashtu edhe në kuadër të identifikimit të mundësive për reduktimin e kostove që mbart përdorimi i instrumenteve të pagesave në ekonomi. Realizimi i një studimi të tillë në Shqipëri do të mbështesë analizimin dhe kuptimin e kostove reale dhe sociale të përdorimit të instrumenteve të pagesave, procesin vendimmarrës në kuadër të modernizimit të sistemeve dhe shërbimeve të pagesave, identifikimin e hapësirave për reduktim të kostove në varësi të rezultateve, si dhe nxitjen e dialogut të aktorëve të tregut bazuar në rezultate konkrete.

Funksionimi i infrastrukturës bazë të pagesave kombëtare në lekë ka reflektuar siguri dhe efikasitet

Infrastruktura bazë për kryqëzimin dhe shlyerjen e pagesave kombëtare në lekë ka vijuar të reflektojë siguri dhe efikasitet edhe përgjatë vitit 2014, duke kontribuar në efikasitetin e politikës monetare, në ruajtjen e stabilitetit financiar, si dhe në besueshmërinë e publikut në monedhën kombëtare. Sistemet e operuara dhe të administruara nga Banka e Shqipërisë, "Sistemi i Shlyerjes së Pagesave Ndërbankare me Vlerë të Madhe (AIPS)" dhe "Sistemi

[37] *Vendimi nr.35, datë 25.06.2014 i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.*

[38] *Po kryhen vrojtime në 1000 individë dhe 700 biznese si dhe në një sërë institucionesh shtetërore të cilat marrin dhe kryejnë pagesa.*

i Klerimit të Pagesave me Vlerë të Vogël (AECH)" kanë funksionuar në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse, duke shmangur situata të jashtëzakonshme.

Kontribut të shtuar në rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të dy sistemeve, AIPS dhe AECH kanë sjellë dhe përmirësimet rregullatore dhe ato infrastrukturore që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë përgjatë vitit.

HAPËSIRË INFORMUESE 4. ECURIA E SISTEMEVE AIPS DHE AECH

AIPS – Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe

Gjatë vitit 2014, aktiviteti i sistemit AIPS ka pasqyruar një rritje të lehtë në vlerë, me 5.56% në terma vjetorë, ndërsa numri i transaksioneve të përpunuara rezulton në të njëjtat nivele me ato të vitit 2013. Gjithashtu, raporti i vlerës së transaksioneve të përpunuara në sistemin AIPS me prodhimin e brendshëm bruto ka paraqitur rritje.

Grafik 30. Ecuria e numrit dhe e vlerës së transaksioneve të shlyera në AIPS (majtas) dhe raporti i vlerës së transaksioneve të AIPS ndaj PPB-së (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pasqyrimi i peshave të tipologjive të ndryshme të transaksioneve të përpunuara në sistemin AIPS tregon se në terma të numrit, pagesat për klientë vijojnë të zënë gjithnjë e më shumë peshë. Ky zhvillim vlerësohet të reflektojë përçimin e masave të marra nga Banka e Shqipërisë në mars të vitit 2011. Në terma të vlerës, vërehet një prani më e madhe e autoritetit monetar në treg dhe një rënie relativisht e lehtë e tregut ndërbankar.*

*Përgjatë vitit 2014, kredia brenda ditës (KBD)** ka reflektuar një rritje vjetore prej 33.4% në vlerë, ndërkohë që në numër mbetet pothuajse në të njëjtat nivele me ato të vitit të kaluar. Pavarësisht rritjes në terma të vlerës, raporti i financimit të transaksioneve të përpunuara në AIPS nëpërmjet këtij instrumenti mbetet në nivele tejet të ulëta (0.4%) duke nënkuptuar një ekspozim të kufizuar të sistemit ndaj rrezikut të*

Grafik 31. Shpërndarja e pagesave të procesuara në sistemin AIPS në numër (majtas) dhe në vlerë (mld lekë, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

likuiditetit. Gjithashtu, nevojat për likuiditet rezultojnë të kenë qenë të përqendruara në kohë dhe në segmente të kufizuara, duke mos reflektuar sjelljen e tregut në tërësi.

Grafik 32. Ecuria e vlerës së KBD dhe AIPS si dhe raporti i tyre (majtas), dhe ecuria e numrit të KBD dhe vlerës mesatare (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

AECH – Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël

Sistemi AECH ka reflektuar rritje si në terma të vëllimit ashtu edhe të vlerës, edhe gjatë vitit 2014. Krahasuar me vitin 2013, numri i transaksioneve të kleruara është rritur me 22.13% dhe vlera me 14.24%.

Shtimi i pagesave të kleruara në AECH ka ardhur si efekt i kombinuar i rritjes së pagesave nga Ministria e Financave (pjesëmarrësi me peshën kryesore në sistem, prej 54% në numër dhe prej 49% në vlerë) dhe e pagesave të kleruara nga bankat

*për llogari të klientëve të tyre. Rritja e pagesave të kleruara nga bankat për të tretin vit radhazi vlerësohet të reflektojë masat e marra nga Banka e Shqipërisë në mars të vitit 2011***.*

*Pasqyrimi i pagesave të kleruara në sistemin AECH përgjatë seancave, tregon një përqendrim më të theksuar në seancën e parë**** të klerimit të pagesave, krahasuar me dy seancat e tjera. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë seancës së fundit të klerimit minimizon rreziqet shtesë në kuadër të mirëfunksionimit të sistemeve të pagesave.*

Grafik 33. Ecuria e numrit dhe e vlerës së transaksioneve të kleruara në AECH



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 34. Pesha e transaksioneve sipas seancave në AECH për vitin 2014



Burimi: Banka e Shqipërisë.

** Me vendimin nr.12, datë 23.02.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi reduktimin e komisioneve dhe tarifave për këtë sistem, si dhe përcaktimin e një vlere maksimale prej 1500 lekësh për komisionet, të cilat mund të aplikojnë bankat për shërbimet e pagesave në lekë të kleruara dhe të shlyera në AIPS.*

***Një instrument i rëndësishëm në sistemin AIPS është Kredia Brenda Ditës (KBD), të cilën Banka e Shqipërisë ia ofron bankave pjesëmarrëse për administrimin e likuiditetit brenda ditës dhe për garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit ndërbankar të pagesave.*

****Me vendimin nr.12, datë 23.02.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi: rritjen e vlerës kufi të sistemit AECH nga 1 milion në 1.5 milionë lekë, shtimin e një seance të tretë klerimi në sistemin AECH, diferencimin e tarifave përgjatë seancave dhe reduktimin e komisioneve dhe tarifave për këtë sistem, si dhe përcaktimin e një vlere maksimale prej 500 lekësh për komisionet, që mund të aplikojnë bankat për shërbimet e pagesave në lekë të kleruara në AECH.*

*****Duhet theksuar fakti se tarifat e aplikuara në pagesat që shlyhen gjatë seancës së parë janë shumë më të lira se ato të seancës së tretë.*

Përdorimi i instrumenteve të pagesave, veçanërisht i atyre elektronike, tregon prirje në rritje

Statistikat e përftuara nga bankat tregojnë se gjatë vitit 2014 janë kryer rreth 10.5 milionë pagesa klientësh me një vlerë totale prej 4,289 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje vjetore të numrit me 21% dhe një rritje të vlerës me 18%. Vitin e kaluar është shënuar një rritje e përshpejtuar e përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, veçanërisht shërbimet "*Home banking*" dhe ato me karta bankare.

Grafik 35. Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave në vite (majtas) dhe përdorimi i instrumenteve të pagesave nga individët dhe bizneset



Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjis ë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Grafik 36. Ecuria e përqindjes së llogarive të aksesueshme nga interneti ndaj totalit ë llogarive dhe ecuria e raportit të shfrytëzimit të llogarive të aksesueshme nga interneti*



*Raporti i utilizimit tregon sa përdoret mesatarisht një llogari me akses nga interneti për kryerje tranasksoinesh.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shërbimet "*home banking*" gjithnjë e më shumë po marrin shtrirje në tregun shqiptar. Pas prezantimit të këtij produkti në vitin 2005 nga një bankë e sistemit, në fund të vitit 2014, numri i bankave që ofrojnë shërbime "*home banking*" është 11.

Shtimi i numrit të llogarive rrjedhëse të klientëve të aksesueshme nga interneti me 27% krahasuar me vitin 2013 (pas një dyfishimi të tij në vitin 2013), është shoqëruar me një katërfishim të numrit të transaksioneve "*home banking*" gjatë vitit 2014. Ky rezultat përtej familjarizimit të tregut me këto shërbime si dhe aksesin[39] më të gjerë të publikut ndaj këtij shërbimi, reflekton deri diku dhe raportimin më të rregullt të bankave për këtë zë, si rrjedhojë e ndryshimit të metodologjisë së raportimeve.

[39] *Nëse marrim parasysh faktin se në vitin 2005 ky shërbim është prezantuar si një shërbim i profilizuar kryesisht ndaj bizneseve, tanimë gjithnjë e më shumë ky produkt po u ofrohet dhe individëve.*

Përdorimi i llogarive të aksesueshme nëpërmjet internetit rezulton të jetë rritur. Në vitin 2014 janë kryer mesatarisht rreth 9 transaksione për llogari nga 3 në vitin 2013. Ky shërbim vijon të përdoret më shumë nga bizneset (11 transaksione për llogari) krahasuar me individët (7 transaksione për individ).

Nga perspektiva e përdorimit të kartave si instrument pagese, analizimi i infrastrukturës së ofruar nga bankat e licencuara si emetuese[40] kartash dikton një rënie të lehtë të numrit të ATM-ëve për vitin 2014 me 2% në terma vjetorë. Rënia e numrit të ATM-ëve vlerësohet të reflektojë vendimet e bankave për mbylljen e disa degëve të tyre. Nga ana tjetër, numri i POS-eve të ofruara nga bankat e licencuara si pranuese[41] kartash ka shënuar një rritje të konsiderueshme, në masën 8% në terma vjetorë. Pavarësisht rritjes së terminaleve POS, përqendrimi i tyre vijon të jetë i lartë në qarkun e Tiranës[42], në masën 78%. Nga totali i kompanive të cilat potencialisht[43] mund të zotërojnë një terminal POS, vetëm 12% e tyre zotërojnë aktualisht terminale. Kjo shifër mund të jetë akoma më e ulët nëse marrim parasysh se në disa raste kompanitë zotërojnë mbi një POS.

Grafik 37. Zhvillimet e ATM dhe POS, për periudhën 2004 -2014 (majtas), dhe zhvillimet e kartave të debitit dhe të kreditit (djathtas)



Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Në vitin 2014, rritje ka shënuar dhe numri i kartave në qarkullim (7% krahasuar me vitin e kaluar). Nga ndarja e kartave sipas funksionit vihet re një rritje më e përshpejtuar e kartave me funksion krediti, me 32%, krahasuar me atë të kartave me funksion debiti, me 5% në terma vjetorë. Duke iu referuar raportimeve të bankave, në fund të vitit 2014 pesha e kartave të debitit ndaj totalit të kartave në qarkullim ka pësuar një tkurrje të lehtë në 90%, krahasuar me 92% në fund të vitit 2013. Pavarësisht ritmeve pozitive të rritjes së kartave

[40] *Numri i bankave të licencuara si emetuese kartash në Republikën e Shqipërisë, në fund të vitit 2014 rezulton në 14. Këto banka ofrojnë shërbime të tërheqjes cash nga ATM-të.*

[41] *Në fund të vitit 2014, 7 banka rezultojnë njëkohësisht të licencuara edhe si pranuese kartash. Këto banka ofrojnë shërbimin e pranimit të pagesave me karta nëpërmjet pajisjeve POS të vendosura në dyqane, restorante, hotele apo dhe në qendra tregtare.*

[42] *Ndarja e qarqeve bëhet sipas degëve të Bankës së Shqipërisë.*

[43] *Këtu përfshihen kompanitë të cilat kryejnë tregti me pakicë si dhe hotele e restorante.*

të debitit dhe të kreditit, përqindja e llogarive të cilat aksesohen nëpërmjet një karte debiti apo krediti rezulton në nivele relativisht të ulëta (25% ndaj totalit).

Tabelë 9. Transaksionet me karta sipas terminaleve

	Vëllimi			Vlerë (në milionë lekë)		
	2012	2013	2014	2012	2013	2014
1- ATM tërheqje cash	11.300.261	11.729.920	12.205.989	109.609	117.195	125.048
2- ATM depozitime	5	21	6	0,03	0,09	0,01
3- Urdhërtransferta nëpërmjet ATM	80	61	40	0,68	0,75	0,65
4- Tërheqje cash në terminale POS	3.450	3	881	475	460	113
5- Pagesa me karta në terminale POS	1.107.425	1.496.640	2.124.304	13.396	12.511	17.921
nga të cilat:						
- pagesa me karta debiti	656.000	864.730	1.212.278	4.739	5.738	7.914
- pagesa me karta krediti	451.425	631.910	912.026	8.657	6.772	10.006
Totali i transaksioneve me karta	12.411.221	13.226.645	14.331.220	123.481	130.167	143.084

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Rritja e numrit të kartave bankare (debiti dhe krediti) duket të jetë shoqëruar edhe nga një rritje e transaksioneve me karta, ku peshën kryesore vijojnë ta kenë transaksionet për tërheqje cash. Gjatë vitit 2014, në total janë procesuar rreth 14.3 milionë transaksione me karta (në ATM dhe POS-e) me një qarkullim total prej 143 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve, rreth 85% në numër dhe 87% në vlerë, e përbëjnë transaksionet nga ATM-ëtë.

Pavarësisht mbizotërimit të përdorimit të kartave për shërbime bazike, edhe përgjatë këtij viti, është vënë re një rritje e pagesave me karta në POS-et fizike dhe ato virtuale[44]. Shpërndarja e pagesave në POS-e fizike dhe virtuale tregon për një mbizotërim në masën 70% të pagesave me karta në të parat. Ky zhvillim dikton një familjarizim gjithnjë e në rritje të tregut shqiptar me përdorimin e kartave bankare në transaksionet e tyre të përditshme. Nga ana tjetër, ai nënvizon faktin se zhvillimi i tregtisë elektronike në vend përbën një potencial për shtimin e pagesave me kartë, duke rritur mundësitë për blerje në internet.

II.4.2. EMETIMI I MONEDHËS

KARTËMONEDHA NË QARKULLIM[45]

Sasia e kartëmonedhave në qarkullim, në fund të vitit 2014, ishte 130,654,519 copë me vlerë rreth 222.896 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2013, rezulton pothuajse i njëjti numër kartëmonedhash, ndërkohë që vlera regjistron një rritje në masën 9.06%. Kjo rritje pasqyron ndryshimin që ka pësuar struktura në favor të kartëmonedhave me vlerë nominale 5000 Lekë dhe 2000 Lekë. Gjithashtu, vëllimi i kërkesave nga bankat e nivelit të dytë për pagesa pati rritje.

[44] *Është pajisja e ngjashme në shërbime me terminalin POS, e cila mundëson kryerjen e transaksioneve nëpërmjet internetit ose telefonave, me anë të kartave bankare që punojnë në regjim online.*

[45] *Është numri dhe vlera e kartëmonedhave dhe monedhave të hedhura në qarkullim nga Banka e Shqipërisë.*

Grafik 38. Struktura e kartëmonedhës në qarkullim (copë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

MONEDHA METALIKE NË QARKULLIM

Në fund të vitit 2014, rezultuan 147,222,518 copë monedha metalike në qarkullim me vlerë 3.511 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2013, rezulton një rritje e numrit të monedhave metalike me 5.1% dhe një rritje me 3.45 % e vlerës së tyre. Struktura e monedhës metalike në fund të vitit 2014 paraqitet pak a shumë e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Në fund të vitit 2014, raporti i përgjithshëm midis vlerës së monedhës metalike ndaj kartëmonedhës rezultoi më i ulët se vitin e kaluar.

Grafik 39. Struktura e monedhës metalike në qarkullim (copë)



Burimi Banka e Shqipërisë.

TREGUES TË QARKULLIMIT TË PARASË

Në fund të vitit 2014, raporti i parasë në qarkullim ndaj agregatit M2 ishte 31.3%, ndërsa në fund të vitit 2013 i njëjti raport ishte 29.97%. Më tej,

koeficienti i qarkullimit të parasë në Bankën e Shqipërisë në vitin 2014, rezultoi 0.568, ndërkohë që ky koeficient për vitin 2013 ishte 0.535. Gjithashtu vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim në fund të vitit 2014, arriti në 1706 lekë, nga 1566 lekë që ishte në fund të vitit 2013.

RICIKLIMI CASH-IT DHE CILËSIA E KARTËMONEDHËS NË QARKULLIM

Gjatë vitit 2014, u përpunuan 127 milionë copë kartëmonedha, të cilat u kontrolluan për autenticitet dhe përshtatshmëri për riqarkullim. Nga përpunimi, rreth 36,6 milionë copë kartëmonedha (28.8% e totalit të përpunuar) rezultuan të papërshtatshme për përdorim, dhe u tërhoqën nga qarkullimi.

MBROJTJA E KARTËMONEDHËS DHE MONEDHËS METALIKE NGA FALSIFIKIMI

Gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë në kuadër të edukimit të publikut dhe mbrojtjes së parasë nga falsifikimi, ka vendosur në faqen e saj të internetit aplikacionin "Albanian money", si një mundësi për dallimin e kartëmonedhave të vërteta dhe njohjen e elementëve të tyre të sigurisë. Gjithashtu, nga Banka Shqipërisë janë kryer për herë të parë trajnime në fushën e mbrojtjes së parasë nga falsifikimi për punonjësit dhe trajtuesit e cash-it në sistemin bankar, duke ndihmuar në përmirësimin e aftësive zbuluese dhe parandaluese si dhe në pengimin e mëtejshëm të qarkullimit të parave të falsifikuara.

Gjatë vitit 2014, numri i kartëmonedhave dhe monedhave metalike të falsifikuara ka rezultuar pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2013. Në përgjithësi, numri i kartëmonedhave dhe monedhave metalike të falsifikuara vlerësohet të jetë i vogël dhe, në raport me sasinë në qarkullim, i papërfillshëm.

Kartëmonedhat e evidentuara si të falsifikuara, sipas analizës teknike, janë kryesisht riprodhime me *inkjet-toner* në makina riprodhuese (skanimi apo fotokopjimi) me ngjyra, si dhe në pak raste me *offset*, të kombinuara me aplikimin e metodave artizanale për imitimin e elementeve të sigurisë të natyrës vizuale apo me rrathë fluoreshentë.

ÇËSHTJE SPECIFIKE NË FUSHËN E ADMINISTRIMIT TË VLERAVE MONETARE

Në muajin korrik 2014, Banka e Shqipërisë mori dijeni mbi një ngjarje të rëndë të ndodhur në ambientet e ruajtjes dhe përpunimit të monedhave e kartëmonedhave. Një ish-punonjës i Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë, i ndodhur përpara pritjes për zbulim të shpejtë të faktit, rrëfeu se kishte përvetësuar vlera të konsiderueshme monetare nga ambientet ku ato ruheshin. Menjëherë me marrjen dijeni, Banka e Shqipërisë bëri kallëzimin përkatës të ngjarjes në Prokurori, në bazë të të cilit u regjistrua prej saj

dhe procedimi penal. Në rrjedhën e hetimeve, u morën të pandehur 18 punonjës të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe ish-Guvernatorin dhe ish-Inspektoren e Përgjithshme. Pas verifikimit të kryer fillimisht nga Banka e Shqipërisë, dhe më pas me veprimet proceduriale të kryera nga organi i prokurorisë, u konstatua se në arka mungonin vlera monetare në ngarkim të punonjësve, në shumën 713 milionë lekë.

Banka e Shqipërisë ka ofruar të gjithë bashkëpunimin e saj në zbulimin e plotë të veprimtarisë kriminale të përgjegjësve të përvetësimit të vlerave monetare. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka depozituar në gjykatë një padi civile me qëllim rikuperimin e vlerave monetare të përvetësuara, prej personave të akuzuar për vjedhjen.

Stafi drejtues i Bankës së Shqipërisë mori masa të menjëhershme për të normalizuar situatën, për të garantuar furnizimin e sistemit bankar me sasinë e nevojshme të parasë në qarkullim dhe për të vijuar përmbushjen e funksioneve të saj ligjore, duke përballuar vështirësitë e krijuara gjatë gjithë kësaj periudhe të jashtëzakonshme. Në veçanti, masa të rrepta u morën për forcimin e sigurisë dhe të kontrollit në ambientet e ushtrimit të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë hapash dhe rregullimesh për të minimizuar materializimin e rrezikut operacional në të gjitha hallkat që veprojnë për magazinimin, përpunimin, shkatërrimin, kontrollin dhe sigurinë fizike të parasë së gatshme.

II.5. OPERACIONET NË TREGUN FINANCIAR DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

II.5.1. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM TË PARASË

- *Banka e Shqipërisë zbaton politikën e saj monetare nëpërmjet përdorimit të instrumenteve indirekte të tregut. Këto instrumente përfshijnë operacionet në treg të hapur, lehtësirat e përhershme dhe mbajtjen e rezervës së detyruar. Operacionet në treg të hapur luajnë rolin kryesor në transmetimin e politikës monetare në sistemin bankar dhe kushtet për ekzekutimin e tyre përcaktohen ekskluzivisht nga Banka e Shqipërisë. Operacioni kryesor i tregut është marrëveshja e riblerjes dhe e anasjellë e riblerjes me maturim shtatë ditë, norma e interesit të së cilës përbën dhe normën bazë të interesit. Operacione të tjera janë marrëveshjet e riblerjes (të anasjellë të riblerjes) me maturim një dhe tremujor dhe shitblerjet me të drejta të plota të portofolit.*

OPERACIONET NË TREG TË HAPUR

Operacionet e tregut të hapur janë të klasifikuara në tre nënndarje: operacione kryesore, operacione rregulluese dhe operacione strukturore. Ato përdoren

Grafik 40. Operacionet e tregut të hapur dhe përdorimi i lehtësirave të përhershme*



*Vlerat negative në përdorimin e instrumenteve reflektojnë operacionet për tërheqjen e likuiditetit, ndërsa vlerat pozitive korrespondojnë me operacionet për injektimin e likuiditetit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

për administrimin afatshkurtër të likuiditetit në tregun e parasë me qëllim kryesor përmbushjen e objektivit operacional të Bankës së Shqipërisë - orientimin e normave afatshkurtra të interesit të tregut ndërbankar pranë normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë dhe kufizimin e luhatjeve të tyre.

Gjatë vitit 2014, norma e interesit në tregun ndërbankar ditor është luhatur pranë normës bazë të interesit. Kuadri ynë operacional ka mundësuar ankorimin e normave të tregut ndërbankar më pranë normës bazë.

Gjatë vitit 2014 niveli mesatar i injektuar është rritur me 7.18 miliardë lekë, në nivel mesatar prej 24.56 miliardë lekësh. Banka e Shqipërisë ka vijuar të ruajë një strukturë të përzier për injektimin e likuiditetit. Kjo strukturë konsistoi në një mesatare prej 64% nëpërmjet instrumentit kryesor dhe 36% nëpërmjet instrumenteve rregulluese me afat më të gjatë se një javë, kundrejt respektivisht 60% dhe 40% gjatë vitit të kaluar.

Tabelë 10. Struktura e injektimit sipas instrumenteve

	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Instrumenti kryesor	55%	58%	74%	55%	60%	64%
Injektimet afatgjata	45%	42%	26%	45%	40%	36%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Instrumenti kryesor për realizimin e operacioneve të tregut të hapur është marrëveshja e anasjellë e riblerjes me maturim njëjavor. Ndërhyrjet nëpërmjet këtij operacioni u realizuan nëpërmjet ankandit me shumë të përcaktuar dhe shumë çmime. Likuiditeti i injektuar nëpërmjet marrëveshjeve të anasjella të riblerjes me maturim njëjavor gjatë vitit 2014 ishte mesatarisht 19.14 miliardë lekë në javë.

Grafik 41. Ndërhyrjet me marrëveshjet e anasjella të riblerjes me maturim njëjavor, njëmujor dhe tremujor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahas operacioneve injektuese njëjavore, gjatë vitit 2014 ka vijuar zhvillimi i njëkohshëm i operacioneve me afat njëmujor. Nëpërmjet ankandeve të marrëveshjeve të anasjella të riblerjes me maturim njëmujor janë injektuar mesatarisht 2.15 miliardë lekë në javë, krahasuar me 1.94 miliardë lekë që ishin një vit më parë. Marrëveshjet e anasjella të riblerjes me maturim tremujor u zhvilluan vetëm në pesë raste, në muajin e parë dhe të fundit të vitit 2014.

Me qëllim administrimin e situatës së likuiditetit dhe normave afatshkurtra të interesit, të përqendruar kryesisht në ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar, gjatë vitit 2014 ka gjetur përdorim edhe operacioni njëditor për injektim likuiditeti. Marrëveshja e anasjellë e riblerjes me maturim njëditor është përdorur në 12 raste, mesatarisht për 2.01 miliardë lekë, nga 18 raste në vitin e kaluar për mesatarisht 1.45 miliardë lekë.

Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në treg edhe me anë të operacioneve strukturore, të cilat kanë synuar të nxisin konkurrencën në segmentin afatshkurtër të tregut të letrave me vlerë. Banka e Shqipërisë ka qenë aktive në tregun sekondar duke kompensuar uljen e pjesëmarrjes në titujt me afat 3- dhe 6-mujor nëpërmjet blerjeve të bonove 12-mujore të sapoemetuara. Nga operacionet e shitblerjes me të drejta të plota të zhvilluara në vitin 2014, portofoli i Bankës së Shqipërisë rezulton 35 milionë lekë më i ulët se niveli i fillimvitit.

LEHTËSIRAT E PËRHERSHME

Lehtësirat e përhershme – depozita njëditore dhe kredia njëditore pranë Bankës së Shqipërisë u shërbejnë bankave të nivelit të dytë për të administruar likuiditetin në bazë ditore. Normat e interesit për to përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2014, ato kanë ndjekur lëvizjet e normës bazë, duke krijuar një korridor të sipërm (+1.75 pikë përqindje nga norma bazë) dhe të poshtëm (-1.75 pikë përqindje nga norma bazë), ku luhaten normat afatshkurtra të tregut ndërbankar.

Gjatë vitit 2014, depozita njëditore ka vijuar të ketë përdorim të lartë. Ajo ka qenë e përqendruar në dy muajt e fundit të vitit në kushtet e tepricës strukturore të likuiditetit të përqendruar tek një bankë. Gjatë vitit 2014, depozita njëditore është përdorur në 74 ditë, për një shumë mesatare 4.57 miliardë lekë.

Kredia njëditore gjeti përdorim në 14 raste (mesatarisht 0.77 miliardë lekë), kundrejt 19 rasteve gjatë vitit të kaluar (mesatarisht 1.46 miliardë lekë). Përdorimi i kredisë njëditore është i përqendruar në ditët e fundit të periudhës së rezervës së detyruar.

REZERVA E DETYRUAR

Rezerva e detyruar në lekë është instrument i politikës monetare që synon rregullimin e likuiditetit në sistemin bankar dhe stabilizimin e normave të interesit. Niveli i rezervës së detyruar aplikohet në masën 10% të depozitave

të bankave të nivelit të dytë deri në dy vjet në monedhat Lekë, Euro dhe Dollar Amerikan. Banka e Shqipërisë i lejon bankat të përdorin deri në 40% të rezervës së detyruar në lekë në bazë ditore, me kushtin e mbajtjes së nivelit mesatar mujor të rezervës së detyruar jo më të vogël se niveli i përcaktuar për të, e llogaritur kjo në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes.

Rritja vjetore e rezervës së detyruar në lekë rezultoi 2.87%, ndërsa ndryshimi vjetor i rezervës së detyruar në valutë rezultoi pozitiv me 6.41% për rezervën në monedhën evropiane dhe negativ me 20.59% për rezervën në monedhën amerikane. Norma e remunerimit të rezervës së detyruar në lekë ka pasqyruar ecurinë e normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë (70% e normës bazë), ndërkohë që rezerva e detyruar në valutë nuk remunerohet[46].

Gjatë vitit 2014, në rregulloren për rezervën e detyruar u përfshi edhe mundësia e remunerimit të tepricave të llogarive në valutë dhe në lekë. Norma e interesit e remunerimit të tepricës në lekë dhe dollarë amerikanë gjatë vitit 2014 ishte 0%, ndërkohë që remunerimi i tepricave të gjendjes në euro, është 0.10% më e ulët se norma e interesit të depozitës e përcaktuar nga Banka Qendrore Evropiane. Nevoja për të rregulluar remunerimin e tepricave lindi në kushtet e kalimit në territor negativ të interesit të depozitës së Bankës Qendrore Evropiane. Në këtë mënyrë, bankat e nivelit të dytë përballojnë vetë shpenzimet që rrodhën nga kjo lëvizje, të paktën për tepricën e likuiditetit në euro që mbajnë në Bankën e Shqipërisë. Nga ana tjetër, rregullorja përcakton se tepricat do të remunerohen vetëm nëse tejkalojnë nivelin 500 mijë euro, duke shmangur kështu luhatjet minimale që vijnë nga ndryshimi i nivelit të rezervës së detyruar.

II.5.2. ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

- *Objektivat e procesit të administrimit të rezervës valutore dhe kriteret që duhet të respektohen gjatë këtij procesi parashikohen në rregulloren "Mbi politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore", që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Si objektiva parësorë të këtij procesi renditen likuiditeti dhe siguria, ndërkohë që sigurimi i të ardhurave nga administrimi i fondit të rezervës përfaqëson objektivin e tretë, për sa kohë nuk cenohen objektivat e likuiditetit dhe të sigurisë. Emrat e lejuar në të cilat investohet rezerva valutore përfshijnë qeveritë e ShBA-së, Japonisë, Britanisë së Madhe dhe të Eurozonës, si dhe agjenci apo institucione të lidhura me qeveritë, të cilat përgjithësisht janë të renditura të paktën AA- (për qeveritë e Eurozonës, renditja minimale e pranuar është BBB-). Në emrat e lejuar për investim përfshihen dhe institucione shumëpalëshe apo të tjera subjekte të renditura të paktën AA-.*

[46] *Duke nisur nga data 24.07.2011, norma e interesit për remunerimin e rezervës së detyruar në valutë është zero.*

ZHVILLIMET KRYESORE NË KUADËR TË ADMINISTRIMIT TË REZERVËS VALUTORE GJATË VITIT 2014

Në vijim të vendimit të marrë në vitin 2013 për uljen e pragut minimal të renditjes dhe përfshirjen në universin e lejuar të investimit të qeverive të Eurozonës të renditura në kategorinë "Për investim", gjatë vitit 2014 është vijuar të ruhet një ekspozim në qeveritë e renditura në klasën BBB, ndonëse në një shkallë më të ulët se në vitin 2013. Pozicionet e krijuara dhe rezultati i investimit monitorohen në mënyrë rigoroze, në kuadër të mekanizimit të posaçëm të ngritur për administrimin e rrezikut të kreditit dhe të tregut për këtë pjesë të portofolit të rezervës. Kthimi nga investimi për këtë pjesë të portofolit ka qenë pozitiv gjatë vitit 2014. Duhet theksuar, se në kushtet e thellimit të mëtejshëm të normave negative të interesit për emetimet e thesarit në Eurozonë, mundësitë e investimit me një normë pozitive kthimi për pjesën e portofolit të Euro-s janë reduktuar ndjeshëm krahasuar me një vit më parë.

Përsa i takon bashkëpunimit me Bankën Botërore, në kuadër të marrëveshjes "Për Administrim dhe Konsulencë në Investimin e Rezervës Valutore" (RAMP), në fillim të muajit maj u finalizua projekti i vënies në zbatim të Sistemit të Administrimit të Portofolit. Ky sistem i përgatitur me burime të vetë Bankës Botërore është i dedikuar vetëm për procesin e administrimit të portofolit të rezervës valutore, duke ofruar një zgjidhje të automatizuar më gjithëpërfshirëse për detyrat që duhet të realizohen nga njësitë në kuadër të këtij procesi. Sistemi i ri ofron një mbështetje më të mirë në drejtim: të kontabilizimit të rezultatit të krijuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të përdorimit të instrumenteve derivative në investim, të llogaritjes dhe të analizës së kthimit nga investimi, të vlerësimit dhe të monitorimit të rreziqeve të mbartura gjatë procesit. Vënia në zbatim e funksionaliteteve shtesë, në përmbushje të nevojave të shprehura nga institucionet pjesëmarrëse në këtë projekt, përfaqëson një nga objektivat më të rëndësishëm të Bankës Botërore në kuadër të zhvillimit të iniciativave të marra për mbështetjen e bankave qendrore anëtare të programit RAMP. Gjatë vitit të kaluar, Banka Botërore ka ofruar asistencë teknike edhe në drejtim të rishikimit dhe përmirësimit të kuadrit për administrimin e rrezikut të kreditit gjatë investimit të portofolit të rezervës valutore.

Përveç sa më sipër Banka Botërore ka vijuar të ofrojë trajnime dhe programe edukimi të specializuara, si CFA *(Chartered Financial Analyst), CIDA (Certified Investments and Derivatives Auditor)* dhe PRM *(Professional Risk Manager)*, në përputhje me nevojat e stafit të Bankës. Këto kualifikime kanë synuar konsolidimin dhe rritjen e mëtejshme të shkallës së profesionalizmit të punonjësve të angazhuar në procesin e administrimit të rezervës valutore, si dhe të stafit që mbështetet ose monitoron ecurinë e këtij procesi.

HAPËSIRË INFORMUESE 5. STATISTIKA MBI ECURINË E REZERVËS VALUTORE, GJATË VITIT 2014

Gjatë vitit 2014, rezerva valutore bruto, e vlerësuar dhe e raportuar në monedhën Euro, është rritur me rreth 177.35 milionë euro, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 2,192.34 milionë euro.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar rezervën bruto paraqiten të grupuar më poshtë.

A. Veprimet e lidhura me aktivitetin e Ministrisë së Financave kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 124.30 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- *hyrje neto nga veprimet valutore me Bankën e Shqipërisë për 24.10 milionë euro,*
- *hyrje neto nga lëvrimi i huave të dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), rinovimi i titujve afatshkurtër, etj., në masën 350.18 milionë euro,*
- *hyrje nga blerjet e valutës në treg dhe të tjera 25.82 milionë euro,*
- *transferta, përfshirë dhe shërbimin e borxhit 275.80 milionë euro.*

B. Veprimet e bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera kanë pasur ndikim negativ në shumën 51.17 milionë Euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- *derdhje nga bankat e nivelit të dytë në llogarinë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë, për plotësimin e rezervës së detyrueshme, për veprime që lidhen me kapitalin etj., 161.22 milionë euro,*
- *transferta 211.28 milionë euro,*
- *dalje neto për llogari të subjekteve të tjera (ASD, etj.) 1.11 milion euro.*

C. Veprimet e Bankës së Shqipërisë kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 32.68 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- *blerje e valutës nga bankat e nivelit të dytë dhe institucione të tjera në shumën 17.20 milionë euro: (10.30 milionë euro nga bankat dhe 6.90 milionë Euro nga institucione të tjera),*
- *të ardhurat e siguruara nga investimi i rezervës valutore llogariten në rreth 31.86 milionë euro. Këto të ardhura përfaqësojnë, në pjesën kryesore, interesa dhe kupona, dhe janë të llogaritura në bazë cash-i,*
- *shlyerja e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë ndaj FMN-së, 6.60 milionë euro,*
- *transferta rreth 9.78 milionë euro.*

D. Faktorët e tregut kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 71.54 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- *luhatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore kanë ndikuar pozitivisht vlerën e rezervës bruto të raportuar në euro, duke regjistruar një efekt rreth 80.25 milionë euro,*
- *efekti i rivlerësimit për portofolin, si rrjedhojë e luhatjes së normave të interesit, llogaritet në një vlerë negative prej rreth 8.71 milionë eurosh.*

II.6. STATISTIKAT

- *Banka e Shqipërisë, përveçse një përdoruese e rregullt e statistikave zyrtare kryesisht të natyrës ekonomike dhe financiare, është dhe një ndër agjencitë më të rëndësishme statistikore në vend. Në faqen zyrtare dhe në botimet periodike të Bankës së Shqipërisë, përdoruesit mund të gjejnë statistika të mbikëqyrjes bankare, statistika monetare dhe statistika të sektorit të jashtëm, që kanë si burim Bankën e Shqipërisë. Edhe gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë vijoi të përgatisë dhe shpërndajë statistikat e saj në mënyrë të rregullt e në kohën e caktuar, sipas kalendarit të publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit.*

Gjatë vitit 2014, ka vijuar puna për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave monetare dhe financiare, të cilat përfshijnë bilancet sektoriale dhe paraqitjet monetare të korporatave depozituese, agregatët e depozitave dhe kredive, normat e interesit për depozitat dhe kreditë e reja në sistemin bankar, si dhe një sërë tabelash e treguesish të tjerë për kreditë e dhëna dhe depozitat e pranuara nga sistemi bankar. Gjithashtu, treguesit për sistemin bankar të përgatitur në funksion të mbikëqyrjes bankare dhe stabilitetit financiar janë përpunuar, hartuar dhe shpërndarë duke ndjekur me rigorozitet kalendarin e statistikave. Po kështu, janë prodhuar dhe shpërndarë statistikat e sektorit të jashtëm, të cilat përfshijnë statistikat e bilancit të pagesave të përbërë nga llogaria korrente dhe llogaria financiare dhe kapitale, statistikat e borxhit të jashtëm bruto, statistikat e pozicionit ndërkombëtar të investimeve, statistikat e modulit të rezervës dhe ato të investimeve të huaja direkte.

Paralelisht me prodhimin statistikor, çdo muaj dhe tremujor është realizuar raportimi periodik pranë institucioneve ndërkombëtare të statistikave monetare, statistikave të bilancit të pagesave, statistikave të borxhit të jashtëm, statistikave për likuiditetin dhe rezervën ndërkombëtare, statistikat e investimeve të huaja direkte dhe statistikat e pozicionit ndërkombëtar të investimeve.

ZHVILLIMET NË FUSHËN E STATISTIKAVE

Përafrimi me standardet e Bashkimit Evropian në drejtim të hartimit të llogarive financiare dhe përgatitjes së metodologjisë përkatëse ka qenë një ndër prioritetet e punës së funksionit të statistikave. Ndërtimi i llogarive financiare ka filluar me ato të sistemit bankar për t'u pasuruar në të ardhmen me llogaritë financiare të korporatave financiare. Gjithashtu, gjatë vitit 2014 është hartuar llogaria financiare e bankës qendrore për vitin 2013. Po kështu, mbështetur në disa supozime dhe vlerësime të nevojshme për llogaritjen e të dhënave, të cilat nuk disponohen, është hartuar në mënyrë eksperimentale llogaria financiare e korporatave të tjera depozituese.

Përveç sa më lart, janë bërë përpjekje për hartimin e llogarive financiare vjetore për institucionet e tjera financiare dhe kompanitë e sigurimit e fondet e pensioneve. Me gjithë përpjekjet në sigurimin e informacionit të përshtatshëm në këtë drejtim, është evidente që ndërtimi i llogarive financiare është një

sfidë e kohës për statistikat monetare dhe financiare, realizimi me sukses i së cilës, përveç përkushtimit kërkon dhe një bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Statistikave - INSTAT.

Në funksion të përmirësimit cilësor të informacionit që mblidhet për hartimin e statistikave monetare është punuar intensivisht në përmirësimin e formularëve të raportimit për subjektet raportuese – banka. Në këtë drejtim është mbajtur në vëmendje standardi sipas Sistemit Evropian të Llogarive (ESA-2010) në drejtim të klasifikimit të njësive institucionale dhe instrumenteve përkatëse financiare, në përputhje me kërkesat e BQE-së për raportim statistikor, veçanërisht të rëndësishme për vendet aspirante për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Gjatë vitit 2014, në hartimin e statistikave të sektorit të jashtëm është punuar në mënyrë intensive për zbatimin e metodologjisë së re, manualit të 6^{të} të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve - BPM6[47], për të dhënat statistikore për vitet 2013-2014. Përmirësimet metodologjike kanë prekur të gjitha statistikat e sektorit të jashtëm, duke nisur me llogarinë korrente, financiare dhe kapitale të bilancit të pagesave, statistikat e borxhit të jashtëm, pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe të modulit të rezervës.

Gjithashtu, në bashkëpunim me ekspertë të FMN-së është punuar për përmirësimin e llogaritjes së të dhënave flukse nga dërgesat e emigrantëve, duke përdorur të dhënat e anketës së re të emigrantëve, metodologjinë e bazuar në këto të dhëna, si dhe të dhënat e raportuara nga bankat dhe operatorët e transferimit të parave.

Në vijim të plotësimit të kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare është realizuar përshpejtimi i afateve të hartimit dhe publikimit të statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe të statistikave të investimeve të huaja direkte sipas shteteve dhe sektorëve për vitet 2013-2014, nga 15 muaj në 9 muaj pas periudhës referencë, siç kërkohet nga standardet ndërkombëtare të FMN-së dhe Eurostat-it.

PROJEKTET E REALIZUARA

Në përpjekje të zbatimit të standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e statistikave, gjatë këtij viti është mundësuar pjesëmarrja në disa projekte dhe misione të rëndësishme.

- Në shërbim të objektivit afatmesëm të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike, me qëllim rritjen e eficiencës së raportimit nga bankat, uljen e ngarkesës së raportimit dhe rritjen e cilësisë së statistikave, edhe gjatë këtij viti, një vëmendje e rëndësishme i është kushtuar projektit të automatizimit të raportimeve (RRS).

[47] *Edicioni i gjashtë i manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve – BPM 6, i përgatitur dhe i publikuar nga FMN.*

- Projekti me Bankën Qendrore Evropiane, "Analiza e nevojave të Bankës së Shqipërisë[48]", i cili mundësoi një analizë të detajuar të statistikave monetare dhe financiare kundrejt kërkesave të BQE-së për raportim statistikor. Në përfundim të tij, ekspertët evropianë përgatitën rekomandimet përkatëse me shtrirje afatmesme dhe afatgjatë, të cilat do të jenë pjesë e drejtimeve kryesore të punës për statistikat monetare dhe financiare.

- Në kuadër të projektit IPA 2012 për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve, është punuar dhe po punohet për zbatimin e rekomandimeve të misionit të EUROSTAT-it për përafrimin me rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian.

- Misioni i FMN-së në muajin prill të vitit 2014, mundësoi një vizitë dyjavore të ekspertëve të FMN-së për ofrimin e asistencës teknike në kompilimin e statistikave të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare sipas manualit të 6^{të} të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve – BPM6.

BASHKËPUNIMET NDËRINSTITUCIONALE

Bashkëpunimi me agjencitë e tjera statistikore në funksion të forcimit dhe përmirësimit të Sistemit Statistikor Kombëtar ka qenë prezent gjatë gjithë vitit 2014. Bashkëpunimi me Institutin e Statistikave ka vijuar me shkëmbimin e informacionit lidhur me të dhënat për FISIM – Shërbimet Financiare të Matura Indirekt, si dhe tabelat mbi statistikat e bilancit të pagesave. Gjithashtu, bashkëpunimi dhe diskutimi me INSTAT-in ka qenë aktiv lidhur me llogarinë financiare të sektorit të qeverisë së përgjithshme. Paralelisht me këto, bashkëpunimi me INSTAT-in ka qenë mjaft aktiv dhe në kuadër të vrojtimeve që INSTAT-i ka ndërmarrë si rrjedhojë e kërkesave të Bankës së Shqipërisë.

Në kuadër të përgatitjes së Llogarive Financiare janë intensifikuar përpjekjet me anë të takimeve dhe komunikimeve zyrtare për vendosjen e një marrëdhënieje të rregullt për marrje informacioni edhe me Agjencinë e Mbikëqyrjes Financiare dhe Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

[48] *"Needs analysis for the Bank of Albania". Për më tepër informacion rreth projektit, ju lutem referojuni kapitullit IV "Integrimi evropian dhe bashkëpunimi ndërkombëtar".*

III. PUNA KËRKIMORE

- *Banka e Shqipërisë synon të mbështesë procesin vendimmarrës të saj në themele të forta dijesh dhe njohurish të testuara mbi ekonominë shqiptare. Investimi në krijimin e kapaciteteve të shëndosha kërkimore ndihmon në rritjen e reputacionit dhe të besueshmërisë së Bankës së Shqipërisë, si një institucion që zotëron metodologjitë përkatëse dhe ka njohuritë e nevojshme për të garantuar ekuilibrat makroekonomikë të vendit. Për këto arsye, zhvillimi dhe përdorimi aktiv i kërkimit shkencor zë një vend parësor në strategjinë e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë.*

Gjatë vitit 2014, fokusi i hulumtimit shkencor në Bankën e Shqipërisë ka qenë i orientuar në efektivitetin e politikës monetare dhe në çështjet që lidhen me ruajtjen e stabilitetit financiar. Puna kërkimore në Bankën e Shqipërisë ka ruajtur orientimin drejt politikëbërjes, duke kontribuar jo vetëm në thellimin e kuptimit të dinamikës së zhvillimeve ekonomike në vend, por edhe në diskutimin e çështjeve që paraqesin shqetësim për ekonominë shqiptare. Rrjedhimisht, kërkimi shkencor ka qenë i dobishëm, duke shërbyer dhe mbështetur procesin vendimmarrës të Bankës së Shqipërisë. Në përputhje me strategjinë afatmesme të kërkimit shkencor, një grup studimesh është fokusuar në zhvillimin metodologjik apo analizën empirike të zhvillimeve me karakter rajonal ose ndërkombëtar.

Makromodelimi mbetet një aspekt i rëndësishëm i punës kërkimore. Gjatë vitit 2014, Modeli Makroekonometrik i Ekonomisë Shqiptare (MEAM) është rivlerësuar duke përdorur një bazë të re të dhënash tremujore, për periudhën 1996-2012. Rivlerësimi është motivuar nga përfshirja e kanaleve të reja dhe rivlerësimi i atyre ekzistuese pas publikimit të statistikave për treguesit e llogarisë kombëtare nga INSTAT-i dhe rishikimeve të tjera që u janë bërë serive kohore të variablave ekonomikë të përdorur në model. Njëkohësisht është rritur shpjegueshmëria e sjelljes ekonomike duke përfshirë lidhje të reja në ekuacionet e sjelljes së konsumit, sektorit fiskal, etj. Rezultatet e punës kërkimore kanë kontribuar në përmirësimin e treguesve të kërkesës së huaj, prodhimit potencial dhe normës natyrore të papunësisë.

Projeksionet e derivuara nga studimet më lart, ashtu si dhe të tjera lidhur me tregtinë e mallrave, kanë kontribuar në analizën dhe parashikimin e ecurisë së pritshme të kërkesës agregate dhe përbërësve të saj, presioneve inflacioniste në vend, si dhe të zhvillimeve në tregun financiar. MEAM ka mundësuar vlerësimin e "goditjeve" ekzogjene dhe analizën e rreziqeve që lidhen me ecurinë e kursit të këmbimit, me rritjen e çmimeve të huaja apo me ndryshime të tjera në mjedisin e jashtëm ekonomik.

Mekanizmi i transmetimit monetar mbetet një çështje thelbësore në analizat dhe studimet empirike në Bankën e Shqipërisë. Kërkimi në këtë drejtim ka synuar të identifikojë efektin e kanaleve tradicionale të transmetimit të normës së interesit dhe të kursit të këmbimit dhe të testojë qëndrueshmërinë (në kohë) të parametrave të vlerësuar të modelit. Rezultatet e studimeve dhe analizës empirike janë kombinuar për të vlerësuar masën e përçimit të vendimeve të politikës monetare tek normat e interesit në tregun ndërbankar, në atë primar, atë sekondar dhe së fundi në ekonomi.

Gjatë vitit 2014, kërkimi është orientuar drejt tregut financiar dhe stabilitetit të tij. Këto studime janë fokusuar tek efektet e mbetura të krizës, implikimit që ato kanë për stabilitetin financiar dhe pasojat që mbartin për përçimin e politikave monetare konvencionale. Tematika kryesore e kërkimit në këtë drejtim është fokusuar te hulumtimi i lidhjes ndërmjet stabilitetit dhe treguesve të tregut financiar dhe ekuilibrit të përgjithshëm makroekonomik e anasjelltas. Konkluzionet e arritura mbartin rekomandime të vlefshme për hartimin dhe implementimin e politikave financiare në funksion të stabilitetit makrofinanciar të vendit.

Indeksi i stresit sistemik financiar dhe implikimet e tij në ekonomi dhe në tregun financiar kanë qenë gjithashtu në fokus të kërkimit shkencor. Drejtim tjetër ka qenë dhe identifikimi i përcaktuesve kryesorë të sjelljes së kreditimit në valutë. E prekur edhe më herët, kjo temë është rishikuar gjatë vitit 2014, duke përfshirë dhe pasuruar analizën me tregues të ofertës dhe kërkesës si: diferenca e normave të interesit, depozitat në valutë, luhatja e inflacionit dhe e kursit të këmbimit, etj.

Punët kërkimore dhe materialet e diskutimit të Bankës së Shqipërisë kanë trajtuar gjithashtu tematika të rëndësishme me karakter teorik e empirik duke synuar prezantimin e metodikave të reja në kërkimin shkencor me aplikime në financë e ekonomi. Kërkimi është fokusuar në metodën e vlerësimit të densiteteve probabilitare dhe përdorimin e analizës *co-word* si mjet i studimit empirik. Zhvillimi, formalizimi dhe aplikimi i këtyre metodave është një fushë me interes dhe synon aplikimin e tyre në të ardhmen në procesin e vendimmarrjes dhe analizës në Bankën e Shqipërisë.

Ndër qëllimet e këtyre studimeve është publikimi në faqen zyrtare të Bankës, nën kategorinë "Publikime/Kërkime dhe Materiale Diskutimi", ndërsa një pjesë e artikujve publikohen me frekuencë gjashtëmujore edhe në Buletinin e Bankës së Shqipërisë. Tashmë që prej vitit 2009, Banka e Shqipërisë publikon revistën me frekuencë gjashtëmujore "Të rejat shkencore në Bankën e Shqipërisë", e cila paraqet një informacion më të gjerë mbi materialet e sapopërfunduara apo ato në proces, si dhe të tjera të prezantuara në "Seminaret e së Premtes" e në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit. Produktet e punës kërkimore në Bankën e Shqipërisë kanë ngjallur interesin e forumeve ndërkombëtare dhe janë prezantuar e diskutuar në këto forume.

Gjatë vitit 2014 u zhvilluan një sërë aktivitetesh me karakter shkencor e trajnues. Fokusi i këtyre aktiviteteve ishte diskutimi i studimeve me karakter

ekonomik të kryera në Bankën e Shqipërisë dhe implementimi i rezultateve të kërkimit në vendimmarrjen e saj. Bashkëpunimi me Universitetin e Oksfordit dhe Institutin e Studimeve Pasuniversitare të Gjenevës, kontribuoi në zgjerimin dhe forcimin e ndërveprimit me institucionet akademike ndërkombëtare dhe bankat qendrore të rajonit të Eurozonës në fushën e kërkimit.

Hapja ndaj komunitetit të kërkimit dhe atij akademik në rajon, Evropë e më tej, mbetet një prioritet kryesor për vitin 2015 së bashku me publikimin e punës kërkimore në revistat ekonomike me rëndësi ndërkombëtare.

IV. INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

- *Më 24 qershor 2014, Shqipëria fitoi statusin e vendit kandidat në Bashkimin Evropian. Raportet periodike të KE-së vlerësojnë kontributin e Bankës së Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, ruajtjes së stabilitetit financiar, përmirësimit të praktikave mbikëqyrëse, dhe nxitjes së zhvillimit të tregjeve dhe të sistemit të pagesave në vend.*

INTEGRIMI EVROPIAN

Më 24 qershor 2014, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) i dhanë Shqipërisë statusin e vendit kandidat. Vendimi i mësipërm, u ratifikua nga kryetarët e shteteve dhe të qeverive në samitin evropian të Luksemburgut (26-27 korrik 2014). Dhënia e statusit kandidat përbën një vlerësim për reformat e ndërmarra nga Shqipëria, përçon një sinjal të rëndësishëm se vendi është duke lëvizur në fazën e radhës të procesit të integrimit evropian dhe e ngre marrëdhënien me BE-në në një stad të ri.

Në muajin tetor 2014, Komisioni Evropian publikoi raportin e tij vjetor për progresin e realizuar nga Shqipëria drejt integrimit evropian, duke vlerësuar përpjekjet e vendit për të përmbushur kriteret e Kopenhagenit dhe kushtet e procesit të Stabilizim-Asociimit.

Raporti vlerëson kontributin e Bankës së Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik. Inflacioni i ulët ka krijuar hapësira për lehtësimin e vazhdueshëm të politikës monetare. Megjithatë, ndikimi i politikës monetare në kërkesën agregate mbetet i kufizuar për shkak të sjelljes së bankave ndaj rrezikut. Sistemi bankar vlerësohet i mirëkapitalizuar dhe likuid, ndërkohë që nënvizohet nevoja për masa të tjera për trajtimin e kredive me probleme. Këto të fundit shihen si barriera që pengojnë thellimin e ndërmjetësimit financiar.

Komisioni vlerëson progresin e realizuar në fushën e lëvizjeve të kapitalit falë implementimit të ligjit për sistemet e pagesave. Raporti përmend dhënien e një licence për operatorin e sistemit kombëtar të pagesave me kartë si dhe nxjerrjen e rregullores për ngritjen dhe funksionimin e komitetit kombëtar të sistemeve të pagesave.

Raporti vlerëson progresin e arritur në fushën e shërbimeve financiare, kryesisht në lidhje me kuadrin legjislativ për mbikëqyrjen e sektorit bankar dhe atij jobankar. Në mënyrë të veçantë vlerësohet miratimi i politikës së re mbikëqyrëse dhe i manualit të ri të vlerësimit të rrezikut, nga ana e Bankës së

Shqipërisë, nëpërmjet të cilave është bërë progres në përafrimin me sistemin e vlerësimit të rrezikut në BE. Gjithashtu, raporti vlerëson përmirësimet e bëra në rregulloren për administrimin e rrezikut të kredisë, kriteret në lidhje me fshirjen e kredive të këqija, miratimin e rregullores për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave si dhe udhëzimin për planet e rimëkëmbjes. Sipas raportit, Shqipëria vazhdoi zbatimin e parimeve të Bazel II në përputhje me planin e veprimit.

Në fushën e politikës monetare, raporti vlerëson ruajtjen e regjimit të politikës monetare, atë të inflacionit të shënjestruar në kushtet e një regjimi të lirë kursi këmbimi, çka ka mundësuar stabilitetin e çmimeve të konsumit, ndërkohë që përmendet edhe nevoja për të përafruar ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" me legjislacionin e BE-së.

Gjatë periudhës prill-shtator 2014, Banka e Shqipërisë zbatoi me sukses programin e asistencës teknike me Bankën Qendrore Evropiane dhe 11 banka të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore[49] (SEBQ). Qëllimi i këtij programi ishte mbështetja e Bankës së Shqipërisë për forcimin e kapaciteteve, reformës legjislative dhe administrative në kuadër të përgatitjeve për anëtarësim në SEBQ. Produkt i programit ishin një seri rekomandimesh për institucionin në lidhje me ndryshime dhe përmirësime për t'u përafruar me standardet e BE-së dhe me praktikat e mira evropiane.

HAPËSIRË INFORMUESE 6: PROJEKTI "ANALIZA E NEVOJAVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË"

Projekti "Analiza e nevojave të Bankës së Shqipërisë (Needs Analysis for the Bank of Albania) ishte një projekt i konceptuar dhe i udhëhequr nga Banka Qendrore Evropiane (BQE), në partneritet me 11 banka qendrore të BE-së. Ky projekt u zhvillua në kontekstin e një programi më të gjerë të BQE-së "Bashkëpunimi teknik me bankat qendrore të Ballkanit Perëndimor në përgatitjet e anëtarësimit të tyre pranë Sistemit Evropian të Bankave Qendrore", i cili parashikon si vende përfituese vendet kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në BE.

Projekti, i financuar nga fondet e Instrumentit të Para-Anëtarësimit të BE-së, u zbatua njëkohësisht në Bankën Qendrore të Kosovës dhe në Bankën Qendrore të Maqedonisë. Për këtë, edhe aktivitetet promovuese dhe informuese mbi projektin u zhvilluan bashkërisht me përfaqësuesit e të tre bankave qendrore dhe përfaqësuesit e palës evropiane. Në prezantimin e këtij programi, të mbajtur në Tiranë më 17 prill 2014, datë e cila shënoi edhe fillimin e programit, z. Yves Mersch, anëtar i Bordit Ekzekutiv të BQE-së theksoi: "Një bankë qendrore e fortë përbën çelësin për stabilitetin monetar dhe financiar në Evropë dhe në botë. Me këtë iniciativë të përbashkët, komuniteti i bankingut qendror të BE-së është i gatshëm të mbështesë kolegët e Ballkanit Perëndimor në përpjekjen e tyre për të adaptuar standardet më të larta të fushës."

[49] *Bankat qendrore të Gjermanisë, Francës, Italisë, Maltës, Holandës, Austrisë, Portugalisë, Sllovenisë, Sllovakisë, Bullgarisë dhe Republikës Çeke.*

Qëllimi i këtij projekti ishte përforcimi i kapacitetit institucional të Bankës së Shqipërisë, duke identifikuar kriteret ligjore, organizative dhe burimet e nevojshme për përafrim me kuadrin standard institucional dhe operacional të Bankës Qendrore Evropiane, duke konsideruar vizionin e integrimit të Shqipërisë në BE dhe rrjedhimisht të anëtarësimit të Bankës së Shqipërisë në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Projekti me BQE-në dhe bankat partnere u organizua në tre faza dhe u përqendrua në 13 funksione të Bankës së Shqipërisë. Në të u angazhuan 23 ekspertë të bankave qendrore nga 11 vende anëtare të Bashkimit Evropian. Për çdo funksion u identifikuan fillimisht objektivat operacionalë që shërbyen si benchmarks për fazat pasardhëse, të cilat reflektojnë standardet/kërkesat minimale që Banka e Shqipërisë duhet të përmbushë si pjesë e anëtarësimit të vendit në BE. Përgjatë fazës së dytë, pas përcaktimit dhe dakordësimit të benchmarks, ekspertët evropianë kryen takime me punonjësit dhe drejtuesit e çdo fushe mbi vlerësimin e kuadrit aktual operacional dhe institucional. Në përfundim të vizitave vlerësuese, ekspertët përgatitën raporte mbi gjetjet e tyre kryesore. Gjatë fazës së tretë dhe të fundit, u vlerësua hendeku midis kuadrit aktual të bankës dhe objektivave operacionalë të vendosur (benchmarks).

Në përputhje me çka parashikohej në marrëveshjen me institucionet evropiane, gjatë 6 muajve të zbatimit të projektit, pranë Bankës së Shqipërisë ka qëndruar një Koordinator rezident, i zgjedhur nga Banka Qendrore Evropiane dhe bankat partnere, për administrimin e përditshëm të projektit dhe për të bashkërenduar organizimin e vizitave të ekspertëve dhe hartimin e raportit final.

Produkti final i Projektit ishte raporti "Need Assessment Report", ku u paraqitën rekomandimet dhe gjetjet për çdo funksion të analizuar gjatë projektit. Raporti vlerëson se Banka e Shqipërisë është një institucion me kapacitete të mira teknike. Një pjesë e mirë e rregulloreve dhe e praktikave të ndjekura janë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Rekomandimet e propozuara synojnë të shërbejnë si udhëzues për Bankën e Shqipërisë në kuadër të përafrimit të plotë me standardet dhe parimet evropiane. Vlen të theksohet se programi i asistencës teknike të BQE-së parashikon vazhdimin e projektit në të ardhmen me anë të zbatimit të komponentit të dytë të Programit. Komponenti i dytë i zbatuar edhe në bankat qendrore të disa vendeve të rajonit, parashikon hartimin e një plani për implementimin e rekomandimeve të evidentuara gjatë komponentit të parë.

Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë aktive në takimin e Komitetit të Stabilizim Asocimit. Gjithashtu, përfaqësuesit e institucionit kanë marrë pjesë edhe në takimet e radhës të Nënkomitetit BE-Shqipëri për Çështjet Ekonomiko-Financiare dhe Statistikat, ku është raportuar mbi zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, inflacionin dhe politikën monetare, sektorin e jashtëm, zhvillimet dhe reformat në sektorin financiar bankar. Në takimin e Nënkomitetit mbi Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, është raportuar mbi punën në lidhje me përmirësimin e kuadrit rregullator të sistemit bankar dhe atij të lëvizjes së kapitalit.

Përmes instrumentit TAIEX, Banka e Shqipërisë ka kryer tre aktivitete me ekspertë të bankave qendrore të shteteve anëtare për përafrimin e kuadrit ligjor me atë të BE-së në fushat e menaxhimit të statistikave të sektorit të jashtëm, të statistikave monetare dhe financiare, si dhe të kuadrit rregullator të sistemeve të pagesave.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Marrëdhëniet me Fondin Monetar Ndërkombëtar

Kuota e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) qëndroi 60 milionë SDR edhe përgjatë vitit 2014. Shqipëria zotëron 1,337 vota (ose 0.05% të shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së). Ajo ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën dhe San Marinon, dhe kryesohet nga përfaqësuesi italian, z. Carlo Cottarelli, në pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv të konstituencës për periudhën 2014-2016. Kjo konstituencë ka një total prej 106,404 votash (ose 4.22% të shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së).

Në vijim të rezolutës së FMN-së "Rishikimi i 14-të i përgjithshëm i kuotave dhe reforma e Bordit Ekzekutiv të Fondit Monetar Ndërkombëtar", e cila synon rritjen e kuotave për të gjithë anëtarët e FMN-së, në përshtatje me ndryshimet që ka pësuar vitet e fundit pesha dhe roli i vendeve të ndryshme, kuota e Republikës së Shqipërisë do të kalojë në nivelin 139.3 milionë SDR. Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe institucionale për përfundimin e procedurave për rritjen e kësaj kuote. Shqipëria është në pritje të njoftimit nga FMN-ja mbi kryerjen e pagesës për rritjen e kuotës, në momentin kur do të arrihet shumica e nevojshme për të proceduar me rritjet përkatëse të kuotave të vendeve anëtare.

Më 28 shkurt 2014, Bordi Ekzekutiv i FMN-së miratoi marrëveshjen trevjeçare prej 295.42 milionë SDR (rreth 330.9 milionë euro), nën programin *Extended-Fund Facility* (EFF) për Shqipërinë, në mbështetje të programit me reforma të qeverisë. Lëvrimi i saj është në formën e mbështetjes së drejtpërdrejtë për buxhetin dhe synon konsolidimin fiskal afatmesëm, lehtësimin e rreziqeve lidhur me borxhin e lartë publik dhe rregullimin e ekonomisë në periudhën afatshkurtër. Deri në fund të vitit 2014 janë lëvruar dy këste për shumën totale të 47.1 milionë SDR.

Në muajin mars, FMN-ja publikoi raportin e saj në përfundim të misionit në Shqipëri në kuadër të Nenit IV të Neneve të Marrëveshjes së FMN-së. Raporti vëren se Shqipëria ka shmangur me sukses recensionin si pasojë e krizës botërore dhe ka pësuar një goditje më të lehtë ndaj rritjes, krahasuar me vendet fqinje. Inflacioni ka rezultuar i ulët dhe i qëndrueshëm, ndërsa sistemi bankar mjaft i kapitalizuar dhe likuid, falë ndërmarrjes së stimulit fiskal, politikës efektive monetare dhe veprimeve makroprudenciale. FMN-ja nënvizoi se autoritetet kanë përforcuar mbikëqyrjen e sektorit financiar. Në vijim, misioni i FMN-së sugjeroi se lehtësimi i mëtejshëm i politikës monetare mund të ndihmojë kreditimin, nëse mbeten të pandryshuar ekspozimi i lartë në valutë dhe rreziku i cilësisë së kredive. Zgjidhja kryesore për përshpejtimin e kreditimit mbetet trajtimi i kredive me probleme, i cili do të sjellë rivendosjen e besimit ndaj sistemit bankar.

Në muajin shkurt 2014, FMN-ja publikoi raportin në përfundim të misionit sipas Programit për Vlerësimin e Sektorit Financiar (FSAP). Raporti rendit

rekomandime specifike për institucionet e përfshira, me qëllim mbështetjen e tyre në identifikimin e burimeve kryesore për rreziqet sistemike dhe implementimin e politikave të nevojshme për garantimin e elasticitetit të sistemit financiar ndaj goditjeve dhe mundësisë së tejçimit të tyre.

Gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të përfitojë nga asistenca teknike e FMN-së, në formën e konsulencës në fushën e mbikëqyrjes bankare, statistikave dhe stabilitetit financiar. Në këtë kuadër, janë realizuar vizita pune të ndryshme nga ekspertë të FMN-së për çështje të tilla si: rregulloret për kreditë me probleme, implementimi i manualit të ri për bilancin e pagesave (edicioni i gjashtë), kryerja e ushtrimeve të provës së rezistencës, etj.

Marrëdhëniet me Grupin e Bankës Botërore

Grupi i Bankës Botërore vijon të mbetet i angazhuar në Republikën e Shqipërisë përmes zbatimit të Strategjisë së Partneritetit, e cila synon avancimin në zbatimin e prioriteteve të identifikuara nga qeveria përmes ofrimit të mbështetjes për rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike, dhe përmirësimit të qeverisjes dhe axhendës për integrimin evropian të vendit.

Siç është shpjeguar në kapitujt përkatës, bashkëpunimi me Bankën Botërore ka qenë i spikatur në fushën e administrimit të rezervës valutore dhe në atë të mbikëqyrjes bankare.

Marrëdhëniet me bankat qendrore dhe bashkëpunimi teknik

Gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka bërë kujdes të veçantë për zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të saj dypalëshe dhe shumëpalëshe me institucione homologe në rajon dhe më gjerë. Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë aktive në të gjitha takimet e mbajtura nga organizatat dhe grupet ku ajo ka aderuar prej kohësh.

Gjatë vitit të kaluar, Banka e Shqipërisë është vizituar nga shumë personalitete të bankingut qendror dhe të botës akademike, ndërkohë që administratorët dhe personeli i saj kanë zhvilluar një aktivitet intensiv informues dhe promovues të institucionit në takime dhe konferenca të ndryshme ndërkombëtare.

V. ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE INFRASTRUKTURA E BANKËS SË SHQIPËRISË

- *Politikat e burimeve njerëzore orientohen drejt krijimit të një mjedisi pune motivues, që i shërben rritjes profesionale të punonjësve, adoptimit të standardeve më të mira të një banke qendrore moderne dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të kapaciteteve administrative të institucionit.*

BURIMET NJERËZORE

Në 31 dhjetor 2014, numri i punonjësve të Bankës së Shqipërisë ishte 503, prej të cilëve 448 në administratën qendrore dhe 55 në degë. Numri i personave të punësuar rishtazi, gjatë vitit 2014, ishte 28 - të gjithë me arsim të lartë universitar; ndërsa 26 punonjës kanë shkëputur marrëdhëniet e punësimit me Bankën e Shqipërisë. Mosha mesatare e punonjësve ishte 43 vjeç dhe 58% e punonjësve ishin femra. Roli i femrës në drejtimin e institucionit është rritur gjatë viteve. Në fund të vitit 2014, ato mbajnë rreth 52% të pozicioneve drejtuese në Bankën e Shqipërisë.

Grafik 42. Shpërndarja e punonjësve sipas nivelit të kualifikimit



Burimi: Banka e Shqipërisë

Duke vlerësuar si prioritet cilësinë e burimeve njerëzore, Banka e Shqipërisë është përpjekur vazhdimisht të hartojë politika stimuluese për personelin në drejtim të rritjes së kualifikimeve profesionale, marrjes së titujve akademikë dhe të gradave shkencore, si dhe të përfitimit të certifikatave profesionale ndërkombëtare.

Përditësimi i personelit me tendencat dhe risitë e bankingut qendror është kryer përmes trajnimeve brenda dhe jashtë vendit të organizuara kryesisht nga banka të tjera qendrore dhe institucione financiare ndërkombëtare. Pjesa më e madhe e trajnimeve profesionale janë realizuar në fushën e mbikëqyrjes bankare (13%), operacioneve monetare (10%), statistikave (9.5%), ekonometrisë dhe modelimit (7.5%), politikës monetare (7.5%).

INFRASTRUKTURA E RE

Selia e Bankës së Shqipërisë, në qendër të Tiranës, tashmë përfaqëson një vepër të përfunduar. Banka e Shqipërisë ka kryer rikonstruksionin dhe ndërtimin

e ri, duke e kompletuar strukturën dhe lidhjen midis ndërtesës ekzistuese dhe asaj të re si një kompleks të vetëm administrativ me imazhin e vet – një bankë qendrore në përputhje me standardet e bankave të tjera të këtij lloji në Evropë. Aktualisht, pjesa më e madhe e personelit të Bankës së Shqipërisë zhvillon aktivitetin e saj në këtë objekt.

HAPËSIRË INFORMUESE 7: REALIZIMI I PROJEKTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN DHE NDËRTIMIN E BANKËS SË SHQIPËRISË

Rruga përmes së cilës u arrit të realizohej kompleksi ndërtimor administrativ i Bankës së Shqipërisë, përmban tri momente të rëndësishme:

1. *Hartimin e detyrës së projektimit ose të termave të referencës, si platformë për organizimin e konkursit ndërkombëtar për përzgjedhjen e idesë arkitektonike.*

2. *Realizimin e Projektit të përzgjedhur nga konkursi dhe detajimi i tij në përputhje me standardet bashkëkohore në dy faza, Projektide dhe Projektzbatim i plotë inxhinjerik.*

3. *Ndërtimi, realizimi dhe zbatimit i Projektit në përputhje me disiplinën inxhinjerike: nga themelet, karabinaja e konstruksioni, veshjet, rifiniturat dhe detajet më fine të interierit deri në përfundim të veprës si kompleks.*

Detyra e Projektimit dhe konkursi ndërkombëtar

Kërkesat e Detyrës së Projektimit konsistonin në katër pika kryesore:

- *Të mbrohej identiteti "Morpurgo", duke respektuar vlerat arkitektonike që paraqet kjo ndërtesë.*
- *Të ruhej lartësia ekzistuese e ndërtesës, stili dhe karakteri i saj, gjuha arkitektonike.*
- *Ndërtesa e re të respektonte ekzistuesen, duke marrë në konsideratë aksin e ndërtesës dhe duke e theksuar këtë aks si element kryesor.*
- *Ndërtesa e re të zhvillohej 4 kate nën tokë, duke siguruar në këto kate shërbimet dhe parkimet. Gjithashtu, u kërkua parashikimi i ambienteve të tilla si muzeu numizmatik dhe salla e mbledhjeve.*

Detyra e Projektimit kërkonte standarde bashkëkohore. Ajo linte të hapur gjuhën arkitektonike - dilemën e komunikimit midis të vjetrës dhe të resë, pikërisht si çështje që do ta zgjidhte konkursi ndërkombëtar.

Banka e Shqipërisë vendosi organizimin e një konkursi ndërkombëtar për përzgjedhjen e projektidesë më të mirë, e cila i jepte zgjidhje kërkesave funksionale, teknike, teknologjike etj. Duke pasur parasysh rëndësinë e projektit, si dhe për të garantuar konkurrencën dhe pjesëmarrjen e subjekteve më prestigjioze në këtë fushë, Banka e Shqipërisë publikoi njoftimin për zhvillimin e konkursit ndërkombëtar në gazetën ndërkombëtare "Financial Times" dhe në shtypin vendas. Njoftimi iu komunikua edhe ambasadave të huaja, shoqatave profesionale, si dhe u botua në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

Pas këtyre publikimeve, shfaqën interes për të marrë pjesë në konkurs 27 studio projektimi dhe projektues të huaj. Njëkohësisht u përzgjodh një juri ndërkombëtare me ekspertë të njohur të huaj dhe vendas, të cilët kryen vlerësimin artistik dhe teknik, duke ruajtur të fshehtë identitetin e pjesëmarrësve.

Konkursi u zhvillua në tre faza. Në fazën e parë u krye kualifikimi ligjor i dokumentacionit të detyrueshëm të paraqitura nga 27 studio arkitekture, prej të cilave u kualifikuan 17 studio. Në fazën e dytë u kualifikuan 8 projektide arkitektonike, duke ruajtur fshehtësinë e identitetit të pjesëmarrësve. Pas vlerësimit dhe gjykimit skrupuloz të jurisë, u përzgjodhën 3 variantet më të mira. Në fazën e tretë, përpara jurisë u paraqitën të tre konkurrentët më të mirë për të mbrojtur projektidetë e tyre. Në përfundim, juria përcaktoi fituesit e çmimeve si vijon:

Vendi i parë:	*Prof. Arch. Marco Petreschi*
Vendi i dytë:	*Dini & Architettura Associati srl*
Vendi i tretë:	*Associazione Professionale Studio Valle Progettazioni*

Në 29 shkurt 2008 u shpall fituesi i konkursit për projektidenë më të mirë. Vendimi i jurisë u mirëprit nga publiku. Shumë arkitektë, artistë, inxhinierë, intelektualë e kritikë, u prononcuan për variantin fitues si përzgjedhja më e mirë e mundshme e Bankës së Shqipërisë. Shtypi dhe kritika e kohës brenda dhe jashtë Shqipërisë mbështetën variantit fitues.

Projekti

Projekti për "Rikonstruksionin dhe Ndërtimin e Bankës së Shqipërisë" realizuar nga Ark.Marco Petreschi dhe bashkëpunëtorët përbën një projekt të plotë gjithëpërfshirës, si në aspektin e restaurimit dhe të teknologjisë bashkëkohore të korpusit të ri, ashtu dhe në aspektet inxhinjerike konstruktive të realizimit të sistemeve me teknologji moderne.

Projekti zgjidhi dilemën arkitektonike midis ekzistueses dhe të resë, midis traditës dhe modernes duke dialoguar dhe duke siguruar vazhdimësi me ndjeshmërinë e një arkitekti restaurator të kulturës italiane, si Prof.Ark. Marco Petreschi. Ndërtesa e vjetër e Bankës së Shqipërisë në Tiranë, me arkitekturën e trashëguar nga Vittorio Ballio Morpurgo, ka mbetur e pandryshuar dhe është pjesë e historisë. Kompleksiteti i projektit reflektohet në restaurimin dhe integrimin e ndërtesës së vjetër me ndërtimin e ri, përshtatjen me mjeshtëri dhe lidhjen organike midis tyre për vazhdimësinë funksionale të gjithë ndërtesës. Forma e jashtme; rondoja dhe roli i saj i rëndësishëm si qendër e të tërës; atriumi ose oborri i krijuar si hapësirë ndarëse, por edhe bashkuese e dy ndërtesave në "aks"; hyrja, pozicionimi i saj dhe orientimi; planimetria, vendosja e shkallës qendrore dhe forma e saj në lidhje me aksin primar të pjesës së vjetër; fasada, forma dhe ritmi i hapjes së dritareve dhe materialet e saj, janë pjesë e realizimit të projektit.

Zbatimi i projektit për rikonstruksionin dhe ndërtimin e Bankës së Shqipërisë

Zbatimi i projektit kishte dy momente: ndërtesa ekzistuese, e cila u restaurua, dhe ndërtesa e re me 4 kate nën tokë dhe 4 kate mbi tokë në të njëjtën lartësi me atë ekzistuese. Ndërtesa e vjetër iu nënshtrua një restaurimi konservator. Ndërtimi i dy korpuseve të reja, në kahun jugor dhe atë perëndimor, iu nënshtrua një teknologjie bashkëkohore, veçanërisht në ankorimin e murit rrethues nëntokësor, e cila nga pikëpamja inxhinierike është pjesa më e rëndësishme në zbatimin e projektit.

Paralelisht me punimet e kryera nga grupi i inxhinierëve zbatues, vijuan punimet për instalimin e pajisjeve kryesore dhe kryerjen e rifiniturave në objektin ekzistues. Këto konsistonin kryesisht në ndërtimin e muraturave të ndryshme, në instalimet elektrike, informatike, në tarracat ekzistuese, riparimet e shtresave hidroizoluese etj.

VI. KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

- *Komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë, si në përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes dhe efektivitetit të saj, ashtu edhe për arritjen e objektivit të përhershëm të rritjes së besueshmërisë së këtij institucioni qendror. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë e vlerëson komunikimin ndërveprues me publikun si një çështje parësore dhe me rëndësi strategjike, për të transmetuar tek opinioni publik, sa më drejt dhe kuptueshëm, politikën monetare të zbatuar prej saj.*

INFORMIMI I PUBLIKUT

Banka e Shqipërisë përdor një sërë kanalesh komunikimi për informimin e publikut, me qëllim shpjegimin sa më qartë të objektivit të saj, si dhe të mënyrës së përmbushjes së tij. Ndër to përmendim:

Konferencat mujore për shtyp

Banka e Shqipërisë organizon çdo muaj konferencë për shtyp, pas çdo vendimmarrjeje të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë mbi politikën monetare, gjatë së cilës Guvernatori i shpjegon publikut vendimin e marrë dhe analizën e përdorur në mbështetje të kësaj vendimmarrjeje. Gjatë vitit 2014, 8 konferencat për shtyp, të organizuara sipas datave të publikuara në një kalendar vjetor në fillimit të vitit, janë shoqëruar me publikimin e fjalimeve të Guvernatorit dhe të pyetje-përgjigjeve përkatëse, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Raporti i Politikës Monetare

Si instrumenti kryesor i komunikimit të shkruar të politikës monetare, ky raport përcjell te publiku një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe të faktorëve që kanë ndikuar dhe priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend. Gjatë vitit 2014, ai është publikuar rregullisht në formatin e tij tremujor, në gjuhët shqipe dhe angleze.

Prezantimi i Raportit Vjetor në Kuvend

Raporti Vjetor është një publikim i përvitshëm që përshkruan gjendjen ekonomiko-financiare të vendit, si dhe veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë një viti. Ai i prezantohet Kuvendit të Shqipërisë, pas një diskutimi

paraprak nga ana e Guvernatorit me anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Marrëdhëniet me median

Banka e Shqipërisë e konsideron komunikimin me median si element mjaft të rëndësishëm për informimin e publikut në kohë reale mbi vendimet dhe aktivitetet saj, si dhe të sistemit bankar në tërësi. Në këtë kuadër, media është informuar dhe sensibilizuar në vazhdimësi mbi çështje që lidhen, si me bankën, ashtu edhe me ecurinë ekonomike dhe financiare të vendit. Edhe gjatë vitit 2014, ka vijuar komunikimi me median, nëpërmjet konferencave mujore për shtyp apo aktiviteteve të tjera publike. Gjatë këtij viti, për mediat janë zhvilluar edhe 7 prezantime "*off the records*" të raporteve të saj periodike. Këto takime synojnë orientimin e medias në leximin e drejtë të vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë dhe vlerësohen si një mjet mjaft efikas për të përcjellë aktivitetin e Bankës tek publiku.

Daljet në publik

Guvernatori dhe përfaqësuesit e tjerë të Bankës së Shqipërisë komunikojnë me publikun, nëpërmjet fjalimeve, prezantimeve dhe kumtesave të mbajtura në aktivitete të organizuara nga Banka e Shqipërisë apo institucione të tjera vendase dhe të huaja.

Dialogu me sistemin bankar, biznesin dhe botën akademike

Pjesë e komunikimit me publikun, gjatë vitit 2014, kanë qenë edhe forumet dhe tryezat e diskutimit të organizuara me përfaqësues të sistemit bankar, biznesit, e akademisë. Përveç diskutimit të çështjeve të ditës, ato i japin mundësinë Bankës së Shqipërisë të marrë informacion mbi problematikën që kanë sektorë apo rajone të veçanta të vendit.

Botimet

Botimet e Bankës së Shqipërisë ofrojnë informacion të zgjeruar e të përditësuar mbi ekonominë shqiptare dhe atë botërore; mbi zhvillimet në sistemin bankar dhe atë financiar; stabilitetin financiar e paranë; ndryshimet e pasurimet e legjislacionit bankar dhe të kuadrit të tij rregullator; si dhe mbi çështje të tjera, duke u konsoliduar kështu si burim informacionesh të sakta dhe të besueshme për publikun.

Botimet e realizuara gjatë vitit 2014 janë, si çdo vit, periodike dhe joperiodike, dhe numërojnë rreth 5000 faqe analiza, statistika dhe studime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Seti i raporteve periodike edhe gjatë këtij viti ka ruajtur të njëjtën strukturë: Raporti Vjetor (vjetor), Raporti i Politikës Monetare (tremujor), Raporti i Stabilitetit Financiar (gjashtëmujor) dhe Raporti i Mbikëqyrjes (vjetor). Përveç raporteve periodike, kjo gamë pasurohet më tej me Buletinin Zyrtar (mujor), Buletinin e Bankës së Shqipërisë (gjashtëmujor), revistën "Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë" (gjashtëmujore).

Në funksion të intensifikimit të marrëdhënieve me institucionet kërkimore, ekonomike e financiare, dhe me këdo tjetër të interesuar, si dhe në përmbushje të detyrimit të Bankës për të publikuar, informuar dhe shpjeguar objektivat, politikat, procedurat dhe opinionet e saj, Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2014, ka vijuar politikën e shpërndarjes falas të botimeve të saj.

Faqja e internetit

Gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka ofruar transparencë të plotë, duke publikuar në kohë reale, në faqen e saj të internetit, informacion mbi aktivitetet e saj dhe sistemin bankar, si fjalime të administratorëve, deklarata dhe njoftime për shtyp, raporte periodike, vrojtime, analiza dhe studime, statistika dhe tregues të ndryshëm etj. Duke vlerësuar informimin e publikut si pjesë të prioriteteve të saj, nga data 7 maj 2014, Banka e Shqipërisë publikon paraprakisht kalendarin e datave të publikimit të Raportit të Politikës Monetare.

Statistikat

Banka e Shqipërisë zotëron një sistem të pasur statistikash për shumë sektorë të ekonomisë shqiptare, si: sektori bankar, sektori fiskal, sektori real dhe sektori i jashtëm; të cilat publikohen sipas një kalendari të përcaktuar që përditësohet çdo gjashtëmujor. Qëllimi i mbledhjes së këtij informacioni lidhet me qëllimet e bankës qendrore, të tilla si: hartimi i politikës monetare, kompilimi i bilancit të pagesave, si dhe analizimi i sistemit bankar dhe financiar për zhvillimin e këtij sistemi. Statistikat e Bankës së Shqipërisë publikohen në raportet mujore statistikore, në raportet tremujore të politikës monetare dhe në faqen zyrtare të internetit.

EDUKIMI I PUBLIKUT

Strategjia e Komunikimit të Bankës së Shqipërisë synon, ndër të tjera, edukimin e publikut lidhur me një gamë të gjerë çështjesh, duke nisur nga financat personale e bankingu, deri tek ndikimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i Bankës së Shqipërisë në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Edukimi financiar tashmë përbën një domosdoshmëri, duke marrë në konsideratë jo vetëm ritmet e zhvillimit ekonomik, bankar dhe teknologjik, por edhe rëndësinë e peshën që informacioni ka në botën e sotme globale.

Pavarësisht se edukimi i publikut nuk përbën një detyrim ligjor, Banka e Shqipërisë i kushton një rëndësi të veçantë zgjerimit dhe thellimit të kulturës financiare të publikut në vend, e veçanërisht të brezit të ri. Masat e parashikuara në Strategjinë e Komunikimit për këtë qëllim janë zbatuar plotësisht gjatë vitit 2014, duke veçuar, projektin më të spikatur, krijimin e Muzeut të Bankës së Shqipërisë në brendësi të ndërtesës së saj qendrore.

HAPËSIRË INFORMUESE 8: AKTIVITETET EDUKUESE TË ORGANIZUARA GJATË VITIT 2014

Aktivitete në kuadër të Javës Globale të Parasë

Në datat 10-17 mars 2014, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, u bë pjesë e kremtimeve të Javës Globale të Parasë (Global Money Week). Java Globale e Parasë është një festë mbarëbotërore me në fokus paranë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë financiarisht. Gjatë kësaj jave, partnerë të shumtë në mbarë globin, nën koordinimin e Child and Youth Finance International, organizuan aktivitete të larmishme për t'i përfshirë financiarisht fëmijët anembanë globit, duke u mësuar si të kujdesen për paratë, si të kursejnë, si t'i kuptojnë ndryshimet në sistemet ekonomike ku jetojnë, si të fitojnë të ardhura nëpërmjet sipërmarrjes dhe të vendosin bazat për të ardhmen e tyre. Për Javën Globale të Parasë të vitit 2014, Banka e Shqipërisë prezantoi një program edukues sfidues, me përfshirjen e një numri të lartë nxënësish nga shkollat e nivelit të ulët dhe të mesëm. Ndër aktivitetet e zhvilluara mund të rendisim teatrin me kukulla për fëmijë "Çufo dhe Tipi - Një aventurë me verdhushka", konkursin me vizatime "Paraja ime", vizitat e nxënësve në banka dhe takimet me punonjësit, etj.

Mbi pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në Panairin XVII të Librit, Tirana 2014

Duke marrë shkas nga përvoja tashmë trevjeçare e pjesëmarrjes së institucionit tonë në organizime të ngjashme, si dhe duke e vlerësuar Panairin e Librit si një aktivitet tepër të përshtatshëm për prezantimin dhe shpërndarjen e botimeve të BSh-së dhe për ruajtjen e një ure komunikimi të drejtpërdrejtë me publikun e gjerë, Banka e Shqipërisë u bë pjesë e Panairit XVII të Librit "Tirana 2014", të organizuar edhe këtë vit nga Shoqata e Botuesve Shqiptarë, në ambientet e Pallatit të Kongreseve.

Gjatë 5 ditëve të këtij aktiviteti, vizitorëve iu vunë në dispozicion kopje të botimeve të ndryshme periodike, të punimeve shkencore e kërkimore, si dhe të broshurave informative e edukative. Në titujt e ekspozuar u përfshinë botime me interes për individë që i përkasin grup-moshave të ndryshme e që kanë formim të ndryshëm akademik.

Falë pjesëmarrjes në këtë aktivitet vlerësohet që vizitorëve t'iu jenë shpërndarë afërsisht 2 000 kopje botimesh periodike, 3 500 kopje botimesh shkencore, si dhe 11 000 kopje botimesh edukative.

Krijimi i aplikacionit "Albanian Money"

Gjatë vitit 2014, Banka e Shqipërisë krijoi aplikacionin e parë zyrtar "Albanian Money", i cili synon të informojë dhe edukojë publikun e gjerë mbi paranë shqiptare në përgjithësi dhe elementët e saj të sigurisë, në veçanti. Në formë interaktive, ky aplikacion mundëson shqyrtimin e:

- *monedhave dhe kartëmonedhave shqiptare në qarkullim;*
- *elementëve të sigurisë së kartëmonedhave;*
- *kursit zyrtar të këmbimit valutor përkundrejt monedhës vendase Lek, të përditësuar në mënyrë automatike.*

Ky aplikacion, i disponueshëm në gjuhët shqip dhe anglisht, është i përshtatshëm për përdorim në web, si dhe mund të shkarkohet pa pagesë nga të gjithë telefonat me sistem operimi IOS (iphone, ipad, ipod), android dhe pajisje tablet.

VII. KONTROLLI I BRENDSHËM

- *Kontrolli i brendshëm në Bankën e Shqipërisë realizohet nga Departamenti i Kontrollit. Objektivi kryesor i tij është të sigurojë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë. Një tjetër objektiv i tij është të veprojë si një masë kontrolli e përgjithshme dhe shërbim këshillimi për Administratorët dhe Këshillin Mbikëqyrës, duke dhënë ndihmesën e tij në drejtim të ruajtjes së integritetit të informacionit, përdorimit eficient të burimeve dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë.*

Administratorët dhe drejtorët e departamenteve mbajnë përgjegjësi për hartimin, implementimin dhe monitorimin e sistemeve të përshtatshme të kontrollit të brendshëm. Funksioni i kontrollit i siguron administratorëve të bankës, në mënyrë periodike dhe të pavarur, verifikimin dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke testuar kontrollet dhe procedurat e caktuara, pa qenë një zevendësues i tyre.

Veprimtaria e Departamentit të Kontrollit për vitin 2014, u bazua në planin e auditimit të brendshëm të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm, pas komunikimit të tij pranë Guvernatorit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Për vitin 2014, u planifikuan gjithsej 16 angazhime auditimi për dhënie sigurie, nga të cilat 2 janë angazhime auditimi periodike me bazë tremujore dhe 2 angazhime këshillimi.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014, Departamenti i Kontrollit kreu veprimtarinë e tij në përputhje me planin e auditimit të brendshëm, duke përfunduar 8 angazhime auditimi dhe duke raportuar për secilin prej tyre pranë Administratorëve në 8 raporte auditimi. Gjatë muajit janar 2014, u përfunduan dhe u raportuan edhe 2 angazhime të planifikuara për vitin 2013.

Për secilin nga angazhimet e kryera të auditimit, vlerësimi i mjaftueshmërisë së kontrolleve të vendosura dhe gjetjet e evidentuara për përmirësim, u adresuan fillimisht pranë drejtuesve të njësive organizative objekt auditi, me qëllim marrjen e komenteve dhe më pas u vunë në vëmendje të Administratorëve të Bankës së Shqipërisë. Sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullative, përmbledhja e problematikave kryesore të auditimeve të periudhës, analiza e punës së aktivitetit të Departamentit të Kontrollit dhe ndjekja e statusit të zbatimit të rekomandimeve, u raportuan nga Inspektori i Përgjithshëm pranë Këshillit Mbikëqyrës, me bazë tremujore (në maj 2014 për aktivitetin e tremujorit të parë dhe në gusht 2014 për aktivitetin e tremujorit të dytë të vitit 2014).

Gjatë vitit 2014, plani i auditimit u rishikua për të adresuar rekomandimet dhe kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar, si dhe për të vlerësuar mangësitë/dështimet në sistemin e kontrollit të funksionit "Emetimi dhe Administrimi i Parasë", pas ngjarjes së përvetësimit të kundraligjshëm të vlerave monetare, në muajin korrik 2014.

Në mungesë të Inspektorit të Përgjithshëm, detyrimet dhe përgjegjësitë ligjore e rregullative të lidhura direkt me këtë pozicion nuk mund të përmbusheshin. Gjatë katërmujorit të fundit të vitit 2014, Departamenti i Kontrollit vijoi punën për angazhimet e auditimeve të nisura me miratimin e Inspektorit të Përgjithshëm, të cilat ishin në proces gjatë muajit shtator 2014.

Gjatë këtij viti, u adresuan gjithsej 67 rekomandime të reja. Përmbledhja e tyre në formë raportesh periodike me bazë tremujore është paraqitur pranë Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nga Inspektori i Përgjithshëm.

Departamenti i Kontrollit, gjatë kësaj periudhe, është angazhuar edhe në detyra të tjera joauditueseve si:

- Rishikimi i bazës rregullative. Pas hartimit përfundimtar, u propozuan për miratim dy dokumente: (1) "Politika e Auditimit të Brendshëm në Bankën e Shqipërisë" dhe rregullorja (2) "Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Kontrollit". Rishikimi i bazës rregullative synon të përcaktojë qartë qëllimin, autoritetin dhe përgjegjësitë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë, në përputhje me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, me Kodin e Etikës dhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm. Dokumenti "Politika e Auditimit të Brendshëm në Bankën e Shqipërisë" është projektuar duke u mbështetur në Statutin e Auditimit të Brendshëm, të propozuar nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA), si dhe në disa dokumente të ngjashme të bankave qendrore. Dy projektet u propozuan për miratim pranë Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në muajin mars 2014 dhe versione të rishikuara të tyre u propozuan për miratim në muajt qershor dhe gusht 2014.

- Pjesëmarrja në grupet e punës dhe në komisionet e inventarizimit. Në vijim të ngjarjes së muajit korrik 2014 në Bankën e Shqipërisë, angazhimi dhe fokusi i Departamentit të Kontrollit u orientua drejt vlerësimit të situatës dhe propozimit të masave të nevojshme për forcimin e sistemeve të kontrollit në proceset e prekura. Gjatë periudhës korrik–dhjetor 2014, inspektorët e kontrollit u angazhuan me urdhër të Administratorit, në komisionet e ndryshme për inventarizimin e vlerave monetare, komisionet për vlerësimimin e administrimit të informacionit të klasifikuar etj. Pjesëmarrja në këto grupe/komisione ishte në cilësinë e anëtarëve apo të vëzhguesve të procesit për të vlerësuar zbatueshmërinë e procedurave dhe për të identifikuar nevojat për përmirësim në këto procese.

Vlerësimet e jashtme të aktivitetit të auditimit të brendshëm

Gjatë vitit 2014, funksioni i auditimit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë, i realizuar nga Departamenti i Kontrollit, ishte objekt i disa vlerësimeve nga institucione/organizata financiare vendase dhe të huaja si Fondi Monetar Ndërkombëtar (mars 2014), Banka Qendrore Evropiane (maj 2014), Kontrolli i Lartë i Shtetit (qershor 2014) dhe Korpusi i Vullnetarëve për Shërbime Financiare (nëntor 2014). Nga këto vlerësime rezultoi se aktiviteti i auditimit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë "përgjithësisht përputhet" me standardet IPPF (Kuadri Ndërkombëtar i Praktikave Profesionale) dhe me Kodin e Etikës të Auditimit të Brendshëm.

VIII. OBJEKTIVAT E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2015

- *Objektivat e Bankës së Shqipërisë janë detajuar në dokumentin e strategjisë afatmesme të Bankës së Shqipërisë[50]. Me anë të kësaj strategjie, Banka e Shqipërisë synon: (i) të ofrojë një përgjigje proaktive ndaj sfidave në mjedisin në të cilin operon banka qendrore; (ii) të nxisë përdorimin efektiv dhe eficient të burimeve; dhe (iii) të promovojë llogaridhënien e Bankës së Shqipërisë. Strategjia përbën një plan konkret dhe transparent që shërben si mjet komunikimi me punonjësit e bankës qendrore dhe palët e treta të interesuara.*

Gjatë vitit 2015, objektivat kryesorë të Bankës së Shqipërisë në drejtim të përmbushjes së misionit dhe detyrave të saj ligjore, do të jenë si më poshtë:

- Politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të vazhdojë të orientohet drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Funksioni i politikës monetare do të synojë përmirësime të mëtejshme, në forcimin e kapaciteteve analizuese, parashikuese dhe vendimmarrëse, si dhe në drejtim të rritjes së efektivitetit të transmetimit të saj në ekonomi. Paralelisht me të, politika monetare do të synojë një bashkërendim në rritje me politikën fiskale dhe instrumentet rregullatore dhe mbikëqyrëse.
- Zhvillimi i politikave makroprudenciale do të synojë identifikimin dhe zbatimin e masave për parandalimin, kufizimin dhe trajtimin e rreziqeve financiare sistemike. Ky funksion do të synojë zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të analizës, vlerësimit dhe identifikimit të instrumenteve të duhura të ndërhyrjes. Gjithashtu, ai do të synojë një bashkëpunim në rritje me institucionet mbikëqyrëse dhe rregullatore brenda dhe jashtë vendit, me agjentët financiarë në vend dhe grupet e tjera të interesit.
- Mbikëqyrja bankare do të vijojë të ketë si objektiv themelor të saj sigurimin e një veprimtarie të shëndetshme bankare, e cila garanton sigurinë e kursimeve të qytetarëve, mbështet stabilitetin financiar dhe kontribuon në ecurinë pozitive të ekonomisë në tërësi. Zhvillimi i kuadrit rregullator do të orientohet nga përafrimi me parimet e Bazel II dhe III, si dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
- Funksionet kryesore të Bankës së Shqipërisë do të mbështeten nga zhvillimi i gjithanshëm i kapaciteteve institucionale, në drejtim të adoptimit të praktikave më të mira të bankave qendrore. Një vëmendje të veçantë në këtë drejtim do të ketë plotësimi i rekomandimeve që dolën nga projekti i bashkëpunimit me Bankën Qendrore Evropiane, nga plotësimi i rekomandimeve të Programit të Vlerësimit të Sektorit

[50] *Ky kapitull përmbledh aspektet kryesore të Strategjisë së Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën afatmesme 2013-2015. Materiali i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë: www.bankofalbania.org.*

Financiar (FSAP), dhe respektimi i detyrave dhe angazhimeve të tjera institucionale.

- Banka e Shqipërisë do të synojë një përmirësim të dukshëm të transparencës së politikave dhe të aktivitetit të saj, duke kontribuar kështu në forcimin e llogaridhënies së institucionit dhe në rritjen e besimit të publikut në të.

Drejtimet e mësipërme të punës do të kryhen në përmbushje dhe në zhvillim të mëtejshëm të objektivave të Strategjisë të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë.

IX. RAPORTI I AUDITORIT TË JASHTËM DHE PASQYRAT FINANCIARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2014

KPMG

KPMG Albania Shpk
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Këshillit Mbikëqyrës
të Bankës së Shqipërisë

Tiranë, 23 mars 2015

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Bankës së Shqipërisë ("Banka") siç paraqiten në faqet 1 deri 43, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Banka e Shqipërisë siç shpjegohet në shënimin 2 (a) të pasqyrave financiare bashkëngjitur, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi ynë, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

KPMG Albania Shpk, an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.

Registered in the National Registration Center with VAT Number J91619001D

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë, të gjendjes financiare të Bankës më 31 dhjetor 2014, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Banka e Shqipërisë siç shpjegohet në shënimin 2 (a) të pasqyrave financiare bashkëngjitur.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 u audituan nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion pa rezervë mbi ato pasqyra më 18 mars 2014.

Tzvetelinka Koleva

Tzvetelinka Koleva
Ekspert Kontabël i Regjistruar
KPMG Albania Sh.p.k.

Gordana Nikushevska
Administrator
KPMG Macedonia DOO

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Në milionë lekë	Shënime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
AKTIVET			
Aktive në monedhë të huaj			
Ari dhe metale të çmuara	5	9,569	8,474
Llogari me Fondin Monetar Ndërkombëtar	6	21,792	20,220
Depozita në bankat jorezidente	7	30,003	21,661
Investime të vlefshme për shitje	8	242,419	230,588
Investime të mbajtura për tregtim	9	14,378	12,591
Aktive të tjera në monedhë të huaj	10	779	577
Totali i aktiveve në monedhë të huaj		318,940	294,111
Aktive vendase			
Ari dhe metale të çmuara	5	4,483	4,021
Kredi ndaj bankave rezidente	11	25,548	21,502
Investime të vlefshme për shitje	12	63,948	63,920
Të drejta ndaj Qeverisë Shqiptare	13	7,398	-
Aktive të tjera vendase	14	13,009	12,388
Totali i aktiveve vendase		114,386	101,831
Totali i aktiveve		433,326	395,942
DETYRIMET			
Detyrime në monedhë të huaj			
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	6	25,330	18,633
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	15	1,255	1,256
Detyrime të tjera të huaja	16	230	-
Totali i detyrimeve në monedhë të huaj		26,815	19,889
Detyrime vendase			
Para në qarkullim	17	226,407	207,766
Detyrime ndaj bankave rezidente	18	106,311	100,031
Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare	19	17,578	23,779
Detyrime të tjera vendase	20	1,826	1,546
Totali i detyrimeve vendase		352,122	333,122
Totali i detyrimeve		378,937	353,011
KAPITALI I VET DHE REZERVAT			
Fondi i themelimit		2,500	2,500
Rezerva ligjore		12,500	12,500
Rezerva e rivlerësimit	21	21,930	10,421
Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme		1,711	1,750
Rezerva të tjera	22	15,748	15,760
Totali i kapitalit të vet dhe rezervat		54,389	42,931
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat		433,326	395,942

Shënimet nga faqja 8 deri në faqen 48 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 4 mars 2015 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Gent Sejko

Guvernator

Arjeza Beja (Harizaj)

Drejtor i Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe i Kontabilitetit e Financës

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
Në milionë lekë	Shënime	2014	2013
Veprime me jorezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	23	4,640	5,171
Shpenzime për interesa dhe komisione	24	(3,457)	(4,158)
Veprimet me jorezidentë, neto		1,183	1,013
Veprime me rezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	25	3,095	4,387
Shpenzime për interesa dhe komisione	26	(856)	(930)
Veprime me rezidentë, neto		2,239	3,457
Të ardhura operative të tjera, neto	27	970	654
Të ardhura nga instrumente të tregtueshme, neto	28	182	56
Fitimi/(humbja) neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit dhe nga rivlerësimi i arit	21	10,478	(9,660)
Totali i të ardhurave/(humbjeve) nga aktiviteti bankar		15,052	(4,480)
Shpenzime të tjera administrative			
Shpenzime personeli	29	(1,051)	(1,116)
Shpenzime zhvlerësimi	14	(519)	(244)
Shpenzime amortizimi	14	(269)	(126)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		(675)	(690)
Shpenzime te tjera	30	(713)	-
Totali i shpenzimeve të tjera administrative		(3,227)	(2,176)
Fitimi/(humbja) neto nga aktiviteti bankar		11,825	(6,656)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Zëra që janë riklasifikuar, ose mund të riklasifikohen në fitim ose humbje			
Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	21	1,003	(754)
Rezerva të tjera rivlerësimi		-	9
Të ardhura/(humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		1,003	(745)
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse për vitin		12,828	(7,401)
Shpërndarja e fitimit:			
Fitimi/(humbja) neto nga aktiviteti bankar		11,825	(6,656)
Transferim (në)/nga rezerva e rivlerësimit		(10,478)	9,660
Fitimi përpara shpërndarjes		1,347	3,004
Shpërndarja/(përdorimi) i fitimit nga Banka e Shqipërisë			
Rimarrje nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		39	39
Krijim fondi rezervë		-	(12)
Totali i fitimit të shpërndarë për Qeverinë Shqiptare		1,386	3,031

Shënimet nga faqja 105 deri në faqen 145 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2014 dhe 2013

Në milionë lekë	Fondi i themelimit	Rezerva ligjore	Rezervat e rivlerësimit	Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme	Rezerva të tjera	Fitim i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2013	2,500	12,500	20,826	1,789	15,748	-	53,363
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse							
Humbja neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	(6,656)	(6,656)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse							
Rivlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje (shënimi 21)	-	-	(754)	-	-	-	(754)
Rezerva të tjera rivlerësimi	-	-	9	-	-	-	9
Rimarrje e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	-	-	-	(39)	-	39	-
Totali i humbjeve të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	(745)	(39)	-	39	(745)
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse	-	-	(745)	(39)	-	(6,617)	(7,401)
Kontributet dhe shpërndarjet							
Transferime nga rezerva e rivlerësimit (shënimi 21)	-	-	(9,660)	-	-	9,660	-
Rezerva të tjera	-	-	-	-	12	(12)	-
Fitimi i shpërndarë Qeverisë Shqiptare	-	-	-	-	-	(3,031)	(3,031)
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	-	-	(9,660)	-	12	6,617	(3,031)
Gjendja më 31 dhjetor 2013	2,500	12,500	10,421	1,750	15,760	-	42,931
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse							
Fitimi neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	11,825	11,825
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse							
Rivlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje (shënimi 21)	-	-	1,003	-	-	-	1,003
Rimarrje e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	-	-	-	(39)	-	39	-
Totali i të ardhurave/(humbjeve) të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	1,003	(39)	-	39	1,003
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse	-	-	1,003	(39)	-	11,864	12,828
Kontributet dhe shpërndarjet							
Transferime në rezervën e rivlerësimit (shënimi 21)	-	-	10,478	-	-	(10,478)	-
Rezerva të tjera rivlerësimi	-	-	28	-	-	-	28
Rezerva të tjera	-	-	-	-	(12)	-	(12)
Fitimi i shpërndarë Qeverisë Shqiptare	-	-	-	-	-	(1,386)	(1,386)
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	-	-	10,506	-	(12)	(11,864)	(1,370)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	2,500	12,500	21,930	1,711	15,748	-	54,389

Shënimet nga faqja 105 deri në faqen 145 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Në milionë lekë	Shënime	2014	2013
Flukset e parave nga aktivitetet operacionale			
Fitimi/(humbja) neto nga aktiviteti bankar		11,825	(6,656)
Rregullime për:			
Të ardhura nga interesat dhe komisionet (jorezidentë)	23	(4,640)	(5,171)
Shpenzime për interesat dhe komisionet (jorezidentë)	24	3,457	4,158
Të ardhura nga interesat dhe komisionet (rezidentë)	25	(3,095)	(4,387)
Shpenzime për interesat dhe komisionet (rezidentë)	26	856	930
Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto	28	(182)	(56)
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje	27	(834)	(420)
Fitimi nga kontratat derivative të së ardhmes	27	-	(223)
Provigjone për hua të dyshimta		3	13
Fitime/(humbje) neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit dhe nga rivlerësimi i arit	21	(10,478)	9,660
Zhvlerësimi dhe amortizimi	14	788	370
		(2,300)	(1,782)
Ndryshime në:			
Llogaritë me Fondin Monetar Ndërkombëtar		(1,573)	(1,575)
Aktivet e tjera në monedhë të huaj		(223)	135
Aktivet e tjera vendase		259	99
Të drejtat ndaj Qeverisë Shqiptare		(7,398)	-
Detyrimet ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar		6,699	(1,562)
Detyrimet ndaj institucioneve financiare jovendase		(1)	4
Detyrimet e tjera të huaja		230	(131)
Detyrimet ndaj bankave vendase		6,286	2,976
Detyrimet ndaj Qeverisë Shqiptare		(5,801)	9,517
Detyrimet e tjera vendase		280	(140)
Investimet e mbajtura për tregtim (në monedhë të huaj)		(149)	(77)
		(1,391)	9,246
Interesa të arkëtuara		4,627	6,293
Interesa të paguara		(932)	(965)
Para neto nga aktivitetet operacionale		4	12,792
Flukset e parave nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		(1,357)	(1,078)
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara		(311)	(567)
Blerje e letrave me vlerë të vlefshme për shitje (në monedhë të huaj)		(190,850)	(263,295)
Blerje e letrave me vlerë të vlefshme për shitje (vendase)		(106,642)	(109,395)
Shitje dhe maturime të letrave me vlerë të vlefshme për shitje (në monedhë të huaj)		186,724	241,246
Shitje dhe maturime të letrave me vlerë të vlefshme për shitje (vendase)		106,614	112,686
(Rritje)/Rënie në marrëveshjet e riblerjes		(4,042)	281
Fitime/(humbje) të realizuara nga kursi i këmbimit		1,327	(386)
Para neto të përdorura në aktivitetet investuese		(8,537)	(20,508)
Flukset e parave nga aktivitetet financuese			
Rritje në emetimin e parasë në qarkullim		-	16,000
Fitimi i shpërndarë		(1,786)	(4,793)
Para neto (të përdorura në)/nga aktivitetet financuese		(1,786)	11,207
(Ulja)/Rritja në para dhe ekuivalentët e saj gjatë vitit		(10,319)	3,491
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		68,934	65,443
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	31	58,615	68,934

Shënimet nga faqja 105 deri në faqen 145 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(të gjitha shumat janë në milionë lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Banka e Shqipërisë ("Banka") është Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997, "Për Bankën e Shqipërisë".

Në zbatim të këtij ligji, detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë janë si vijon:

- të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor;
- të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë regjimin e këmbimit valutor, si dhe politikën e kursit të këmbimit të valutave në Republikën e Shqipërisë;
- të licencojë ose të revokojë licencat e bankave dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre bankare, me qëllim që të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar;
- të disponojë dhe të administrojë rezervat e saj valutore;
- të veprojë me cilësinë e bankierit, këshilltarit dhe të agjentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë; dhe
- të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për Bankën e Shqipërisë".

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të përshtatura në Manualin e Kontabilitetit të Bankës, miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 50, datë 26 janar 2001, si dhe politika dhe procedura të tjera kontabël të miratuara.

Politikat e rëndësishme kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përshkruar në shënimin 3. Politikat kontabël të përdorura në përgatitjen dhe paraqitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përgjithësisht në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ('SNRF') të aprovuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK'). Si pjesë e kalimit të saj drejt SNRF-ve, Banka është në procesin e përgatitjes së pasqyrave financiare paraprake sipas SNRF-ve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014, për të përcaktuar pasqyrën e pozicionit financiar, rezultatet nga operacionet dhe flukset monetare të Bankës, që nevojiten për të siguruar informacionin financiar krahasues, që pritet të përfshihet në pasqyrat e para

të plota financiare sipas SNRF-ve të Bankës më dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2015.

(b) Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

· instrumentet derivative financiare dhe instrumentet financiare joderivative me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë matur me vlerë të drejtë
· aktivet financiare të vlefshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë;
· ari është matur me vlerë të drejtë;
· ndërtesat janë matur me vlerën e rivlerësuar.

(c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lek shqiptar ("Lekë"), e cila është monedha funksionale e Bankës. Nëse nuk është shënuar ndryshe, të gjitha shumat janë rrumbullakosur në milionin më të afërt.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare drejtimi i Bankës bën gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara. Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në periudhat në vijim.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm të pasigurive në vlerësim dhe të gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël, të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare, është përshkruar në shënimin 4.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të shpjeguara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e kalimit të saj drejt SNRF-ve, Banka është në proces të përfundimit të përzgjedhjes dhe të zbatimit të politikave kontabël për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me SNRF-të. Kjo përfshin përcaktimin e standardeve dhe interpretimeve që priten të jenë efektive kur pasqyrat e para të plota financiare sipas SNRF të përgatiten më 31 dhjetor 2015, dhe identifikimin e ndryshimeve midis politikave kontabël të përzgjedhura dhe të zbatuara nën kuadrin aktual të raportimit financiar dhe SNRF-ve.

Ekziston mundësia që klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve, shumat e tyre dhe shënimet shpjeguese në këto pasqyra financiare, të kërkojnë rregullime para se të realizohen pasqyrat financiare sipas SNRF-ve më datë 31 dhjetor 2015, kohë në të cilën Banka do të përgatisë pasqyrat e para të plota financiare sipas SNRF-ve. Në pasqyrat e para të plota financiare sipas SNRF-ve do të jepet një shpjegim se si kalimi në SNRF ndikon në pozicionin e raportuar financiar, në rezultatin financiar dhe në flukset monetare të Bankës.

a. Interesat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton saktësisht pagesat e vlerësuara monetare të ardhshme dhe arkëtimet gjatë jetës së pritshme të aktivit ose detyrimit financiar (ose, kur është e përshtatshme, merret në konsideratë një periudhë më e shkurtër) deri në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Në përllogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme, duke konsideruar gjithë kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, me përjashtim të humbjeve të ardhshme që rrjedhin nga rreziku i kreditit.

Përllogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksioneve dhe tarifat e paguara ose të arkëtuara që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ), përfshijnë:

- interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare të matur me kosto historike, të llogaritur në bazë të normës efektive të interesit;
- interesin e investimeve të vlefshme për shitje, të llogaritur në bazë të normës efektive të interesit.

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit mbi gjithë aktivet dhe detyrimet e tregtueshme konsiderohen si të rastësishme nga operacionet e tregtimit të Bankës dhe paraqiten së bashku me gjithë ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të tregtueshme, tek të ardhurat nga instrumentet e tregtueshme neto (shih b.).

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv të një aktivi ose detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet e tjera përbëhen kryesisht nga tarifa transaksionesh ose shërbimesh, të cilat njihen si shpenzim në momentin që përfitohen shërbimet.

b. Të ardhurat nga instrumentet e tregtueshme, neto

Të ardhurat nga instrumentet e tregtueshme neto përbëhen nga fitimet minus humbjet nga aktivet dhe detyrimet e tregtueshme, dhe përfshijnë gjithë ndryshimet e realizuara dhe të parealizuara në vlerën e drejtë, interesin dhe diferencat nga kurset e këmbimit.

c. Të ardhura/shpenzime të tjera operative

Të ardhurat/shpenzimet e tjera operative përfshijnë fitmet dhe humbjet që vijnë nga shitjet dhe ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të vlefshme për shitje.

d. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale përkatëse, me kursin aktual të këmbimit në datat e kryerjes së veprimeve.

Në datën e raportimit, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale, me kursin zyrtar të këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja në zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit aktual në fund të viti.

Aktivet dhe detyrimet jomonetare që maten me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jomonetare që janë vlerësuar sipas kostos historike në monedhë të huaj, konvertohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit.

Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi njihen në fitim ose humbje. Fitimet ose humbjet neto nga këmbimi valutor përfshijnë të gjitha diferencat nga kursi i këmbimit të transaksioneve me kursin aktual të këmbimit me datë shlyerje dy ditë mbas datës së tregtimit, megjithëse këto transaksione njihen në ditën e shlyerjes.

Në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997, "Për Bankën e Shqipërisë", si dhe Vendimin nr. 104, datë 27 dhjetor 2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, diferencat e kursit të këmbimit që rezultojnë nga rivlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj, rivlerësimi i arit dhe metaleve të çmuara, si dhe rivlerësimi i llogarive në SDR, njihen fillimisht në fitim ose humbje në periudhën në të cilën lindin, dhe më pas transferohen nga fitimi i pashpërndarë tek "Rezervat e rivlerësimit", pjesë e Kapitalit dhe Rezervave.

e. Tatimi dhe politika e Bankës për shpërndarjen e fitimit

Në përputhje më ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", Banka nuk është subjekt i tatimit mbi fitimin.

Politika e shpërndarjes së fitimit të aktivitetit bankar është përcaktuar në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" ("Ligji"). Sipas nenit 10.2 të këtij ligji, i gjithë fitimi i realizuar kalon në Buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve për fondin rezervë, sipas ligjit dhe të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.

Sipas nenit 64, pika (a) e ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", si dhe vendimit nr. 104, datë 27 dhjetor 2006, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, fitim/humbja neto që rezulton nga rivlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj, rivlerësimi i arit dhe metaleve të çmuara, si dhe rivlerësimi i llogarive në SDR, njihet fillimisht në fitim ose humbje në periudhën në të cilën lindin, dhe më pas transferohen nga fitimi i pashpërndarë tek "Rezervat e rivlerësimit", pjesë e Kapitalit dhe Rezervave. Sipas nenit 64, pika (b), Qeveria Shqiptare emeton letra me vlerë të borxhit me norma interesi tregu për të mbuluar çdo tepricë negative të rezervës së rivlerësimit të ardhur nga aktiviteti i Bankës.

Sipas nenit 11 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", nuk do të bëhet asnjë transferim, shpërndarje apo pagesë sipas neneve 8, 9 ose 10 të këtij ligji, nëse aktivet e Bankës janë më pak se shuma e detyrimeve dhe fondit të themelimit. Në këto kushte, bazuar në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", neni 7, Ministria e Financave mund t'i transferojë Bankës letra të negociueshme me vlerë të qeverisë me interes, në shumën e nevojshme për të mbuluar pamjaftueshmërinë.

f. Rezerva ligjore dhe të tjera

Në përputhje me kërkesat e nenit 9 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", Banka ka krijuar një Rezervë Ligjore, në të cilën transferohet 25% e fitimit neto për vitin, deri sa shuma e rezervës arrin 500% të fondit të themelimit. Më 31 dhjetor 2011, Banka e ka plotësuar këtë detyrim për rezerva, në shumën prej 12,500 milionë lekësh.

g. Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet në datën në të cilën lindin. Të gjithë instrumentet e tjera financiare (duke përfshirë blerjet dhe shitjet e zakonshme të aktiveve financiare) njihen në datën e tregtimit, e cila është data në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për zërat jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e saj.

(ii) Klasifikimi

Aktivet financiare

Banka i klasifikon aktivet financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- të vlefshme për shitje;
- të mbajtura për tregtim; dhe
- hua dhe llogari të arkëtueshme.

Shih i., j., k., l., m., n., o. dhe q.

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, të ndryshme nga garancitë financiare dhe angazhimet e huadhënies, si të matura me kosto të amortizuar. Shih o. dhe p.

(iii) Çregjistrimi

Aktivet financiare

Banka çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë të aktivit financiar është transferuar ose me anë të së cilit Banka nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Në çregjistrimin e një aktivi financiar, diferenca mes vlerës kontabël të aktivit (ose vlerës kontabël të caktuar pjesës së aktivit të ç'regjistruar) dhe shumës së (i) shumës së arkëtuar (përfshirë çdo aktiv të ri të përfituar minus çdo detyrim të ri të marrë përsipër) dhe (ii) çdo fitim ose humbje të akumuluar që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, njihet si fitim ose humbje. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara, që kualifikohet për çregjistrim, i mbajtur ose i krijuar nga Banka, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, anuluar apo kanë skaduar.

(iv) Kompensimi (netimi)

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen, dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur, Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe synon t'i shlyejë ato në baza neto ose të njohë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga SNRF-të, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme, si për shembull ato që lidhen me aktivitetin tregtar të Bankës.

(v) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus ripagimet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë, ndërmjet shumës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm, tek i cili Banka ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e tij të mosekzekutimit.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti, duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë se transaksionet e aktivit ose pasivit ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në baza të vazhdueshme. Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Çmimi i tregtimit të një instrumenti financiar në çastin e njohjes është evidenca me e saktë e vlerës së drejtë të tij – pra vlera e drejtë e shumës së paguar ose të marrë. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nëpërmjet një çmimi të kuotuar në një treg aktiv, duke ju referuar një aktivi ose pasivi identik, dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë ndryshimin midis vlerës së drejtë të njohjes fillestare dhe çmimit të transaksionit. Në periudhat në vijim, kjo diferencë njihet si fitim ose humbje në baza të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se momenti kur vlerësimi është i mbështetur plotësisht nga të dhëna të vrojtueshme në treg ose transaksioni mbyllet.

Në qoftë se një aktiv ose detyrim i matur me vlerë të drejtë ka një çmim oferte ("Bid") dhe një çmim kërkese ("Ask"), atëherë Banka vlerëson aktivet dhe pozicionet në blerje sipas çmimit të ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet në shitje sipas çmimit të kërkesës.

Vlera e drejtë e depozitës në të parë është jo më pak se shuma e pagueshme në të parë, e skontuar prej datës së parë në të cilën shuma mund të kërkohet për t'u paguar.

Banka njeh transferimin ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Vlerësimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, janë zhvlerësuar.

Një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare zhvlerësohen kur evidencat objektive tregojnë se ka ndodhur, pas njohjes fillestare të aktivit (aktiveve), një ngjarje që sjell humbje, dhe kjo ngjarje ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit (aktiveve) që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara përfshijnë:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të huamarrësit ose emetuesit;
- dështim ose shkelje nga huamarrësit;
- të dhëna që huamarrësi ose huadhënësi po falimenton;
- zhdukja e një tregu aktiv për letrën me vlerë; ose
- të dhëna të dukshme lidhur me një grup aktivesh, si p.sh. ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një apo grupi huamarrësish ose emetuesish, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve që maten me kosto të amortizuar, llogariten si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të mjeteve monetare të pritshme, të skontuara me vlerën fillestare të interesit efektiv të aktivit. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe llogarive të arkëtueshme ose të investimeve të mbajtura deri në maturim. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet mbylljes së pozicionit të skontimit. Nëse një ngjarje që ndodh pasi është njohur zhvlerësimi shkakton uljen e shumës së humbjes nga zhvlerësimi, zvogëlimi i humbjes nga zhvlerësimi rishikohet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Humbjet nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje, njihen duke riklasifikuar humbjet e akumuluara në rezervën e vlerës së drejtë në kapital në fitim ose humbje. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga kapitali në fitim apo humbje, është diferenca midis kostos së blerjes, neto nga shlyerjet e principalit dhe amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, minus çdo humbje të njohur më parë nga zhvlerësimi në fitim ose humbje. Ndryshimet në zhvlerësim që i atribuohen zbatimit të metodës së interesit efektiv reflektohen si një komponent i të ardhurave nga interesi.

Në qoftë se në periudhat në vijim, vlera e drejtë e një letre me vlerë të vlefshëm për shitje të zhvlerësuar rritet, dhe kjo rritje mund të lidhet në mënyrë

objektive me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi, atëherë humbja nga zhvlerësimi rregullohet nëpërmjet fitimit ose humbjes; në të kundërt, çdo rritje e vlerës së drejtë njihet nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Çdo rimarrje e mëvonshme në vlerën e drejtë të një letre me vlerë të vlefshme për shitje të zhvlerësuar në formën e aksioneve, njihet gjithmonë në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Në kushtet kur Banka konstaton se nuk ka perspektivë realiste rimarjeje, ajo mund fshijë pjesërisht ose plotësisht nga bilanci një kredi apo një letër me vlerë të borxhit, si dhe çdo llogari provigjoni për humbjet nga zhvlerësimi të lidhur më të.

(vii) Përcaktimi me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Banka përcakton aktivet dhe pasivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në cilëndo prej rrethanave të mëposhtme.

- Aktivet ose detyrimet administrohen, vlerësohen e raportohen brenda institucionit me vlerën e drejtë.
- Ky përcaktim eliminon ose redukton në mënyrë të konsiderueshme një mospërputhje kontabël që do të lindte përndryshe.

Shënimi 9 përcakton shumat dhe përshkrimet e aktiveve financiare të cilat janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

(viii) Marrëveshjet e huadhënies së letrave me vlerë

Investimet e dhëna hua nën marrëveshjet e huadhënies së letrave me vlerë raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar dhe vlerësohen në përputhje me politikat kontabël për aktivet e mbajtura për tregtim dhe aktivet e vlefshme për shitje. Investimet e dhëna hua nën marrëveshjet e huadhënies vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Banka merr para ose letra me vlerë si kolateral për këto huadhënie. Të ardhurat që rrjedhin nga këto marrëveshje raportohen si të ardhura nga interesi.

h. Paraja në qarkullim

Paraja në qarkullim është paraqitur si detyrim vendas, duke zbritur vlerën nominale të kartëmonedhave dhe monedhave në arkë nga vlera nominale e të gjitha kartëmonedhave dhe monedhave ekzistuese të emetuara.

i. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe aktive financiare shumë likuide me kohëzgjatje fillestare deri në tre muaj nga data e blerjes, që janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimit në vlerën e drejtë, e që përdoren nga Banka për administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

j. Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme

Aktivet dhe detyrimet financiare të tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Banka ka kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë e një portofoli që përdoret për ruajtje pozicioni ose për përfitime afatshkurtra.

Aktivet dhe detyrimet financiare të tregtueshme, njihen fillimisht dhe mbahen më tej me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar, duke i njohur kostot e transaksionit në fitim ose humbje. Çdo ndryshim në vlerën e drejtë njihet në fitim ose humbje si pjesë e të ardhurave neto nga instrumentet e tregtueshme. Aktivet dhe detyrimet financiare të tregtueshme nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare.

Një informacion i përgjithshëm për instrumentet derivative, që përfshijnë kontratat derivative të së ardhmes, është dhënë në Shënimin 35 (d).

k. Derivatët e mbajtur për qëllime të menaxhimit të rrezikut

Derivatët e mbajtur për qëllime të menaxhimit të rrezikut përfshijnë të gjitha aktivet dhe detyrimet derivative të cilat nuk janë të klasifikuara si aktive ose detyrime të tregtueshme. Derivatët e mbajtur për qillime të menaxhimit të rrezikut maten me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Nëse një derivativ nuk është i mbajtur për tregtim, dhe nuk është i përcaktuar në një marrëdhënie mbrojtëse të kualifikuar, atëherë të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të tij njihen menjëherë fitim ose humbje.

Një informacion i përgjithshëm për instrumentet derivative, që përfshijnë kontratat derivative të së ardhmes, është dhënë në Shënimin 35 (d).

l. Investimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje

Letrat me vlerë maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit.

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo derivative të përcaktuara si të vlefshme për shitje ose nuk klasifikohen në asnjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Në këtë kategori përfshihen letrat me vlerë të borxhit. Pas njohjes fillestare, investimet e vlefshme për shitje maten me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga dividentët njihen në fitim ose humbje në çastin kur Bankës i lind e drejta mbi dividendin. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit të investimeve në letra të borxhit të vlefshme për shitje, njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje (shih g. (vii)).

Ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë, përveç humbjeve nga zhvlerësimi (shih g. (vii)), janë njohur në ATGJ dhe paraqiten në rezervën e rivlerësimit (me vlerë të drejtë) brenda kapitalit. Kur investimi shitet, fitimi apo humbja e akumuluar në kapital riklasifikohet në fitim ose humbje.

m. Investime të mbajtura për tregtim

Investimet e mbajtura për tregtim maten me vlerë e drejtë dhe ndryshimet e vlerës së drejtë njihen menjëherë në fitim ose humbje, ashtu si përshkruhet në g. (viii).

n. Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe paradhëniet janë aktive financiare joderivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë të kuotuara në një treg aktiv dhe për të cilat Banka nuk ka objektiv shitjeje në të ardhmen e afërt. Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe kreditë për punonjësit janë klasifikuar si hua dhe llogari të arkëtueshme.

Kreditë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus shtesat në kostot direkte të transaksionit, për t'u vlerësuar më pas me koston e amortizuar sipas metodës së interesit efektiv.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm me të) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (marrëveshje e anasjellë e riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie, dhe aktivi nuk njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

o. Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në marrëveshje për ta riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të caktuar ("repo"), marrëveshja regjistrohet si depozitë dhe aktivi vazhdon të jetë i regjistruar në pasqyrat financiare të Bankës.

Marrëveshjet e anasjella të riblerjes regjistrohen si "Hua për bankat rezidente", ndërsa marrëveshjet e riblerjes regjistrohen si "Detyrime ndaj Bankave rezidente". Bazuar mbi rregulloren e Bankës mbi marrëveshjet e riblerjes, Bankës nuk i kërkohet të vendosë garanci për këto letra me vlerë.

Interesi i fituar mbi marrëveshjet e anasjella të riblerjes dhe interesi i shkaktuar nga marrëveshjet e riblerjes njihen si të ardhura ose shpenzime nga interesi gjatë jetëgjatësisë së çdo marrëveshjeje, duke përdorur normën bazë të interesit të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

p. Hua nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Huatë e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë nga FMN-ja merren nëpërmjet Bankës dhe paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Huatë

nga FMN-ja shprehen në SDR (*Special Drawing Rights*).

q. Ari dhe metalet e tjera të çmuara

Ari dhe metalet e tjera të çmuara mbahen me vlerë të drejtë, duke u bazuar në çmimin e Tregut të Arit në Londër (*London Bullion Market*), në datën e raportimit. Ky vlerësim është në përputhje me politikat e brendshme të Bankës.

r. Aktivet e qëndrueshme

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme vlerësohen me koston minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi, përveç tokës dhe ndërtesave, të cilat paraqiten me shumën e rivlerësuar që përllogaritet duke përdorur metodën e kostos së zëvendësimit.

Çdo rritje nga rivlerësimi, e ardhur nga rivlerësimi i tokës dhe ndërtesave, kreditohet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse te rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme, përveç rastit kur kjo rritje anulon rënien nga vlerësimi i të njëjtit aktiv, të njohur më parë në fitim ose humbje, rast ky kur rritja nga rivlerësimi njihet direkt në fitim ose humbje deri në masën e rënies së njohur paraprakisht. Çdo rënie në vlerën kontabël të mbetur të terrenit dhe ndërtesave, të cilat rezultojnë nga procesi i rivlerësimit, njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes deri në masën e balancës së njohur në rezervën e rivlerësimit, rezultuar nga rivlerësimi i mëparshëm i aktiveve. Rezerva e rivlerësimit transferohet në mënyrë të drejtpërdrejtë tek fitimet e pashpërndara gjatë përdorimit të aktivit. Kostot e aktivit përfshijnë dhe shpenzime që lidhen direkt me blerjen e tij.

(ii) Kostot e mëvonshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një aktivi të qëndrueshëm regjistrohet me vlerën e mbartur të këtij aktivi, nëse është e mundur që Banka të marrë përfitime të ardhshme ekonomike nga ky aktiv dhe që kostoja e zëvendësimit të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar ç'regjistrohet. Kostot e mirëmbajtjes ditore të aktiveve të qëndrueshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje sipas metodës lineare, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të çdo pjese përbërëse të aktivit të qëndrueshëm. Toka dhe ndërtimet në proces nuk zhvlerësohen.

Vlerësimi i jetës së dobishme për periudhën aktuale dhe atë krahasimore është si më poshtë:

- ndërtesa, Zyrat Qendrore 40 vjet;
- Ndërtesa, degët 25 vjet;

- Mjete transporti 5 - 10 vjet;
- Pajisje të përgjithshme e të tjera 3 - 20 vjet.

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.

s. *Aktivet e patrupëzuara*

Aktivet e patrupëzuara njihen nëse është e mundur që përfitimet ekonomike që i atribuohen aktivit në të ardhmen do t'i përkasin Bankës dhe kostoja e aktivit mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Aktivet e patrupëzuara përbëhen nga kostot e shtypjes dhe prerjes së parasë, si dhe programet kompjuterike.

(i) *Kosto të shtypjes dhe prerjes së parasë*

Kartëmonedhat e sapo shtypura dhe monedhat të cilat nuk janë vënë në qarkullim, njihen si aktive me kosto të blerjes dhe klasifikohen si kartëmonedha dhe monedha stok. Kostot e shtypjes së kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave amortizohen respektivisht me 2.5 vjet dhe 10 vjet, që nga data e njohjes së tyre.

(ii) *Programet kompjuterike*

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej përdorimit të këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes, bazuar në metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme të programit, prej datës kur është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është vlerësuar 2 vjet.

t. *Përfitimet e punonjësve*

(i) *Plan pensioni me kontribute të përcaktuara*

Detyrimet për kontributet e Bankës ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzime për personelin në fitim ose humbje, kur ato ndodhin. Planet e pensionit me kontribute të përcaktuara përfshijnë planet e pensionit me kontribute vullnetare dhe të detyrueshme.

Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri, sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensionet.

(ii) Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës njihen si shpenzime, kur Banka është angazhuar në mënyrë të dukshme, pa mundësi reale për t'u tërhequr, të zbatojë një plan formal të detajuar për të ndërprerë punësimin para datës së daljes në pension, ose të ofrojë përfitime për të paguar në rastin e largimit vullnetar të punonjësve. Përfitime të ofruara për largimin vullnetar do të regjistrohen vetëm atëherë kur Banka ka bërë një ofertë për largimin vullnetar, kur është e mundshme që kjo ofertë do të pranohet dhe numri pranimeve mund të matet në mënyrë të besueshme.

(iii) Përfitime afatshkurtra

Detyrimet për përfitime afatshkurtra maten në baza të paskontuara dhe njihen si shpenzim në periudhën kur ofrohet shërbimi. Për shumën që pritet të paguhet në lidhje me bonuset afatshkurtra në para, regjistrohet një provigjon, nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë, si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi dhe kur ky detyrim mund të matet në mënyrë të besueshme.

u. Qiratë operative

Pagesat e bëra nën qiratë operative njihen si fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë afatit të qirasë. Incentivat e qerasë njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë jetëgjatësisë së saj.

v. Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Bankës rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e larta mes vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë, minus kostot e shitjes. Në matjen e vlerës në përdorim skontohen flukset e ardhshme monetare në vlerën e tyre aktuale, duke përdorur një normë interesi e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet nga zhvlerësimi, të njohura në periudhat e mëparshme, vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

x. *Provigjonet*

Provigjoni njihet si i tillë nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që të kërkohet një dalje e përfitimeve ekonomike për të shlyer këtë detyrim. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare të ardhshme me një normë që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, si dhe rreziqet specifike të detyrimit. Shlyerja e detyrimit të skontuar njihet si kosto financiare.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 35).

Banka bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve për vitin e ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme, të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

(i) Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit: zhvlerësimi i instrumenteve financiare

Aktivet e regjistruara me kosto të amortizuar dhe asetet e vlefshme për shitje vlerësohen për zhvlerësim, sipas bazë së përshkruar në politikën kontabël 3.g. (vii).

Përbërësit specifikë të kundërpartisë për totalin e provigjoneve për zhvlerësim aplikohen ndaj aktiveve financiare të vlerësuara individualisht dhe bazohen në vlerësimin më të mirë të menaxhimit për vlerën aktuale të flukseve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto flukse të parasë, drejtimi i Bankës gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë kolaterali të vendosur. Çdo aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e flukseve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavarur.

(ii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare, të cilat tregtohen në tregje aktive, bazohet në çmimet e kuotuara të tregut ose në çmimet e ndërmjetësit. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare, Banka përcakton vlerën e drejtë, duke përdorur teknika të tjera vlerësimi.

Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë pak transparencë çmimesh, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve rreth çmimit dhe rreziqeve të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik.

(a) Modelet e vlerësimit

Banka mat vlerën e drejtë, duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerësimit të vlerës së drejtë, e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

- Niveli 1: të dhëna që janë çmime tregu të kuotuara (të parregulluara) në tregje aktive për instrumente identike.
- Niveli 2: të dhëna të tjera përveç çmimeve të kuotuara të përfshira në Nivelin 1, që janë të vrojtueshme qoftë drejtpërdrejt (p.sh. si çmimet) ose tërthorazi (p.sh. rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuara në tregje aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuara për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vrojtueshme nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: të dhëna që nuk janë të vrojtueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet për të cilat teknika e vlerësimit përfshin të dhëna që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe këto të dhëna jo të vëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuara për instrumente të ngjashme për të cilat kërkohen rregullime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të vrojtueshme dhe modele të tjera vlerësimi. Supozimet dhe të dhënat e përdorura në metodat e vlerësimit përfshijnë normat pa rrezik dhe treguesë referencë interesi, marzhet e kreditit dhe prime të tjera të përdorura në llogaritjen e normave të skontuara, çmimet e obligacioneve dhe aksioneve, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, çmimet e kapitalit dhe të treguesve të kapitalit dhe luhatjen e pritshme të çmimeve dhe korrelacionet.

Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijë në një përcaktim të vlerës së drejtë, e cila reflekton çmimin e instrumentit financiar që do të ishte marre nga shitja e një aktivi ose paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt, ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e raportimit.

Banka përdor metoda gjerësisht të njohura të vlerësimit për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve të thjeshta financiare, të tilla si kontratat e shkëmbimit të monedhave të huaja dhe të normave të interesit, të cilat përdorin vetëm të dhëna të vrojtueshme në treg dhe që kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim. Çmimet e vrojtueshme dhe të dhënat e modeleve janë të disponueshme në bursat e letrave me vlerë të borxhit dhe të letrave me vlerë të kapitalit. Disponibiliteti i çmimeve të vrojtueshme të tregut zvogëlon nevojën për gjykim dhe vlerësim nga drejtimi i Bankës, dhe ul pasigurinë e lidhur me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponibiliteti i çmimeve të tregut dhe të dhënave te vrojtueshme, varion sipas produkteve dhe tregjeve dhe

ndikohet prej ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

Vlerësimet e vlerës së drejtë të përftuara nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë, siç janë rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Banka beson që një pjesëmarrës i tretë në treg do t'i marrë ato parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kredisë së instrumentit dhe përfshin rregullime për të marrë parasysh rrezikun e kredisë të Bankës dhe të kundërpalës kur është e përshtatshme.

Të dhënat e modeleve dhe vlerat kalibrohen përkundrejt të dhënave historike dhe parashikimeve të publikuara dhe kur është e mundur përkundrejt transaksioneve korrente apo të fundit të vëzhguara në instrumente të ndryshme dhe përkundrejt kuotimeve të ndërmjetësuesve. Ky proces kalibrimi është shumë subjektiv dhe jep një bashkësi zgjedhjesh të të dhënave të mundshme dhe të vlerësimeve të vlerës së drejtë, dhe gjykimi i menaxhimit është i nevojshëm për të zgjedhur pikën më të përshtatshme në këtë bashkësi.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive është bazuar në çmimet e kuotuara të tregut ose të çmimeve të kuotuar nga tregtarët. Për të gjithë instrumentet e tjera financiare, Banka përcakton vlerën e drejtë, duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të vrojtueshëm dhe modele të tjera të vlerësimit. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijë në një përcaktim të vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e raportimit.

Banka përdor modele vlerësimi gjerësisht të njohura për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare, të zakonshme e të thjeshtë, që përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim. Çmimet e vëzhgueshme dhe treguesit e modeleve janë zakonisht të disponueshëm në treg për letrat me vlerë të listuara, për derivativët e kursit të këmbimit, si dhe për kontratat e së ardhmes së normave të interesit dhe derivativë të thjeshtë mbi banak. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe treguesve të modeleve ul nevojën për gjykim dhe vlerësim dhe gjithashtu redukton pasigurinë që shoqëron përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të vrojtueshme të tregut dhe të dhënave varion sipas produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur që të ndryshojë në bazë të ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

(b) Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë - hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme analizon instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë në datën e raportimit, sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilën matja me vlerën e drejtë është e kategorizuar. Këto vlera janë njohur në pasqyrën e pozicionit financiar.

31 dhjetor 2014	Totali i vlerës së drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Aktive në monedhë të huaj				
Ari dhe metale të çmuara	9,569	9,569	-	-
Investime të vlefshme për shitje	242,419	232,056	10,363	-
Investime të mbajtura për tregtim	14,378	14,378	-	-
Aktive vendase				
Investime të vlefshme për shitje	63,948	-	63,948	-

31 dhjetor 2013	Totali i vlerës së drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Aktive në monedhë të huaj				
Ari dhe metale të çmuara	8,474	8,474	-	-
Investime të vlefshme për shitje	230,588	229,186	1,402	-
Investime të mbajtura për tregtim	12,591	12,591	-	-
Aktive vendase				
Investime të vlefshme për shitje	63,920	-	63,920	-

Informacioni mbi çmimet e kuotuara të tregut është marrë nga dy burime: Merrill Lynch dhe Bloomberg.

(c) Instrumentet financiare që nuk maten me vlerë të drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerën e drejtë të disa instrumenteve financiare që nuk maten me vlerë të drejtë sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilën çdo matje me vlerën e drejtë kategorizohet.

	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 2
	2014	2014	2013	2013
Aktivet financiare				
Aktive në monedhë të huaj				
Llogari me Fondin Monetar Ndërkombëtar	21,792	21,792	20,220	20,220
Depozita në bankat jorezidente	30,003	30,003	21,661	21,661
Aktive vendase				
Kredi ndaj bankave rezidente	25,548	25,548	21,502	21,502
Të drejta ndaj Qeverisë Shqiptare	7,398	7,398	-	-
Detyrimet financiare				
Detyrime në monedhë të huaj				
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	25,330	25,330	18,633	18,633
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	1,255	1,255	1,256	1,256
Detyrime vendase				
Detyrime ndaj bankave rezidente	106,311	106,311	100,031	100,031
Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare	17,578	17,578	23,779	23,779

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe huave është e bazuar në transaksionet në një treg të vëzhgueshëm. Kur të tilla transaksione nuk janë të disponueshme, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur modele vlerësimi, të tilla si teknikat e zbritjes së flukseve monetare, duke aplikuar normat që janë ofruar për instrumente të maturiteteve dhe kushteve të ngjashme.
Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma për t'u paguar në datën e raportimit.

5. ARI DHE METALE TË ÇMUARA

	2014	2013
Ari – jorezident	9,569	8,474
Ari dhe metale të çmuara - vendase	4,483	4,021
Totali	14,052	12,495

Më 31 dhjetor 2014, vlera e arit të Bankës, të vendosur në depozita dhe llogari rrjedhëse në bankat jashtë vendit, e përfshirë në aktivet në monedha të huaja ishte 9,569 milionë lekë (2013: 8,474 milionë lekë).

Më 31 dhjetor 2014, vlera e arit në vend ishte 4,483 milionë lekë (2013: 4,021 milionë Lekë) ku përfshihen gjendjet jomonetare të arit, platinit dhe të argjendit të mbajtura në arkat vendase.

Rritja vjetore në total prej 1,557 milionë lekësh (2013: rënie prej 5,506 milionë lekë), që rezulton nga riçmimi i arit dhe metaleve të çmuara (shiko 3.q.) në datën e raportimit, dhe rivlerësimi i metaleve të tjera të çmuara është njohur fillimisht në fitim ose humbje e më pas është transferuar në rezervën e rivlerësimit.

6. LLOGARI ME/DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR (FMN)

Gjendja e aktiveve dhe detyrimeve lidhur me anëtarësinë në Fondin Monetar Ndërkombëtar është si më poshtë:

	2014	2013
Llogari me Fondin Monetar Ndërkombëtar		
Kuota në FMN	9,485	9,712
Të drejta speciale të tërheqjes ("SDR") të mbajtura	12,306	10,506
Interes i përllogaritur	1	2
Totali i aktiveve	21,792	20,220
	2014	2013
Detyrime ndaj FMN		
Shpërndarje e SDR-ve	7,752	7,286
Llogaria e letrave me vlerë të FMN	14,221	7,286
FMN llogaria Nr.1	2,301	2,379
FMN llogaria Nr.2	1	1
Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit ("PRGF")	1,054	1,678
Interes i përllogaritur	1	3
Totali i detyrimeve	25,330	18,633

Kuotat në FMN, prej 9,485 milionë lekësh ose 60 milionë SDR-sh (2013: 9,712 milionë lekë ose 60 milionë SDR) rezultojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në FMN, në përputhje me Ligjin nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997, "Për Bankën e Shqipërisë".

Të drejtat speciale të tërheqjes në shumën prej 12,306 milionë lekësh ose 74 milionë SDR (2013: 10,506 milionë lekë ose 67 milionë SDR) përfaqësojnë depozita të vendosura me FMN. Këto të drejta përfaqësojnë shumat e fituara përmes shpërndarjes së SDR-ve. Të drejtat speciale të tërheqjes sjellin interes, i cili përcaktohet në baza javore. Në 31 dhjetor 2014 norma vjetore e interesit ishte 0.05% (2013: 0.13% në vit).

Shpërndarjet e SDR-ve prej 7,752 milionë lekë ose SDR 46 milionë (2013: 7,286 milionë Llekë ose SDR 46 milionë) përfaqësojnë shuma të huazuara nga FMN-ja, qëllimi i të cilave është të sigurojnë një përgjigje të menjëhershme ndaj nevojave afatshkurtra dhe afatgjata për likuiditet të vendeve anëtare.

Llogaritë e FMN-së përfaqësojnë detyrime përkundrejt pjesëmarrjes së Shqipërisë në FMN që nuk mbartin interes. Këto llogari nuk kanë maturitet të përcaktuar. FMN-ja paguan remunerim për anëtarët, sipas transhit të rezervës së remunerimit, me 0.05% në vit (2013: 0.13% në vit). Pozicioni i transhit të rezervës llogaritet si diferencë ndërmjet kuotave në FMN dhe gjendjes së llogarive të FMN-së, duke përjashtuar mbajtjet e ardhura si rezultat i përdorimit të kredive të akorduara nga FMN-ja dhe mbajtjet në llogarinë nr. 2, si më poshtë:

	2014		2013	
Në milionë:	Lekë	SDR	Lekë	SDR
Kuotat në FMN	9,485	60	9,712	60
Zbritje për mbajtjet e monedhave nga FMN:				
Llogaria e letrave me vlerë tek FMN	(14,221)	(90)	(7,286)	(45)
FMN llogaria nr.1	(2,301)	(15)	(2,379)	(15)
FMN llogaria nr.2	(1)	-	(1)	-
Përjashtuar: FMN llogaria nr.2 plus mbajtjet ardhur si rezultat i përdorimit të fondeve të kredisë	8,069	51	923	6
	(8,454)	(54)	(8,743)	(54)
Transhi i rezervës mbajtur me FMN	1,031	6	969	6

E përfshirë në llogaritë e letrave me vlerë të FMN-së është dhe huaja "Lehtësia e Financimit Afatmesëm" (EFF):

	2014		2013	
Në milionë:	LEK	SDR	LEK	SDR
EFF: disbursimet në 2014	7,398	47	-	-
EFF: disbursimet në 2006 - 2009	600	4	922	6
	8,068	51	922	6

Në vitin 2014, FMN ka disbursuar dy transhe si pjesë e programit të miratuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtare në favor të Shqipërisë. Huaja do të ripaguhet për një periudhë 3-vjeçare. Banka ka marrë nota premtimi në shumën 7,398 milionë lekë, të lëshuara nga Qeveria Shqiptare në favor të FMN-së, në lidhje më këtë kredi (shiko shënimin 12).

Huatë EFF janë disbursuar dhe gjatë periudhës 2006 deri më 2009. Principali i huasë ka filluar të shlyhet pas katër vjetësh e gjysmë nga disbursimi, dhe do të paguhet brenda 10 vitesh. Interesi i këtyre kredive është i ndryshueshëm dhe paguhet çdo tre muaj. Më 31 dhjetor 2014, interesi ishte 1.05 % në vit (2013: 1.12%).

Huaja PRGF në shumën prej 1,054 milionë lekësh ose 6 milionë SDR (2013: 1,678 milionë lekë ose 11 milionë SDR) është dhënë në favor të Qeverisë për reformat makroekonomike. Këto huamarrje konsistojnë në komponentët e mëposhtëm:

	2014		2013	
Në milionë:	LEK	SDR	LEK	SDR
Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 3	200	1	628	4
Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 4	854	5	1,050	7
	1,054	6	1,678	11

Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 3 u miratua me marrëveshjen e datës 21 qershor 2002 dhe ka një normë interesi vjetore prej 0.5%.

Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 4 u miratua me marrëveshjen e datës 27 janar 2006 dhe ka një normë interesi vjetore prej 0.5%. Pas një periudhe të lirë prej pesë vjetsh e gjysmë huaja nis të paguhet me 10 këste të njëjta gjashtëmujore.

7. DEPOZITA NË BANKAT JOREZIDENTE

	2014	2013
Llogari rrjedhëse	12,231	13,313
Depozita afatshkurtra	17,751	8,315
Kontrata të së ardhmes	17	31
Interes i përllogaritur	4	2
Totali	30,003	21,661

Normat vjetore të interesit për çdo monedhë për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra, më 31 dhjetor 2014, janë si më poshtë:

- EUR: 0.03% - 0.07% (2013: 0.01% - 0.19%)
- GBP: 0.52% (2013: 0.91% - 0.35%)
- USD: 0.09% (2013: 0.01%)

8. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE (NË MONEDHË TË HUAJ)

	2014	2013
Nota thesari të qeverive të huaja	156,192	169,262
Bono thesari të qeverive të huaja	6,678	3,502
Letra me vlerë afatgjata të agjencive dhe korporatave	67,584	55,723
Letra me vlerë afatshkurtra të agjencive dhe korporatave	11,965	2,101
Totali	242,419	230,588

Normat vjetore të interesit për çdo monedhë më 31 dhjetor 2014 dhe 2013, janë si më poshtë:

2014: Në përqidje	USD	GBP	JPY	EUR
Nota thesari të qeverive të huaja	0.07-3.93	0.31-1.55	(0.02)-0.03	(0.10)-3.62
Bono thesari të qeverive të huaja	-	-	-	(0.07)-0.47
Letra me vlerë afatgjata të agjencive dhe korporatave	0.25-1.81	0.45-1.07	-	(0.02)-0.54
Letra me vlerë afatshkurtra të agjencive dhe korporatave	-	-	-	0.03-0.28

Si rrjedhojë e lehtësimit të mëtejshëm të politikës monetare nga disa banka qendrore gjatë vitit 2014, normat e kthimit për një pjesë të instrumenteve të portofolit në EUR dhe JPY, më 31 dhjetor 2014, janë negative. Këto instrumente përfaqësojnë kryesisht emetime thesari të qeverive të Eurozonës me cilësi të lartë krediti, si ato të qeverive të Gjermanisë dhe Francës për afate maturimi deri në 5 vjet dhe 3 vjet përkatësisht.

2013: Në përqindje	USD	GBP	JPY	EUR
Nota thesari të qeverive të huaja	0.08-5.57	0.33-3.02	0.08-0.10	0.11-4.59
Bono thesari të qeverive të huaja	-	-	-	0.09-0.54
Letra me vlerë afatgjata të agjencive dhe korporatave	0.23-1.74	0.55-1.69	-	0.17-2.13
Letra me vlerë afatshkurtra të agjencive dhe korporatave	-	-	-	0.25-0.42

9. INVESTIME TË MBAJTURA PËR TREGTIM (NË MONEDHË TË HUAJ)

	2014	2013
Nota thesari të qeverive të huaja	10,556	7,685
Letra me vlerë të agjencive dhe korporatave	3,822	4,906
Totali	14,378	12,591

Investimet e mbajtura për tregtim administrohen nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), në kuadër të marrëveshjes së Bankës së Shqipërisë me IBRD "Për administrimin dhe asistencën teknike mbi investimin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë" (Program Menaxhimi për Rezerva dhe Këshillim), të lidhur më datë 23 shtator 2005. Investimet në këtë portofol mbahen në monedhën USD.

Normat vjetore të interesit më 31 dhjetor 2014 dhe 2015, janë si më poshtë:

Në përqindje	2014	2013
Nota thesari të qeverive të huaja	0.25-2.75	0.12-2.75
Letra me vlerë të agjencive dhe korporatave	0.37-2.00	0.37-2.00

Letrat me vlerë të agjencive dhe korporatave kanë norma interesi fikse dhe të ndryshueshme.

10. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË TË HUAJ)

	2014	2013
Kuotizacione në institucionet ndërkombëtare		
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)	365	361
Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA)	13	12
Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA)	7	6
Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)	85	75
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)	67	60
Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)	27	23
Totali i kuotizacioneve	564	537
Llogari me IBRD	196	-
Arka në valutë	19	40
Totali aktiveve të tjera në monedhë të huaj	779	577

Kuotat në institucionet financiare ndërkombëtare përfaqësojnë kuotat e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në këto institucione (shiko shënimin 32.(i)).

Llogaria me IBRD përfaqëson llogaritë e arkëtueshme që vijnë nga shitja e letrave me vlerë të tregtimit (shiko shënimin 9).

11 KREDI NDAJ BANKAVE VENDASE

	2014	2013
Marrëveshjet e anasjella të riblerjes	25,548	21,132
Kredi njëditore	-	370
Total	25,548	21,502

Më 31 dhjetor 2014, marrëveshjet e anasjella të riblerjes ndërmjet Bankës dhe bankave tregtare kanë një maturitet origjinal që varion nga një javë në tre muaj (2013: nga një javë në tre muaj) dhe normat vjetore të interesit të marrëveshjeve të anasjella të riblerjes variojnë nga 2.25%, në 2.58% (2013: 3.00% në 3.29%).

12. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE (VENDASE)

	2014	2013
Bono thesari afatshkurtër të Qeverisë Shqiptare	63,948	63,920
Totali	63,948	63,920

Më 31 dhjetor 2014, investimet e vlefshme për shitje në monedhë vendase, përfaqësohen nga bono thesari të Qeverisë Shqiptare me kupon zero, me afat maturimi nga 3 muaj deri në 12 muaj (2013: nga 3 muaj deri në 12 muaj). Normat e tyre të kthimit në blerje variojnë nga 3.08% në 3.83% (2013: 3.27% në 6.60%).

13. TË DREJTA NDAJ QEVERISË SHQIPTARE (VENDASE)

Të drejtat ndaj Qeverisë Shqiptare në shumën 7,398 milionë lekë përfaqësojnë nota të premtimit në lekë, pa interes dhe jo të negociueshme, që emetohen nga Ministria e Financave në favor të FMN-së, në zbatim të nenit nr.2 të Memorandumit të Mirëkuptimit, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë për huatë, marrë nga FMN-ja gjatë vitit 2014.

14. AKTIVE TË TJERA (VENDASE)

	2014	2013
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, neto	10,381	9,546
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, neto	545	500
Kredi për punonjësit	1,730	1,822
Debitorë të tjerë	-	151
Numizmatika	264	264
Inventari	53	58
Të tjera	36	47
Totali	13,009	12,388

Më 31 dhjetor 2014, kreditë e punonjësve paraqiten neto nga provigjonet për çështje gjyqësore që lidhen me to, në masën 8 milionë lekë (2013: 9 milionë lekë). Më 31 dhjetor 2014, vlera e regjistruar e kolateralit për kreditë afatgjata dhënë punonjësve të Bankës arrin shumën 2,247 milionë Lekë (2013: 2,295 milionë lekë). Vlera e angazhimeve të kredive ende të padisbursuara në favor të punonjësve është 60 milionë lekë (2013: 79 milionë lekë).

Më 31 dhjetor 2013, debitorë të tjerë përfshin shuma të bllokuara nga një bankë tregtare prej 151 milionë lekësh lidhur me një letërkredi të çelur sipas kushteve të kontratës me palët e treta, për printimin e kartëmonedhave. Më 31 dhjetor 2014, nuk ka shuma të tilla të bllokuara.

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për çdo kategori, më 31 dhjetor 2014 dhe 2013, paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa, konstruksione të përgjithshme	Pajisje të përgjithshme	Mjete transporti	Aktive të tjera	Ndërtime në proces	Total
Kosto/Vlerësimi						
Gjendja më 1 janar 2013	6,659	1,891	191	-	1,499	10,240
Shtesa	26	219	84	-	749	1,078
Gjendja më 31 dhjetor 2013	6,685	2,110	275	-	2,248	11,318
Shtesa	-	374	-	15	968	1,357
Transferime	402	-	-	-	(402)	-
Riklasifikime	-	(13)	-	1	-	(12)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	7,087	2,471	275	16	2,814	12,663
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2013	346	1,017	165	-	-	1,528
Amortizimi i vitit	59	177	8	-	-	244
Gjendja më 31 dhjetor 2013	405	1,194	173	-	-	1,772
Amortizimi i vitit	110	281	15	1	-	407
Sistemime nga vitet e kaluara	41	71	-	-	-	112
Riklasifikime	-	(9)	-	-	-	(9)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	556	1,537	188	1	-	2,282
Vlera kontabël neto						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	6,531	934	87	15	2,814	10,381
Gjendja më 31 dhjetor 2013	6,280	916	102	-	2,248	9,546
Gjendja më 31 dhjetor 2012	6,313	874	26	-	1,499	8,712

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara për çdo kategori, më 31 dhjetor 2014 dhe 2013, paraqitet si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Bankënota të prera dhe monedha të shtypura	Punime në proces	Totali i aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2013	404	3,147	-	3,551
Shtesa	52	515	-	567
Gjendja më 31 dhjetor 2013	456	3,662	-	4,118
Shtesa	27	241	43	311
Riklasifikime	12	-	-	12
Gjendja më 31 dhjetor 2014	495	3,903	43	4,441
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2013	396	3,096	-	3,492
Amortizimi i vitit	19	107	-	126
Gjendja më 31 dhjetor 2013	415	3,203	-	3,618
Amortizimi i vitit	37	232	-	269
Riklasifikime	9	-	-	9
Gjendja më 31 dhjetor 2014	461	3,435	-	3,896
Vlera kontabël neto				
Gjendja më 31 dhjetor 2014	34	468	43	545
Gjendja më 31 dhjetor 2013	41	459	-	500
Gjendja më 31 dhjetor 2012	8	51	-	59

15. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOREZIDENTE

	2014	2013
Hua ndaj Republikës së Greqisë	1,234	1,234
Detyrime ndaj institucioneve ndërkombëtare	16	17
Interes i përllogaritur	5	5
Totali	1,255	1,256

Huaja e Republikës së Greqisë prej 1,234 milionë lekë ose 8.8 milionë euro (2013: 1,234 milionë lekë ose 8.8 milionë euro) është dhënë me qëllim financimin e bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma vjetore e interesit është fikse në 1.17%, e pagueshme çdo gjashtëmujor, ndërsa principali i huasë paguhet me një shumë të vetme në datën e maturimit, në vitin 2018.

Detyrimet ndaj institucioneve ndërkombëtare përfaqësojnë shuma të pagueshme ndaj IBRD, IDA dhe MIGA.

16. DETYRIME TË TJERA TË HUAJA

Në detyrime të tjera të huaja me vlerë 230 milionë lekë (2013: zero) përfshihen shuma të pagueshme për blerje të letrave me vlerë të administruara nga IBRD.

17. PARA NË QARKULLIM

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës shqiptare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka.

Më 31 dhjetor 2014 dhe 2013, gjendja e kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim është si më poshtë:

	31 dhjetor 2014		31 dhjetor 2013	
Vlera Nominale - lekë	Numri në mijë	Totali lekë (milionë)	Numri në mijë	Totali lekë (milionë)
Kartëmonedha:				
100	3,410	341	15,843	1,584
200	11,064	2,213	10,210	2,042
500	22,486	11,243	24,663	12,331
1,000	47,168	47,168	52,643	52,643
2,000	23,565	47,130	20,285	40,570
5,000	22,960	114,801	19,289	96,445
Monedha		3,511		2,151
		226,407		207,766

18. DETYRIME NDAJ BANKAVE REZIDENTE

	2014	2013
Në monedhë të huaj		
Rezerva e detyrueshme dhe llogaritë rrjedhëse	49,167	55,355
Në monedhë vendase (Lekë)		
Rezerva e detyrueshme dhe llogaritë rrjedhëse	38,978	32,070
Rezerve e detyrueshme - paraja në kujdestari	11,155	12,589
Depozita ditore	7,000	-
Interes i përllogaritur	11	17
Totali	106,311	100,031

Në përputhje me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 39, datë 25 qershor 2014, rezerva e detyrueshme në valutë më 31 dhjetor 2014 nuk remunerohet, ndërsa rezerva në monedhën vendase remunerohet me 1.575% (2013: 2.45%) dhe llogaritet si 70% e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe atyre të anasjella të riblerjes. Sipas vendimit nr. 46, datë 26 nëntor 2014, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, norma e marrëveshjeve të riblerjes dhe atyre të anasjella të riblerjes u ul nga 2.5% në 2.25%.

Sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 16 maj 2012, "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat", Banka lejon bankat tregtare të mbajnë rezervën e detyrueshme edhe në formën e parasë në kujdestari. Më 31 dhjetor 2014, paraja në kujdestari rezulton në 11,155 milionë lekë (2013: 12,589 milionë lekë).

Depozitat njëditore në shumën 7,000 milionë lekë (2013: zero) kanë një normë interesi prej 0.5 % në vit.

19. DETYRIME NDAJ QEVERISË SHQIPTARE

	2014	2013
Fitim për t'iu shpërndarë Qeverisë	951	1,351
Depozita në emër të Qeverisë	16,600	22,404
Të tjera	27	24
Totali	17,578	23,779

Depozitat në emër të Qeverisë janë si më poshtë:

	2014	2013
Llogaria kryesore në lekë	6,548	12,566
Llogari kryesore në valutë	2,171	1,656
Të tjera	7,881	8,182
Totali	16,600	22,404

Banka e Shqipërisë nuk paguan interes për llogaritë e mbajtura në emër të Qeverisë Shqiptare me përjashtim të një depozite garancie në shumën 500 milionë lekë, bazuar në marrëveshjen ndërmjet Bankës dhe Ministrisë së Financave, për të cilën norma e remunerimit bazohet në vendime të Këshillit Mbikëqyrës.

20. DETYRIME TË TJERA VENDASE

	2014	2013
Depozita të individëve nga pjesëmarrja në bono thesari	1,009	725
Detyrimi ndaj fondit të pensionit	15	14
Detyrim ndaj institucioneve financiare jobankare	124	208
Detyrime të tjera	678	599
Totali	1,826	1,546

Detyrime të tjera prej 678 milionë lekë (2013: 599 milionë lekë), përfshin kryesisht shpenzime të llogaritura, të cilat lidhen me shërbime të kryera ndaj Bankës, si dhe provigjone për pretendime e për disa çështje ligjore krijuar në kushte normale biznesi. Gjatë vitit 2014, lëvizjet në provigjon janë si më poshtë:

	2014	2013
Gjendja më 1 janar	193	181
Provigjon shtesë për periudhën	3	13
Rimarrje dhe pagesa gjatë periudhës	(126)	(1)
Gjendja më 31 dhjetor	70	193

Detyrimi ndaj fondit të pensionit lidhet me fondin e pensionit që bazohet në kontributin e punonjësve, si dhe në kontributin e punëdhënësit. Mbështetur në vendimin Nr. 17, datë 26 shkurt 2014, të Këshillit Mbikëqyrës, fondi i pensionit raporton pozicionin e tij financiar më vete nga ai i Bankës së Shqipërisë.

21. REZERVAT E RIVLERËSIMIT

	2014	2013
Rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit	20,766	10,288
Rivlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje	1,305	302
Zhvlerësime të tjera	(141)	(169)
Totali	21,929	10,421

Më 31 dhjetor 2014, rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit nga luhatja e kursit të këmbimit rezulton me fitim neto prej 10,478 milionë lekësh (2013: humbje neto prej 9,660 milionë lekësh). Fitimi/humbja neto që rezulton nga rivlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj, fillimisht njihet në fitim ose humbje e më pas transferohet në rezerva të rivlerësimit nga kursi i këmbimit të monedhave dhe arit.

Vlera e drejtë e letrave me vlerë të vlefshme për shitje më 31 dhjetor 2014, u rrit me 1,003 milionë lekë (2013: ulje prej 754 milionë lekësh).

22. REZERVA TË TJERA

	2014	2013
Rezervë speciale për bilancin e pagesave	7,209	7,209
Rezerva në ar dhe metale të çmuara	7,042	7,042
Të tjera	1,497	1,509
Totali	15,748	15,760

Rezerva speciale për bilancin e pagesave ka të bëjë me grante të dhëna nga Komuniteti Evropian për Shqipërinë, si asistencë financiare për të mbështetur Shqipërinë në procesin e transformimit të ekonomisë në një ekonomi tregu. Këto fonde i përkasin periudhës 1992 – 1993, në mbështetje të qëndrueshmërisë së bilancit të pagesave, si dhe për të forcuar pozicionin e rezervave. Kjo rezervë ka mbetur e pandryshuar që nga viti 1995.

Rezerva në ar dhe metale të çmuara përfaqëson rezervën e krijuar bazuar në ligjin nr. 9862, datë 24 janar 2008, "Për transferimin e pronësisë së arit dhe metaleve të tjera të çmuara nga Këshilli i Ministrave tek Banka e Shqipërisë". "Të tjera" përfshijnë rezerva të krijuara nga shpërndarja e fitimit gjatë viteve 2004-2007, me vendime të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës në ato vite. Në 31 dhjetor 2013, "Rezervat të tjera" përfshinin edhe një shumë prej 12 milion lekësh, e cila u krijua bazuar në vendimin nr.530, datë 4 mars 2014, nga Këshilli Mbikëqyrës dhe u përdor në vitin 2014. Kjo rezervë lidhet me rregullimet e diferencave nga periudhat e kaluara, të kryera në vitin 2014, si rezultat i zbatimit të sistemit të ri informatik që mat instrumentet financiare sipas metodës së normës efektive të interesit.

23. TË ARDHURA NGA INTERESA DHE KOMISIONE (JOREZIDENTË)

	2014	2013
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	4,515	5,106
Interesa nga depozitat me afat	25	12
Interesa nga depozitat në SDR me FMN	11	9
Interesa nga huadhëniet e letrave me vlerë	16	13
Të tjera (skontime)	73	31
Totali	4,640	5,171

24. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (JOREZIDENTË)

	2014	2013
Amortizimi i primit të letrave me vlerë	3,387	4,080
Shpenzime për interesa nga huatë e institucioneve të huaja	15	15
Shpenzime për interesa nga llogaritë e FMN	15	16
Të tjera	40	47
Totali	3,457	4,158

25. TË ARDHURA NGA INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTË)

	2014	2013
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	2,319	3,611
Të ardhura nga marrëveshjet e anasjella të riblerjes	691	689
Të tjera	85	87
Totali	3,095	4,387

26. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTË)

	2014	2013
Shpenzime për interesa mbi rezervën e detyrueshme	784	870
Shpenzime për interesa mbi depozitat e Qeverisë	50	18
Të tjera	22	42
Totali	856	930

27. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO

	2014	2013
Fitim neto nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje	834	420
Fitimi neto nga kontratat forward	-	223
Të tjera	136	11
Totali	970	654

Për vitin 2014, fitimet neto nga kontratat forward janë kaluar në zërin të ardhura nga instrumente të tregtueshme, neto (shiko shënimin 28).

28. TË ARDHURA NGA LETRAT ME VLERË TË TREGTUESHME, NETO

	2014	2013
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë të tregtueshme	112	78
Fitim neto nga shitja e letrave me vlerë të tregtueshme	22	8
Humbje e parealizuar nga rivlerësimi	(21)	(30)
Fitimi neto nga kontratat e të ardhmes dhe forward	69	-
Totali	181	56

29. SHPENZIME PERSONELI

	2014	2013
Pagat e personelit	878	940
Kontribut për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore	88	83
Kontribut për fond pensioni	85	93
Totali	1,051	1,116

Më 31 dhjetor 2014, Banka punëson 500 punonjës (2013: 504 punonjës).

30. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzimet e tjera në vlerën 713 milionë lekë (2013: zero) përfaqësojnë humbjen nga përvetësimi i parave në arkë që u zbulua në korrik 2014. Kjo shumë është regjistruar si humbje bazuar në vendimin nr. 56, datë 1 tetor 2014 të Këshillit Mbikëqyrës.

31. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ

	2014	2013
Depozita në bankat e huaja (shënimi 7)	30,003	21,661
Para në monedhë vendase	28,593	47,233
Para në monedhë të huaj (shënimi 9)	19	40
Totali	58,615	68,934

32. ANGAZHIME DHE GARANCI

(i) Pjesëmarrja në institucionet financiare ndërkombëtare

Në vitet e shkuara, Republika e Shqipërisë është anëtarësuar me kuotizacione në një sërë institucionesh financiare ndërkombëtare, përfshirë këtu FMN, IBRD,

IDA, MIGA, IFC, EBRD dhe IDB. Siç detajohet në shënimin 10 "Aktive të tjera" (Në monedhë të huaj), shuma e akumuluar e kuotizacioneve të paguara nga Banka është 564 milionë lekë (2013: 537 milionë lekë). Për më tepër, siç tregohet në shënimin 6 dhe 13, Banka mban aktive që e kanë origjinën nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në FMN, ndërkohë që huatë e marra prej FMN-së nga Repulika e Shqipërisë merren nëpërmjet Bankës dhe shfaqen në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës.

Banka e Shqipërisë dhe Qeveria e Shqipërisë ende nuk kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi për ndarjen e kontributit origjinal dhe të pronësisë së kuotizacioneve tek institucionet financiare ndërkombëtare.

(ii) Marrëveshje të anasjella riblerjeje

Marrëveshjet e anasjella të riblerjes, më 31 dhjetor 2014, përfaqësojnë kredi të kolateralizuara (shënimi 11). Vlera nominale e letrave me vlerë të përdorura si kolateral, më 31 dhjetor 2014, ishte 28,635 milionë lekë (2013: 23,960 milionë Lekë).

(iii) Marrëveshjet e qirasë

Banka është e përfshirë në marrëveshje të qirasë për ambiente zyrash. Angazhimi i mbetur i qerasë përfundon në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015. Më 31 dhjetor 2014, angazhimi për pagesa për vitin 2015 është rreth 17 milionë lekë (2013: 48 milionë lekë).

(iv) Angazhimet kapitale

Më 31 dhjetor 2013, angazhimi kapital për rindërtimin e zyrave të Bankës ishte 715 milionë lekë, ndërsa në vitin 2014 nuk ka angazhime kapitale.

33. AKTIVE TË ADMINISTRUARA

Më 31 dhjetor 2014, Banka vepron si kujdestare për bono thesari (me afat maturimi 3 - 12 muaj) në vlerën nominale 263 miliardë lekë (2013: 254 miliardë lekë) dhe 35 milionë euro (2013: 24 milionë euro), dhe për obligacione me afat maturimi nga 2 deri 10 vjet, në vlerën 269 miliardë lekë (2013: 252 miliardë lekë) dhe 63 milionë euro (2013: 25 milionë euro). Këto instrumente financiare përfaqësojnë letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

34. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë të kontrollojë tjetrën apo të ushtrojë një influencë domethënëse mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo të tjera.

Duke marrë në konsideratë çdo palë të lidhur të mundshme, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo formës së mirëfilltë ligjore.

Palët e lidhura të Bankës përfshijnë drejtuesit dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Më 31 dhjetor 2014 dhe 2013, transaksionet e realizuara me palët e lidhura përfshijnë:

	2014	2013
Kredi për stafin drejtues		
- Staf drejtues	123	142
Totali	123	142

Kreditë kanë normë interesi vjetore 0.5% dhe, duke pasuar një periudhë prej dy vitesh mospagimi, janë të pagueshme për 30 vjet, me këste të barabarta mujore. Kreditë për strehim janë të kolateralizuara.

Rënia prej 19 milionë lekë (2013: 30 milionë lekë) e kredive të stafit drejtues në vitin 2014, është ndikuar nga shlyerjet normale të kredive prej 4 milionë lekësh dhe nga riklasifikimi i nivelit të kredisë sipas ndryshimeve në strukturën hierarkike të stafit drejtues gjatë vitit 2014, prej rreth 15 milionë lekësh.

	2014	2013
Shpenzime administrative		
-Shpenzime telefoni		
- Drejtorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	3	5
-Paga dhe bonuse		
-Drejtorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	93	120
-Kontributi i Bankës në skemën e fondit të pensionit		
-Drejtorët dhe administratorët	9	12
Totali i shpenzimeve administrative	105	137

Të drejtat/detyrimet ndaj Qeverisë Shqiptare shpjegohen në shënimet 13 dhe 19, ndërsa të ardhurat nga interesat e letrave me vlerë dhe shpenzimet për interesa shpjegohen përkatësisht në shënimet 25 dhe 26. Detyrimet e mundshme lidhur me pjesëmarrje në institucionet ndërkombëtare detajohen në shënimin 32 (i) dhe letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria dhe administruara nga Banka paraqiten në shënimin 33.

35. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(a) Struktura e administrimit të rrezikut

Politikat e monitorimit dhe të adresimit të rrezikut përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.

Rezerva valutore administrohet nga Banka dhe investimi i saj realizohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare, i cili bazohet në rregulloren "Mbi politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore", të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Strategjia e saj e investimit varet kryesisht nga funksioni i veçantë si një bankë qendrore, i cili rregullohet në përputhje me kërkesat e ligjit "Mbi Bankën e Shqipërisë".

Rezerva sipas nevojave të likuiditetit, investohet në instrumente financiare afatshkurtra, në letra me vlerë me të ardhura konstante dhe të ndryshueshme, si dhe instrumente derivative. Pjesa tjetër e portofolit mbahet në SDR dhe ar monetar.

Këto instrumente e ekspozojnë bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i likuiditetit;
- rreziku i kreditit;
- rreziku i tregut;
- rreziku operacional.

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e Bankës ndaj rreziqeve të mësipërme, si dhe objektivat, politikat dhe procedurat për matjen dhe administrimin e tij.

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e lidhura me detyrimet financiare në kohën e duhur.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Politikat e monitorimit dhe të adresimit të rrezikut të likuiditetit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Banka administron rrezikun e likuiditetit, nëpërmjet investimit në instrumente afatshkurtra dhe në letra me vlerë të borxhit në tregje likuide.

Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet në kushte normale dhe të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e saj. Në të njëjtën kohë, ajo duhet të operojë në përputhje me politikat monetare dhe të këmbimit. Portofoli përcaktohet çdo vit, bazuar në parashikimet mujore dhe vjetore të nevojave për likuiditet për çdo monedhë. Investimet në letra me vlerë të borxhit konsiderohen si instrumente me likuiditet të mjaftueshëm.

Lidhur me detyrimet në monedhën vendase, Banka nuk është e ekspozuar ndaj këtij rreziku për shkak të karakterit të saj të një banke qendrore.

Tabela e mëposhtme paraqet detyrimet financiare të Bankës (duke përfshirë edhe monedhën në qarkullim dhe detyrime të tjera) në bazë të maturitetit të mbetur, si dhe aktivet financiare në bazë të maturitetit të pritshëm. Flukset e pritshme të parasë mund të variojnë nga rezultatet e kësaj analize.

31 dhjetor 2014	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre muaj deri në gjashtë muaj	Gjashtë muaj deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Maturitet i papërcaktuar	Totali
Detyrime ndaj FMN-së	15,919	266	21	328	1,043	-	7,753	25,330
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	-	-	-	-	1,240	-	15	1,255
Detyrime të tjera të huaja	230	-	-	-	-	-	-	230
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	226,407	226,407
Detyrime ndaj bankave rezidente	106,311	-	-	-	-	-	-	106,311
Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare	16,100	-	952	-	-	-	526	17,578
Detyrime të tjera vendase	705	-	-	-	-	-	1,121	1,826
Totali i detyrimeve 2014 (data e maturimit të mbetur)	139,265	266	973	328	2,283	-	235,822	378,937
Totali i aktiveve 2014 (data e maturimit të mbetur)	85,153	48,911	47,610	62,333	144,617	9,107	35,595	433,326

31 dhjetor 2013	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre muaj deri në gjashtë muaj	Gjashtë muaj deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Maturitet i papërcaktuar	Totali
Detyrime ndaj FMN	8,898	315	21	437	1,640	36	7,286	18,633
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	-	-	-	-	1,240	-	16	1,256
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	207,766	207,766
Detyrime ndaj bankave rezidente	100,031	-	-	-	-	-	-	100,031
Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare	14,558	1,351	-	-	-	-	7,870	23,779
Detyrime të tjera vendase	138	2	3	7	23	-	1,373	1,546
Totali i detyrimeve 2013 (data e maturimit kontraktual)	123,625	1,668	24	444	2,903	36	224,311	353,011
Totali i aktiveve 2013 (data e maturimit të pritshëm)	75,889	30,514	36,963	59,002	152,580	7,653	33,341	395,942

(c) Rreziku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes ose pakësimit të vlerës së investimit në monedhë të huaj për shkak të paaftësisë ose rënies së cilësisë së besimit të institucioneve financiare ose emetuesve të letrave me vlerë, në instrumentet e të cilave rezerva valutore është investuar.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit administrohet nëpërmjet përcaktimit të limiteve mbi nivelin total të ekspozimit të lejuar ndaj institucioneve financiare, si dhe ndaj emetuesve të ndryshëm. Limitet e ekspozimit llogariten bazuar në kritere të cilat janë të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Rreziku i kreditit gjithashtu zvogëlohet nëpërmjet krijimit të një portofoli të larmishëm.

Kreditë për bankat vendase sigurohen nga bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare.

Tabela e mëposhtme tregon aktivet financiare që paraqesin rrezikun e kreditimit në datën e raportimit:

Aktivet	2014	2013
Ari në bankat e huaja (shënimi 5)	9,569	8,474
Të drejtat speciale të tërheqjes tek FMN (shënimi më poshtë)	4,554	3,220
Depozita në bankat jorezidente (shënimi 7)	30,003	21,661
Investime të vlefshme për shitje të huaja (shënimi 8)	242,419	230,588
Investime të mbajtura për tregtim të huaja (shënimi 9)	14,378	12,591
Kredi ndaj bankave rezidente (shënimi 11)	25,548	21,502
Investime të vlefshme për shitje vendase (shënimi 12)	63,948	63,920
Të drejta ndaj Qeverisë Shqiptare (shënimi 13)	7,398	-
Totali i aktiveve	397,817	361,956

Një shumë prej 7,752 milionë lekë (2013: 7,286 milionë lekë) që përfshihet në të drejtat speciale të tërheqjes tek FMN (shënimi 6) nuk paraqet rrezik krediti, sepse përfaqëson një kundërllogari të shumave të shpërndara, nëpërmjet alokimeve në SDR. Vetëm shuma e të drejtave prej 4,554 milionë lekësh (2013: 3,220 milionë lekë), e cila tejkalon shpërndarjet, përfshihet në aktivet financiare që paraqesin rrezik kreditimi.

Një analizë e përqendrimit të aktiveve financiare sipas kundërpartisë, në datën e raportimit, paraqitet si më poshtë:

Kriteret e kreditimit	Ari në bankat e huaja	Të drejtat speciale të tërheqjes tek FMN	Depozita në bankat jorezidente	Investime të vlefshme për shitje (të huaja)	Investime të mbajtura për tregtim (të huaja)	Kredi ndaj bankave rezidente	Investime të vlefshme për shitje (vendase)	Të drejta ndaj Qeverisë Shqiptare	Totali
Banka Qendrore	9,569	4,554	8,346	-	-	-	-	-	22,469
BIS Basle	-	-	3,239	-	-	-	-	-	3,239
Letra të qeverive e agjencive të huaja	-	-	-	231,855	14,378	-	-		246,233
Bankat tregtare	-	-	18,418	10,564	-	25,548	-	-	54,530
Qeveria Shqiptare	-	-	-	-	-	-	63,948	7,398	71,346
Totali më 31 dhjetor 2014	9,569	4,554	30,003	242,419	14,378	25,548	63,948	7,398	397,817

Qeveria Shqiptare është vlerësuar B me pritje pozitive, bazuar në kriteret e Standard & Poor's dhe me B1 i qëndrueshëm nga Moody`s.

Kriteret e kreditimit	Ari në bankat e huaja	Të drejtat speciale të tërheqjes tek FMN	Depozita në bankat jorezidente	Investime të vlefshme për shitje (të huaja)	Investime të mbajtura për tregtim (të huaja)	Kredi ndaj bankave rezidente	Investime të vlefshme për shitje (vendase)	Totali
Banka Qendrore	8,474	3,220	6,543	-	-	-	-	18,237
BIS Basle	-	-	3,220	-	-	-	-	3,220
Letra të qeverive e agjencive të huaja	-	-	-	224,950	12,591	-	-	237,541
Bankat tregtare	-	-	11,898	5,638	-	21,502	-	39,038
Qeveria Shqiptare	-	-	-	-	-	-	63,920	63,920
Totali më 31 dhjetor 2013	8,474	3,220	21,661	230,588	12,591	21,502	63,920	361,956

Qeveria Shqiptare është vlerësuar B, bazuar në kriteret e Standard & Poor's, dhe me B1 i qëndrueshëm nga Moody`s.

Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kreditit sipas pozicionit gjeografik, në datën e raportimit, paraqitet si më poshtë:

31 dhjetor 2014	Evropë	SHBA	Republika e Shqipërisë	Të tjera	Totali
Ari në bankat jorezidente	9,569	-	-	-	9,569
Të drejtat speciale të tërheqjes tek FMN	-	-	-	4,554	4,554
Depozita në bankat jorezidente	24,628	5,375	-	-	30,003
Investime të vlefshme për shitje (monedha të huaja)	192,281	43,378	-	6,760	242,419
Investime të mbajtura për tregtim (monedha të huaja)	-	14,378	-	-	14,378
Kredi ndaj bankave rezidente	-	-	25,548	-	25,548
Investime të vlefshme për shitje (vendase)	-	-	63,948	-	63,948
Të drejta ndaj Qeverisë Shqiptare			7,398		7,398
Totali	226,478	63,131	96,894	11,313	397,817

31 dhjetor 2013	Evropë	SHBA	Republika e Shqipërisë	Të tjera	Totali
Ari në bankat jorezidente	8,474	-	-	-	8,474
Të drejtat speciale të tërheqjes tek FMN	-	-	-	3,220	3,220
Depozita në bankat jorezidente	20,530	1,131	-	-	21,661
Investime të vlefshme për shitje (monedha të huaja)	178,178	44,005	-	8,405	230,588
Investime të mbajtura për tregtim (monedha të huaja)	-	12,591	-	-	12,591
Kredi ndaj bankave rezidente	-	-	21,502	-	21,502
Investime të vlefshme për shitje (vendase)	-	-	63,920	-	63,920
Totali	207,182	57,727	85,422	11,625	361,956

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në balancën e kredisë së kredidhënësit apo kredimarrësit) të ndikojë në të ardhurat e Bankës apo vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Elementët kryesorë të rrezikut të çmimit që ndikojnë Bankën janë:

- Rreziku i normave të interesit, i lidhur me ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve financiare, për shkak të ndryshimit të normave të interesit; dhe
- Rreziku i kursit të këmbimit, i lidhur me ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve financiare, për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Aktivet dhe detyrimet financiare, të mbajtura në monedhë të huaj, janë paraqitur në secilin prej shënimeve korresponduese në pasqyrat financiare.

Rreziku i normave të interesit

Operacionet e Bankës janë të ekspozuara ndaj rrezikut të normave të interesit, i cili ndikon në çmimet e aktiveve interesprurëse (duke përfshirë investimet), dhe detyrimeve që paguajnë interes. Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të normave të interesit monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Banka e zbut këtë rrezik duke mbajtur një tepricë të konsiderueshme aktivesh interesprurëse mbi detyrimet që paguajnë interes. Banka e Shqipërisë mban një portofol aktivesh dhe detyrimesh financiare me interes, të tillë që e ardhura nga interesi neto është në mënyrë të ndjeshme më e lartë se kërkesat operative, për të minimizuar efektet e mundshme negative të ndryshimeve në normat e interesit. Normat e interesit që zbatohen mbi aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten në çdo shënim korrespondues të pasqyrave financiare.

Aktivet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme interesi mbartin rrezikun e ndryshimit të bazës që shërben për të përcaktuar normat e interesit.

Instrumentet me norma të ndryshueshme interesi detajohen si më poshtë:

	Norma mesatare	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë muaj deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Totali
31 dhjetor 2014								
Aktivet								
Investime të vlefshme për shitje	0.25%	-	-	461	-	-	-	461
Investime të vlefshme për shitje	0.27%	-	-	-	577	-	-	577
Investime të mbajtura për tregtim	1.72%	346	-	-	-	-	-	346
Investime të mbajtura për tregtim	0.53%	-	-	115	-	-	-	115
Investime të mbajtura për tregtim	0.41%	-	-	-	231	-	-	231
Investime të mbajtura për tregtim	0.17%	-	-	-	-	646	-	646
Total		346	-	576	808	646	-	2,376
Detyrimet								
Detyrime ndaj FMN	1.09%	68	51	-	119	473	-	711
Totali		68	51	-	119	473	-	711
Pozicioni për norma të ndryshueshme		278	(51)	576	689	173	-	1,665
Ndjeshmëria ndaj 100 b.p. rritje		3	(1)	6	7	2	-	17
31 dhjetor 2013								
Aktivet								
Investime të vlefshme për shitje	0.39%	-	-	-	2,778	-	-	2,778
Investime të vlefshme për shitje	0.33%	-	-	-	-	918	-	918
Investime të mbajtura për tregtim	0.72%	-	408	-	-	-	-	408
Investime të mbajtura për tregtim	0.39%	-	-	306	-	-	-	306
Investime të mbajtura për tregtim	0.45%	-	-	-	562	-	-	562
Investime të mbajtura për tregtim	0.38%	-	-	-	-	1,021	-	1,021
Total		-	408	306	3,340	1,939	-	5,993
Detyrimet								
Detyrime ndaj FMN	1.14%	-	-	-	-	-	923	923
Totali		-	-	-	-	-	923	923
Pozicioni për norma të ndryshueshme		-	408	306	3,340	1,939	(923)	5,070
Ndjeshmëria ndaj 100 b.p. rritje		-	4	3	33	19	(9)	50

Një përmbledhje e aktiveve interesprurëse dhe detyrimeve që paguajnë interes (përfshirë instrumentet e mësipërme me normë të ndryshueshme) sipas datës së maturimit, paraqitet si më poshtë:

31 dhjetor 2014	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë muaj deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Pa interes	Totali
Aktivet								
Ari dhe metalet e çmuara – të huaja	-	-	-	-	-	-	9,569	9,569
Llogari me FMN	12,306	-	-	-	-	-	9,486	21,792
Depozita në banka jorezidente	14,588	15,415	-	-	-	-	-	30,003
Investime të vlefshme për shitje – të huaja	9,024	13,503	27,014	52,046	132,879	7,953	-	242,419
Investime të mbajtura për tregtim – të huaja	347	-	662	2,106	11,263	-	-	14,378
Aktive të tjera në monedhë të huaj	-	-	-	-	-	-	779	779
Ari dhe metalet e çmuara - vendase	-	-	-	-	-	-	4,483	4,483
Kredi ndaj bankave rezidente	22,245	3,303	-	-	-	-	-	25,548
Investime të vlefshme për shitje - vendase	19,243	16,661	19,910	8,134	-	-	-	63,948
Të drejta ndaj Qeverisë Shqiptare	-	-	-	-	-	-	7,398	7,398
Aktive të tjera vendase	32	5	-	-	-	1,730	11,242	13,009
Totali	77,785	48,887	47,586	62,286	144,142	9,683	42,957	433,326
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj FMN	15,919	266	21	328	1,043	-	7,753	25,330
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	-	-	-	-	1,240	-	15	1,255
Detyrime të tjera të huaja	230	-	-	-	-	-	-	230
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	226,407	226,407
Detyrime ndaj bankave rezidente	45,990	-	-	-	-	-	60,321	106,311
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	17,578	17,578
Detyrime të tjera vendase	48	-	-	-	-	-	1,778	1,826
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	54,389	54,389
Totali	62,187	266	21	328	2,283	-	368,241	433,326
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	15,598	48,621	47,565	61,958	141,859	9,683	(325,284)	-
Pozicioni i akumuluar – 2014	15,598	64,219	111,784	173,742	315,601	325,284	-	

31 dhjetor 2013	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë muaj deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Pa interes	Totali
Aktivet								
Ari dhe metalet e çmuara – të huaja	-	-	-	-	-	-	8,474	8,474
Llogari me FMN	10,508	-	-	-	-	-	9,712	20,220
Depozita në banka jorezidente	20,482	1,179	-	-	-	-	-	21,661
Investime të vlefshme për shitje – të huaja	3,796	11,704	16,380	51,006	141,871	5,831	-	230,588
Investime të mbajtura për tregtim– të huaja	308	408	459	706	10,710	-		12,591
Aktive të tjera në monedhë të huaj	-	-	-	-	-	-	577	577
Ari dhe metalet e çmuara - vendase	-	-	-	-	-	-	4,021	4,021
Kredi ndaj bankave rezidente	20,628	874	-	-	-	-	-	21,502
Investime të vlefshme për shitje - vendase	20,158	16,349	20,123	7,290	-	-	-	63,920
Aktive të tjera vendase	9	-	-	-	-	1,822	10,557	12,388
Totali	75,889	30,514	36,962	59,002	152,581	7,653	33,341	395,942
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj FMN	8,898	315	21	437	1,640	36	7,286	18,633
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	-	-	-	-	1,241	-	15	1,256
Detyrime të tjera të huaja	-	-	-	-	-	-	-	-
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	207,766	207,766
Detyrime ndaj bankave rezidente	32,087	-	-	-	-	-	67,944	100,031
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	23,779	23,779
Detyrime të tjera vendase	55	-	-	-	-	-	1,491	1,546
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	42,931	42,931
Totali	41,040	315	21	437	2,881	36	351,212	395,942
Pozicioni më 31 dhjetor 2013	34,849	30,199	36,941	58,565	149,700	7,617	(317,871)	-
Pozicioni i akumuluar – 2013	34,849	65,048	101,989	160,554	310,254	317,871	-	

Kontratat e ardhshme

Kontratat e ardhshme janë kontrata standarde për blerjen ose shitjen në një datë të ardhshme të një aktivi financiar ose jofinanciar, me një çmim specifik të paracaktuar. Për të minimizuar rrezikun e kreditit, në varësi të llojit të kontratës së ardhshme, investitorët duhet të lënë një marzh pranë "*clearing broker*-it", si garanci financiare, i cili vlerësohet çdo ditë sipas tregut, që do të thotë se çdo ndryshim në vlerë tregohet në llogarinë e investitorit në fund të çdo dite tregtimi, deri në skadimin e kontratës.

Më 31 dhjetor 2014, vlerësimi neto për këto kontrata ishte 17 milionë lekë (2013: 31 milionë lekë) (shënimi 7).

Vlera nocionale e këtyre kontratave për 31 dhjetor 2014 paraqitet:

- kontratat në blerje janë në vlerën 856 milionë lekë (2013: 3,354 milionë lekë); dhe
- kontratat në shitje janë në vlerën 6,440 milionë lekë (2013: 8,270 milionë lekë).

Rreziku i këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit vjen si pasojë e diferencës në strukturën e monedhave midis aktiveve dhe detyrimeve. Nga një këndvështrim kontabël, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit për shkak të realizimit të funksioneve të saj si bankë qendrore.

Ky rrezik mund të ndikojë madhësinë e kapitalit të saj. Për të administruar këtë lloj ekspozimi ndër vite është vepruar me shtim të kapitalit, të fondeve dhe - në raste të veçanta, atëherë kur vlera e rivlerësimit të zërave të bilancit ka rezultuar negative - me emetim të instrumenteve nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, sikurse parashikohet në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë".

Normat zyrtare e aplikuar nga Banka (Lekë për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore, për periudhën 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013, janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Dollari Amerikan (USD)	115.23	101.86
Monedha e Bashkimit Evropian (EUR)	140.14	140.20
Paundi Britanik (GBP)	179.48	168.39
Të drejtat speciale të tërheqjes (SDR)	166.90	156.86
Yen-i Japonez (JPY)	0.9649	0.9698
Ari ('XAU') për 1 onz (Lek)	138,189.58	122,384.79

Kontratat e këmbimit forward dhe swap

Banka, për efekte të administrimit të rezervës së saj valutore apo veprimeve që kryen për administrimin e likuiditetit të qeverisë shqiptare, përdor kontrata forward dhe *swap*. Përsa i përket rrezikut të përmbushjes së kontratës, e konsiderojmë të papërfillshëm për vetë natyrën e palëve në kontratë.

Një kontratë këmbimi "*forward exchange*" përfaqëson një marrëveshje për të konvertuar valuta të ndryshme, në një datë të caktuar në të ardhmen, me një kurs të përcaktuar.

Kontratat *swap* janë kontrata me bazë në këmbime të ardhshme, në të cilat dy palët bien dakord të shkëmbejnë një seri fluksesh parash.

	Lekë	USD	Euro	GBP	Të tjera	Totali
Aktivet						
Ari dhe metalet e çmuara - të huaja	-		-	-	9,569	9,569
Llogari me FMN	-		-	-	21,792	21,792
Depozita në bankat jorezidente	-	4,642	19,897	3,606	1,858	30,003
Investime të vlefshme për shitje - të huaja		53,848	172,882	8,929	6,760	242,419
Investime të mbajtura për tregtim - të huaja	-	14,378	-	-	-	14,378
Aktive të tjera në monedhë të huaj	335	427	17	-	-	779
Ari dhe metale të çmuara - vendase	-	-	-	-	4,483	4,483
Kredi ndaj bankave rezidente	25,548	-	-	-	-	25,548
Investime të vlefshme për shitje (vendase)	63,948	-	-	-	-	63,948
Të drejta ndaj Qeverisë Shqiptare	7,398	-	-	-	-	7,398
Aktive të tjera vendase	12,992	13	4	-	-	13,009
Totali i aktiveve	110,221	73,308	192,800	12,535	44,462	433,326
Detyrimet						
Detyrime ndaj FMN	16,522	-	-	-	8,808	25,330
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	15	-	1,240	-	-	1,255
Detyrime të tjera të huaja	-	230	-	-	-	230
Para në qarkullim	226,407	-	-	-	-	226,407
Detyrime ndaj bankave rezidente	57,144	6,487	42,680	-	-	106,311
Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare	13,918	118	3,278	1	263	17,578
Detyrime të tjera vendase	1,237	174	415	-	-	1,826
Totali i detyrimeve	315,243	7,009	47,613	1	9,071	378,937
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2014	(205,022)	66,299	145,187	12,534	35,391	54,389
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2013	(186,252)	58,519	126,631	11,751	32,282	42,931

	Lekë	USD	Euro	GBP	Të tjera	Totali
Aktivet						
Ari dhe metalet e çmuara – të huaja	-	-	-	-	8,474	8,474
Llogari me FMN	-	-	-	-	20,220	20,220
Depozita në bankat jorezidente	-	3,046	15,127	3,279	209	21,661
Investime të vlefshme për shitje – të huaja	-	49,872	163,843	8,468	8,405	230,588
Investime të mbajtura për tregtim – të huaja	-	12,591	-	-	-	12,591
Aktive të tjera në monedhë të huaj	335	206	36	-	-	577
Ari dhe metale të çmuara - vendase	-	-	-	-	4,021	4,021
Kredi ndaj bankave rezidente	21,502	-	-	-	-	21,502
Investime të vlefshme për shitje - vendase	63,920	-	-	-	-	63,920
Aktive të tjera vendase	12,216	13	154	5	-	12,388
Totali i aktiveve	97,973	65,728	179,160	11,752	41,329	395,942
Detyrimet						
Detyrime ndaj FMN	9,586	-	-	-	9,047	18,633
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	16	-	1,240	-	-	1,256
Para në qarkullim	207,766	-	-	-	-	207,766
Detyrime ndaj bankave rezidente	44,676	6,959	48,396	-	-	100,031
Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare	21,040	196	2,542	1	-	23,779
Detyrime të tjera vendase	1,141	54	351	-	-	1,546
Totali i detyrimeve	284,225	7,209	52,529	1	9,047	353,011
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2013	(186,252)	58,519	126,631	11,751	32,282	42,931
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2012	(172,017)	62,645	119,253	11,973	31,509	53,363

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes direkte dhe indirekte, si rezultat i një shumëllojshmërie shkaqesh të lidhura me operacionet e Bankës, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën, si dhe me faktorë të jashtëm, përveç rrezikut të kredisë, rreziqeve të tregut dhe të likuiditetit, të lindura nga kërkesat ligjore dhe rregullatore, si dhe standardet përgjithësisht të pranuara të sjelljes organizative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e Bankës.

Menaxhimi i rrezikut operacional mbështetet në sistemet e kontrollit të brendshëm për një sërë aktivitete të Bankës dhe në standardet për menaxhimin e rrezikut operacional, si dhe në një sërë politikash të përgjithshme, rregullore të drejtimit stafit dhe kërkesa rregullatore.

36. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit, të tilla që mund të ketë nevojë për rregullime ose shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare.